


Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele



RAPORTI I PUNËS
SË AGJENCISË PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PËR VITIN 2025

Mars, 2026

PËRMBAJTJE

HYRJE	4
RREGULLATIVA MEDIATIKE.....	7
MONITORIMI I PREZANTIMIT MEDIATIK TË ZGJEDHJEVE LOKALE.....	11
DETYRIME PROGRAMORE DHE TË TJERA TË TRANSMETUESVE	
TRANSAPERNCA E PUNËS SË TRANSMETUESVE	
MBROJTJA E PLURALIZMIT DHE TRANSPARENCA E PRONËSISË SË TRANSMETUESVE	28
ARSIMI MEDIATIK DHE PËRFSHIRJA SOCIALE	
PROMOVIMI I LIRISË SË SHPREHJES DHE LIRISË SË MEDIAS	
LEJET E TRANSMETIMIT TELEVIZIV DHE RADIO	
OPERATORËT E RRJETIT PUBLIK TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK	
OFRUES TË SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIOVIZUELE ME KËRKESË	
BOTUES TË MEDIAS SË SHTYPIT	
BOTUES TË MEDIAS ONLINE - INTERNET PORTALE	
MASAT E NDËRMARRA	
KONTESTET ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURAT PARA GJYKATËS KUSHTETUESE	
ANALIZA,STUDIME DHE HULUMTIME	53
AKTIVITETE TË TJERA TË AGJENCISË	
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	
PROCESI I INTEGRIMIT EVROPIAN	
TRANSPARENCA NË PUNË DHE KOMUNIKIMI PUBLIK	
REVIZION I BRENDSHËM NË AGJENCION	
PUNA MATERIALE - FINANCIARE	
SHTOJCA NDAJ RAPORTIT	
1. LEJET E DHËNA/TË MARRA DHE PASQYRA E MASAVE TË SHQIPTUARA.....	83
2.RAPORT MBI REALIZIMIN E PLANIT VJETOR PËR MBIKËQYRJE PROGRAMORE PËR VITIN 2025	105
3. RAPORT FINANCIAR PËR REALIZIMIN E PLANIT FINANCIAR PËR VITIN 2025, ME TË	
ARDHURAT, SHPENZIMET DHE DETYRIMET PËR VITIN 2025	117

HYRJJE

Në pajtim me nenin 8 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Agjencia, si trup rregullator i mëvetësishëm dhe i pavarur, për punën e saj raporton para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë duke dorëzuar raport mbi punën në vitin paraprak.

Raporti përfshin të gjitha aktivitetet që në kuadër të kompetencave të saj të përcaktuara në Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV), Ligjin për Median (LM) dhe Kodin Zgjedhor (KZ) Agjencia i realizoi gjatë vitit 2025.

Më 24 qershor 2025, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me Vendim (nr. 08-3607/1), si antarë të Këshillit të Agjencisë emëroi Viktor Pavlovski, inxhinier i diplomuar në informatikë prodhimi nga Shkupi; Sasho Stefanovski, i diplomuar në arte filmike, kameraman filmi dhe televizioni nga Shkupi; Petar Xhurovskin, redaktor i diplomuar filmi dhe televizioni nga Shkupi; Cvetanka Minovska, gazetare e diplomuar nga Shkupi; Afrona Vërzivolli, ekonomiste e diplomuar nga Shkupi; Zirjeta Hajro Jajaga, profesoreshë e gjuhës dhe letërsisë shqipe, magjistër i diplomacisë nga Shkupi; dhe Gordana Majnova, ekonomiste e diplomuar dhe magjistër i komunikimit nga Shkupi.

Më 3 korrik 2025, u mbajt seancë konstituive në të cilën për kryetar të Këshillit të Agjencisë u zgjodh Sasho Stefanovski ndërsa për zëvendëse e kryetarit u zgjodh Zirjeta Hajro Jajaga.

Në nëntor u shpall konkurs publik për zgjedhje të drejtorit dhe zëvendësi të drejtorit të Agjencisë, pas së cilës, në seancën e 26-të, e cila u mbajt më 26 dhjetor 2025, Këshilli i Agjencisë miratoi vendim me të cilin për drejtor të Agjencisë u zgjodh dr. Zoran Trajçevski.

Në vitin raportues, drejtuar ministrisë kompetente Agjencia paraqiti dy iniciativa për ndryshime legjislative që do të ofrojnë kornizë bashkëkohore që do të inkurajojë zhvillimin e sektorit mediatik dhe do të forcojë mbrojtjen e interesit publik, njëra për fillimin e procesi për utjen e radios digjitale (DAB), dhe tjetra për fillimin e aktiviteteve përgatitore për formim të fondit për mbështetje të pluralizmin mediatik. Përveç kësaj, Agjencia mori pjesë aktive në procesin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Median, dhe miratoi tre akte nënligjore që mundësojnë zbatim të plotë dhe të menjëhershëm të dispozitave të LShMAAV dhe Ligjit për Median.

Një nga aktivitetet më të rëndësishme të Agjencisë në vitin raportues ishte monitorimi i mbulimit mediatik të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura në vitin 2025. Monitorimi filloi më 10 gusht, pas shpalljes së zgjedhjeve, dhe aktivitetet përfunduan me dorëzim të Raportit mbi transmetimin e reklamave politike me pagesë në rrethin e dytë të fushatës zgjedhore në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, më 20 nëntor 2025. Gjatë fushatës, stacionet televizive kryesisht i respektuan rregullat për raportim të balancuar, reklamim politik dhe përfaqësim politik pa pagesë. Përrjashtim ishin rastet individuale të mosrespektimit të heshtjes zgjedhore në rrethin e parë, për të cilat u inicuan procedura kundërvajtëse, ndërsa në rrethin e dytë nuk u konstatuan shkelje. Reklamim të paguar politik kryesisht shfrytëzuan katër koalicionet më të mëdha. Në rrethin e parë të zgjedhjeve, vetëm një transmetues tejkaloi limitin ligjor për transmetim të reklamave politike me pagesë, për të cilat Agjencia inicioi procedurë kundërvajtëse. Në rrethin e dytë nuk u konstatuan parregullsi.

Për të konstatuar nëse transmetuesit i përmbushin detyrimet programore, administrative dhe detyrimet e tjera sipas LShMAAV, LM, akteve nënligjore, si dhe detyrimeve të përcaktuara në lejen për transmetim, Agjencia zbatoi mbi 300 mbikëqyrje të rregullta, të jashtëzakonshme dhe kontrolluese. Për shkeljet e konstatuara gjatë këtyre mbikëqyrjeve, u shqiptuan masa në pajtim me LShMAAV.

Me qëllim rritjen e transparencës së pronësisë së medias dhe për t'i ofruar publikut qasje të lehtë, të thjeshtë dhe papagesë në të dhënat mbi pronarët përfundimtarë të botuesve të medias, në vitin raportues Agjencia filloi aktivitetet për krijimin e regjistrimit të vetëm për strukturën pronësore të të gjithë botuesve të medias (televizion, radio, media online - portale interneti dhe media e shkruar), i cili u përfundua dhe u vendos në ueb-fqen e Agjencisë në fillim të vitit 2026. Dhe këtë vit, Agjencia përgatiti publikimin - "Pronësia e Medias në vitin 2025".

Në periudhën nga 17 deri më 24 nëntor 2025, nën moton "Ti e di tjetri nuk e di. Komenti yt mund të ndihmojë!", u mbajtë për të shtatën herë me radhë Ditët e Arsimimit Mediatik (DAM) 2025, të organizuar nga Agjencia dhe anëtarë të tjerë të Rrjetit për Arsimim Mediatik (RrAM) dhe mbështetësve të tyre, gjatë të cilave u realizuan më shumë se 20 evente në lokacione të ndryshme në të gjithë vendin dhe online, me ç'rast vendi përsëri iu bashkua Javës Globale të Arsimimit Mediatik dhe Informativ të UNESCO-s. Këtë vit, fokusi i DAM ishte vënë në shfrytëzimin e të menduarit kritik për t'u përballur me dezinformimin nga vendi dhe bota, përgjegjësinë personale në hapësirën digjitale, si dhe në motivimin e "të aftëve mediatikë" për të qartësuar praktikatat e dëmshme në sferën online.

Agjencisë iu dorëzuan mbi 30 parashtresa nga qytetarët në lidhje me përmbajtjen mediatike. Të gjithave iu dha përgjigje në kohën e duhur, u njoftuan edhe mediat që ishin objekt i ankesave, dhe dokumentacioni i plotë (në formë anonime, në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale) u publikua në ueb-faqen e AshMAA-së në pjesën për parashtresa. Agjencia mori pjesë në disa evente që trajtuan çështjet gjinore, dhe gjithashtu iu bashkua fushatës "Gjashëmbëdhjetë ditë aktivizim kundër dhunës me bazë gjinore 2025". Në vitin 2025, u përgatit edhe analiza "Gjinia në Media 2024: Çështjet gjinore dhe mënyra e përfaqësimit të grave dhe burrave në kohën më të shikuar në televizionet kombëtare".

Në vitin raportues, Agjencia mori katër vendime për dhënien e lejes, të gjitha për transmetim të radioprogrameve në nivel lokal, për zonat në vijim: Shtip, Prilep, Strugë dhe Kumanovë. Në pajtim me dispozitat e LShMAAV-së, dhe pasi u konstatua se ishin përmbushur kushtet e përcaktuara, iu vazhdua leja për transmetim televiziv njërit prej transmetuesve.

Sipas ligjit, ka mbaruar vlefshmëria e lejes për transmetim televiziv dhe radio gjithsej pesë transmetuesve - dy radio dhe tre televizione. Ndaj tre prej tyre Agjencia ua hoqi lejen për transmetim televiziv, ndërsa dy të tjerët me deklaratë me shkrim njoftuan Agjencinë se po ndërprisnin transmetimin e programit në radio.

Në regjistrin e operatorëve që rritransmetojnë paketa programe u evidentuan gjithsej 30 subjekte. Duke vepruar në pajtim me kompetencat ligjore, Agjencia ka dhënë gjithsej 282 certifikata për regjistrimin e një pakete shërbimesh programore. Ndaj operatorëve u kryen gjithsej 99 mbikëqyrje dhe për shkeljet e konstatuara u shqiptuan masa në pajtim me LShMAAV. Drejtuar zotëruesve të të drejtave iu dërguan 18 njoftime në rastet kur mbikëqyrjet e kryera përcaktuan se operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik po rritransmetonin papagesë shërbime programesh që nuk janë të regjistruara në Agjenci.

Nga mbikëqyrja e realizuar mbi personat juridikë që janë ofrues të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, u konstatua se plotësisht i përmbushin detyrimet sipas LShMAAV.

Mbikëqyrja ndaj 19 botuesve të medias së shtypit u realizuan në lidhje me përmbushjen e detyrimit për të siguruar transparencë të punës dhe detyrimin për publikim impresium. Gjatë këtyre mbikëqyrjeve nuk u konstatuan shkelje.

Në vitin raportues, Agjencia krijoi regjistrin e botuesve të mediave online - portaleve të internetit. U paraqitën gjithsej 68 kërkesa për regjistrim në regjistër, dhe pas kontrollit të përmbushjes së kriterëve të përcaktuara ligjore, në regjistër u evidentuan gjithsej 48 persona juridik që botojnë 60 media online - portale të internetit.

Për shkelje të konstatuara të LShMAAV, LM dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të ligjit, Agjencia ka shqiptuar gjithsej 50 masa, nga të cilat 40 aktvendime për ndërmarrjen e masës - paralajmërim publik (32 ndaj transmetuesve dhe tetë ndaj operatorëve të rrjetit publik të komunikimit elektronik), katër procedura kundërvajtëse/procedura për paqësim - procedura për dhënie të urdhër pagese kundërvajtëse, një vendim për heqjen e lejes dhe pesë aktvendime për fshirje nga regjistri i transmetuesve.

Agjencia përgatiti tre Studime për të përcaktuar arsyeshmërinë e shpalljes së konkursi publik për dhënie e lejes për radio në nivel lokal - për zonat e Prilepit, Shtipit dhe Strugës. U përgatitën katër analiza: "Analiza vjetore e tregut të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele për vitin 2024", analiza "Struktura e të punësuarve në industrinë mediatike audio dhe audiovizuele në vitin 2024", analiza "Transmetuesit rajonalë dhe lokalë (arsyetimi dhe mundësitë për vënien e masave mbështetëse)" dhe "Analiza e tregut mediatik në Maqedoni (karakteristikat strukturore, qëndrueshmëria ekonomike dhe mundësitë e zhvillimit)", si dhe u konceptua Hulumtim i mendimit dhe qëndrimit publik në lidhje me mediat.

Bashkëpunimi ndërkombëtar u zhvillua nëpërmjet pjesëmarrjes në punën e shoqatave të organeve rregullatore në fushën audiovizuele - Platforma Evropiane e organeve rregullatore (EPRA), Rrjeti mesdhetar i organeve rregullatore (MNRA), Grupi i rregullatorëve evropianë për shërbime mediatike audiovizuele (ERGA)/Bordi evropian i shërbimeve mediatike (Bordi i Medias) i rregullatorëve të medias nga UE-ja, dhe evente të karakterit ndërkombëtar relevante për fushën audiovizuele. Agjencia gjithashtu bashkëpunoi me Misionin e OSBE-së në Shkup, Zyrën e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dhe organe të tjera ndërkombëtare, aktivitetet e të cilave lidhen me lirinë e medias dhe monitorimin e përfaqësimit mediatik gjatë fushatës zgjedhore, si dhe me Këshillin e Evropës në aktivitete që synojnë inkurajimin e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për median.

RREGULLATIVA MEDIATIKE

Në drejtim të përparimit të rregullativës mediatike, në vitin 2025, drejtuar ministrisë kompetente Agjencia paraqiti dy iniciativa për ndryshime legjore që do të ofrojnë një kornizë bashkëkohore që do të inkurajonte zhvillimin e sektorit mediatik dhe do të forcojë mbrojtjen e interesit publik. Njëra iniciativë kishte të bënte me fillimin e një procesi për futjen e radios digjitale (DAB), dhe tjetra kishte të bënte me fillimin e aktiviteteve përgatitore për formim të fondit për të mbështetur pluralizmin mediatik. Përveç kësaj, në vitin raportues, Agjencia mori pjesë aktive në procesin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Median dhe miratoi tre akte nënligjore që mundësojnë zbatimin e plotë dhe të menjëhershëm të dispozitave të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe dispozitave të Ligjit për Median.

Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele

- **Iniciativë për fillim të procesit për instalim (futje) të radios digjitale**

Duke u nisur nga fakti se transmetimi digjital në radio është një standard që është zhvilluar dhe në përgjithësi i pranuar në Evropë dhe në vendet fqinje, dhe në vendin tonë ky proces as nuk ka filluar, Agjencia zhvilloi disa takime pune me përfaqësues të Agjencisë për Komunikime Elektronike (AKE) ku u diskutua për mundësitë e instalimit të radios digjitale në Maqedoni. Në janar 2025, të dy institucionet, si organe rregullatore kompetente në fushën e medias dhe komunikimeve elektronike, paraqitën një iniciativë të përbashkët në Ministrinë e Transformimit Digjital (MTD) dhe kërkuan që të organizohet takim pune për të diskutuar lidhur me aktivitetet dhe hapat konkret për futjen e radios digjitale në Maqedoni.

Në Iniciativën e paraqitur, Ministria u informua se dy organet rregullatore kishin identifikuar disa pengesa ligjore dhe teknike që duhen tejkaluar në mënyrë që ky standard të futej në vendin tonë, përkatësisht se nevojiteshin ndryshime në Ligjin për Komunikimet Elektronike (LKE) dhe Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV). Në lidhje me LKE, u theksua se nevojiteshin ndryshime në nenin 133 të këtij ligji, të cilat do t'i mundësonin AKE-së t'i jepte Ndërmarrjes Publike Radiodifuzioni i Maqedonas (RDM) miratim për shfrytëzimin e tre sistemeve kombëtare multipleks, dhe në lidhje me LShMAAV, se dispozitat që rregullojnë çështjet që lidhen me ndarjen dhe dhënien e lejeve për transmetim në radio, llogaritjen e kompensimit (tarifës) së llesjes, si dhe kufizimet në fitim të pronësisë nga transmetuesit janë të vjetruara dhe dekurajuese për procesin e futjes së radios digjitale. Për këto arsye, është e nevojshme që dispozitat të rishikohen dhe me kujdes të ndryshohen, përkatësisht të plotësohen për të inkurajuar këtë proces shumë të rëndësishëm, veçanërisht duke pasur parasysh se zakonisht radistacionet janë të parat që fillojnë transmetimin digjital. Të dy organet rregullatore treguan se janë të dispozicion me ekspertizën e tyre për të gjitha fazat dhe janë të gatshëm të marrin pjesë aktive në të gjithë procesin.

Duke pasur parasysh se ka kaluar një periudhë e caktuar kohore dhe Ministria nuk i është përgjigjur Iniciativës së paraqitur, në shkurt Agjencia dhe AKE dorëzuan edhe një shkresë – Duke rikujtuar në lidhje me Iniciativën për fillim të procesit për futje së radios digjitale (DAB), pas së cilës Ministria dorëzoi Informacion se kjo çështje, si dhe koncepti që lidhet me radion digjital në përgjithësi, do të shqyrtohen në fazën e përpunimit të zgjidhjes së re ligjore, saktësisht në procedurën për miratimin e ligjit të ri për LKE. Agjencia, përmes përfaqësuesve të saj, mori pjesë aktive në grupin e punës për miratimin e LKE të ri dhe dha propozime konkrete që u miratuan dhe të cilat tejkaluan pengesat e këtij ligji. LKE i ri është miratuar dhe hyn në fuqi më 1.6.2026. Mbetet të bëhen ndryshimet e nevojshme në LShMAAV për të mundësuar futjen e radios digjitale në Maqedoni.

- **Iniciativë për fillimin e aktiviteteve për të krijuar një fond për mbështetje të pluralizmit mediatic**

Në shtator 2025, Agjencia drejtuar Ministrisë së Transformimit Digjital ka paraqitur një Iniciativë për fillimin e aktiviteteve për krijimin e një fondi për të mbështetur pluralizmin mediatic. Konkretisht, Agjencia propozoi të fillonte një proces për aktivitete përgatitore për ndryshime ligjore që do të krijonin një Fond për Pluralizmin Mediatic, i hartuar në mënyrë që do të paraqet instrument afatgjat për inkurajimin e një oferte mediatike cilësore dhe të larmishme, forcimin e prodhimit audiovizual vendas dhe zhvillimin e gazetarisë investigative profesionale dhe të pavarur.

Procesi i krijimit dhe hartimit të fondit duhet të jetë transparent, i gjerë dhe gjithëpërfshirës dhe duhet të përfshijë të gjithë palët e interesuara - mediat, organizatat e shoqërisë civile që punojnë në fushën e medias, ekspertët e medias dhe institucionet përkatëse. Sigurisht, Agjencia gjithashtu shprehu gatishmërinë e saj për të marrë pjesë aktive në proces dhe me ekspertizën e saj të japë ndihmesë për zbatimin e tij të suksesshëm.

Njëkohësisht, Agjencia tregoi se në fazën përgatitore duhet të merren në konsideratë së paku çështjet e mëposhtme: burimi i mjeteve të fondit (buxheti i shtetit, mjetet që do të paguhen nga kompanitë private në bazë të ligjit, donacionet dhe burimet e tjera të financimit); shuma e fondit; organi që do të menaxhojë fondin, përkatësisht do të shpallë konkurse, do të vlerësojë aplikimet, do të shpërndajë mjetet dhe do të sigurojë transparencë dhe mbikëqyrje mbi shfrytëzimin e mjeteve; cilat subjekte do të jenë në gjendje t'i përdorin mjetet (nëse të gjitha televizionet dhe radiot - në nivel shtetëror, rajonal dhe lokal, mediat online - portalet e internetit); cilat janë qëllimet me interes publik që duhet të arrihen me fondin (produksion i programeve cilësore artistike, dokumentare dhe edukative; inkurajimi, promovimi dhe mbrojtja e identitetit kulturor, gjuhës dhe traditës së bashkësive në Maqedoni, respektimi i dallimeve kulturore dhe fetare, krijimi i përmbajtjeve programore për respektimin dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, privatësisë, dinjitetit, reputacionit dhe nderit të individit, tolerancës, mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë, ndjenjës së paqes, drejtësisë, vlerave dhe institucioneve demokratike, mbrojtjes së të miturve, barazisë gjinore, përfitimeve të shoqërisë civile dhe luftës kundër diskriminimit), si dhe të përcaktohen kriteret e qarta dhe precize për vlerësimin e aplikimeve të paraqitura gjatë konkurimit për shfrytëzimin e mjeteve nga fondi (cilësia dhe inovacioni i përmbajtjes, kontribut ndaj interesit publik, pluralizmi mediatic dhe liria e shprehjes, përfshirja dhe përfaqësimi i grupeve të cënueshme, etj.).

- **Ndërrim i nenit 42 të LShMAAV**

Në vitin raportues, u ndërrua dhe u plotësua neni 42 i LShMAAV-së, i cili rregullon çështjet që lidhen me anulimi të vendimit me të cilin Agjencia më parë kishte lejuar zbatimin e ndryshimi në strukturën pronësore ndaj transmetuesit të caktuar. Përfaqësuesit e Agjencisë, në bashkëpunim me përfaqësuesit e Ministrisë së Transformimit Digjital, shqyrtuan mundësitë për specifikimin e mëtejshëm të këtij neni të LShMAAV-së, duke dhënë propozimet, mendimet dhe vërejtjet e tyre, pas së cilës neni u plotësua me paragraf të ri që përcakton se Agjencia me vendim do ta anulojë vendimin me të cilin ka lejuar zbatimin e ndryshimi në strukturën pronësore, nëse transmetuesi nuk e zbaton ndryshimin në strukturën pronësore në Regjistrin Qendror në afat prej 90 ditësh nga data e miratimit të vendimit të Agjencisë.

Ligji për Media

Në janar 2025, Ministria e Transformimit Digjital i kërkoi Agjencisë të paraqiste mendim në lidhje me Propozimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Media. Qëllimi i këtyre ndërrimeve ishte të krijonte kornizë ligjor në të cilën mediat online - portalet e internetit t'i njeji si media dhe përcakton rregulla të qarta për themelimin dhe regjistrimin e tyre. Përveç kësaj, këto ndryshime përcaktojnë edhe detyrime përmbrojtjen e të miturve, detyrime për të siguruar transparencë në punë, të publikojnë impesium dhe për të emëruar redaktor përgjegjës. Ndryshimet e propozuara përcaktuan kompetencën e Agjencisë për të udhëhequr (mbajtur) Regjistrin e mediave online - portaleve të Internetit, pas verifikimit paraprak të përmbushjes së kushteve të përcaktuara me ligj për evidentim në regjistër.

Në nëntor 2024, në Regjistrin unik kombëtar elektronik të dispozitave (RUNE) është paraqitur propozim për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Median dhe Agjencia në atë kohë paraqiti vërejtje dhe propozime për përmirësimin e tij. Nga përmbajtja e Propozimit të paraqitur nga Ministria në janar 2025, ishte e qartë se vërejtjet e paraqitura nga Agjencia në nëntor 2024 u pranuan dhe u përfshinë në Propozim-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Median, por se mbetet të sqarohen dhe specifikohen pjesë nga dispozitat. Prandaj, në janar, Agjencia paraqiti përsëri propozime konkrete në formë amandamenti, të cilat i referoheshin si vijon:

- në Propozim-ligjin ishte përcaktuar që regjistri, ndër të tjera, të përmbajë të dhënasë paku dy persona të punësuar tek botuesi në marrëdhënie të rregullt pune. Agjencia sugjeroj se kjo nuk ishte e nevojshme sepse numri i punonjësve është kusht për evidentim në regjistër;
- kushtet minimale kuadrore që duhet të përmbushin mediat online jofitimprurëse për t'u evidentuar në regjistër të jetë vetëm një person i punësuar në marrëdhënie të rregullt pune, duke marrë parasysh se në këto media personat që krijojnë përmbajtjet zakonisht angazhohen në bazë vullnetare;
- evidentimi në regjistër të kryhet në bazë të Kërkesës së paraqitur paraprakisht për regjistrim, forma dhe përmbajtja përcaktohet nga Agjencia;
- në vend siç ishte parashikuar në Propozim-ligj, mediat online – portalet e internetit një herë në vit të publikojnë të dhëna mbi pronësinë e gazetës ditore, Agjencia tregoi se transparencë më e madhe do të sigurohej nëse do të parashihej si detyrim një herë në vit rregullatorit t'i paraqesin të dhëna mbi pronësinë dhe financimin, ndërsa të dhënat Agjencia t'i publikojë në ueb-faqe, duke ofruar kështu që publiku në vazhdimësi të ketë akses të lehtë dhe të vazhdueshëm;
- të ndërrohet neni 4 nga LM, i cili përcakton ndalesat e veçanta, në mënyrë që të harmonizohet me nenin 48 të LShMAAV dhe me ndryshimin e Direktivës për shërbime mediatike audiovizuale të vitit 2018, në mënyrë që mos të ketë kushte të pabarabarta ligjore të punës së botuesve të mediave të shtypit dhe mediave online – internet portaleve, nga njëra anë dhe shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale nga ana tjetër;
- njëkohësisht, Agjencia theksoi nevojën për ndryshime gjithëpërfshirëse të LM në të ardhmen e afërt, me qëllim që të sigurohet harmonizim të këtij ligji me Aktin evropian për lirinë e medias dhe me dispozitat e tjera përkatëse evropiane.

Aktet nënligjore

- **Rregullore për formën dhe përmbajtjen e aplikimit për regjistrim në Regjistrin e botuesve të mediave online – internet portaleve dhe për mënyrën e udhëheqjes së Regjistrit të botuesve të mediave online – internet portaleve**

Në bazë të ndryshimeve të LM nga prill 2025, në të cilën Agjencisë i është dhënë detyrim të udhëheqë Regjistrin e Botuesve të mediave online - portaleve të internetit, në qershor Agjencia miratoi "Rregulle mbi formën dhe përmbajtjen e aplikimit për regjistrim në Regjistrin e botuesve të mediave online – internet portaleve dhe për mënyrën e udhëheqjes së Regjistrit të botuesve të mediave online – internet portaleve". Përpara se ta miratonte, Agjencia e vuri Draft-tekstin e rregullores në debat publik, duke u mundësuar palëve të interesuara të shprehin mendimet e tyre dhe të japin propozime në lidhje me të. Gjatë periudhës së debatit publik, u mbajt edhe një takim me përfaqësues të mediave online.

Po atë muaj Agjencia miratoi Formular për dorëzimin e të dhënave për të siguruar transparencë të punës së botuesve të mediave online – internet portaleve (Formular CYE/2), në të cilin botuesit janë të detyruar çdo vit t'i dorëzojnë rregullatorit të dhëna mbi strukturën pronësore, redaktorin përgjegjës, të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara dhe numrin e të punësuarve.

- **Rregullore për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve platformë për ndarjen e videove**

Në janar të vitit 2025, pas përfundimit të debatit publik me kohëzgjatje prej 30-ditësh, Agjencia miratoi Rregullore për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve platformë për ndarjen e videove, e cila rregullon formën dhe përmbajtjen e formularit të aplikimit që ofruesit e shërbimeve platformë për ndarjen e videove nën juridiksionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të paraqesin për t'u evidentuar në regjistrin që udhëhiqet nga Agjencia, si dhe të dhënat që do të përmbajë regjistri.

- **Rregullore për personat fizikë që ofrojnë shërbime mediatike audiovizuele me kërkesë (influenser/vlogerë/kreator)**

Gjatë vitit 2025, u hartuan dhe hynë në fuqi dokumente që operacionalizojnë dispozitat e LShMAAV që rregullojnë punën e influencerëve/vlogerëve/kreatorëve të përmbajtjeve që ofrojnë shërbime mediatike audiovizuele me kërkesë.

Përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe konsultativ, në të cilin në mënyrë aktive u përfshinë influencer si palë të interesuara, Agjencia në korrik miratoi Rregulloren për personat fizikë që ofrojnë shërbime me kërkesë (influenser/vlogerë/kreator), dhe u përgatitën dhe u publikuan udhëzime për zbatimin e rregullores. Aktivitetet u harmonizuan me trendet rregullatore evropiane dhe kontribuan në rregullimin dhe stabilizimin e tregut mediatik digjital.

Me qëllim që këto subjekte në mënyrë të thjeshtë të njihen me detyrimet që lidhen me mbrojtjen e të miturve, shënimin e komunikimeve komerciale, rregullat për publikimin e lojërave shpërblyese, sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara shqisore, ndalimin e përhapjes dhe nxitjes së diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes, u përgatit Udhëzues për influencer/e, vlogerë/e dhe kreator/e të përmbajtjeve Përgatitja e tij u parapri nga një hulumtim i gjerë mbi mënyrën se si këto çështje rregullohen në tokën evropiane përmes përdorimit të studimeve dhe dokumenteve të Observatorit Audiovizual Evropian dhe Këshillit të Evropës, konsultimeve me organet rregullatore evropiane dhe përdorimin e dokumenteve të tyre, si dhe komunikimit me influencerë me të cilët u mbajtën takime dhe, gjatë verës, atyre iu dha version pune i draftit-tekstit të Udhëzuesit. Pasi Këshilli i Agjencisë miratoi draftin, u hap një debat publik në kuadrin e të cilit organi rregullator mbajti edhe një takim me influencerët, me qëllim që t'u jepte mundësinë të bënin pyetje dhe të jepnin komente. Udhëzuesi përfundimtar u miratua dhe hyri në fuqi në fund të vitit.

MONITORIMI I PREZANTIMIT MEDIATIK TË ZGJEDHJEVE LOKALE

Një nga aktivitetet më të rëndësishme të Agjencisë në vitin raportues ishte monitorimi i prezantimit mediatic të Zgjedhjeve lokale të mbajtura në vitin 2025.

Në pajtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor (KZ), Agjencia është e detyruar: të monitorojë prezantimin mediatic zgjedhor të shërbimeve programore të transmetuesve nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundimin e tyre; nëse konstaton shkelje të dispozitave ligjore, duhet të iniciojë procedurë kundërvajtjeje para gjykatës kompetente në afat prej 48 orësh nga konstatimi i shkeljeve; dhe të paraqesë raporte mbi aktivitetet në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (javore në periudhën para fillimit të fushatës zgjedhore dhe ditore gjatë fushatës zgjedhore), të cilat do t'i publikojë në ueb-faqen e saj (neni 76-v i KZ). Agjencia gjithashtu duhet të publikojë në ueb-faqe dhe të dhëna mbi programet që Shërbimi publik radiodifuziv dhe stacionet televizive në nivel shtetëror do t'i vënë në dispozicion për personat me aftësi të kufizuara gjatë fushatës zgjedhore, dhe të monitorojë përmbushjen e detyrimeve të ndërrmarra prej tyre (neni 75 paragrafi 5 i KZ). Gjithashtu, në pajtim me nenin 76-d të KZ, Agjencia është e detyruar: të konfirmojë raportet mbi transmetimin e reklamave politike me pagesë (RPP) të transmetuara në afat prej pesë ditësh nga dita e dorëzimit të tyre; dhe të paraqesë Raport mbi reklamat politike me pagesë të transmetuara nga radiodifuzerët deri te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, në ditën e 20-të nga fillimi i heshtjes parazgjedhore për rrethin e parë dhe për rrethin e dytë, nëse mbahet.

Aktivitetet përgatitore të Agjencisë për monitorimin e prezantimit mediatic të Zgjedhjeve lokale të vitit 2025 filluan në korrik 2025. Monitorimi filloi më 10 gusht, pasi u shpallën zgjedhjet, dhe aktivitetet përfunduan me dorëzimin e Raportit mbi RPP të transmetuar në rrethin e dytë të fushatës zgjedhore në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve më 20 nëntor 2025. Megjithatë, zgjedhjet mbetën në fokus deri në fund të vitit, duke pasur parasysh se në katër komuna në rrethin e parë të Zgjedhjeve lokale nuk pati pjesëmarrje të mjaftueshme të votuesve, përkatësisht nuk u zgjodhën kryetarë komunash, prandaj më 17 nëntor 2025, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut shpalli Zgjedhje të përsëritura për kryetarë në komunat Gostivar, Vrapçisht, Mavrovë-Rostushë dhe Qendër Zhupë, të planifikuara për 11 janar 2026.¹

Aktivitetet për monitorimin e proceseve zgjedhore zbatohen në pajtim me *Metodologjinë për monitorimin e prezantimit mediatic zgjedhor nëpërmjet shërbimeve programore televizive dhe radio gjatë proceseve zgjedhore dhe udhëzimeve të Agjencisë*, të cilat kryesisht i referohen reklamave politike me pagesë. I gjithë procesi është i ndarë në disa faza për të cilat zbatohen detyrime të ndryshme ligjore për transmetuesit, prandaj u përgatitën pesë raporte grupore (mbi raportimin në periudhën para fillimit të fushatës zgjedhore, gjatë rrethit të parë dhe gjatë rrethit të dytë të zgjedhjeve, si dhe mbi RPP të transmetuara në rrethin e parë dhe të dytë të zgjedhjeve)² dhe disa raporte të veçanta mbi shkeljet e konstatuara. Në vazhdim janë paraqitur aspektet dhe gjetjet kryesore të monitorimit..

Parazgjedhore

¹ Më shumë detaje mbi Zgjedhjet e përsëritura lokale të vitit 2026 do të ofrohen në raportin e ardhshëm të Agjencisë për vitin 2026.

² Raportet e veçanta oficiale mbi fazat e të gjithë procesit zgjedhor janë të disponueshme në ueb0faqen e AshMA-së në fushën e veçantë [Zgjedhjet lokale](#).

Raporti i parë i Agjencisë për Zgjedhjet Lokale 2025 rezultoi nga monitorimi analitik për periudhën e të ashtuquajturës parazgjedhje - nga 10 gushti, pas shpalljes së zgjedhjeve, deri më 28 shtator, dita e fundit para fillimit të rrethit të parë të fushatës. Mostra për analizën përbëhej nga shërbimet programore ditore të nëntë televizioneve kombëtare: Shërbimi i parë dhe i dytë televiziv të Shërbimit Publik Radiodifuziv Radiotelevizioni i Maedonisë dhe shërbimet programore televizive komerciale të: Alsat-M, Alfa, Kanal 5, Sitel, Telma, 21-M dhe 24 Vesti. Për mediat e tjera, u ndërmorën veprime sipas parashtresave.

Përpara fillimit të fushatës zgjedhore, monitorimi u përqendrua në monitorimin e respektimit të parimeve të përgjithshme gazetareske për raportim objektiv (neni 47-a dhe neni 111 të LShMAAV), të cilat duhet të mundësojnë prezantim pluralist të opsioneve dhe mendimeve politike. Përveç kësaj, u monitorua respektimi i disa dispozitave të Kodit Zgjedhor që zbatohen gjatë periudhës parazgjedhore, duke përfshirë:

- A i shërbrn raportimi mbi aktivitetet e organeve shtetërore, organeve komunale dhe qytetit të Shkupi, institucioneve shtetërore dhe organizatave, si dhe personave juridikë dhe persona të tjerë të cilëve me ligj u është besuar ushtrimi i kompetenca publike – funksionit të prezantimit mediatic zgjedhor të dikujt (neni 75-b dhe neni 76-a paragrafi 12 nga KZ);
- A po respektohet ndalimi i përfaqësimit selektiv mediatic të programeve të destinuar për të mitur (neni 75, paragrafi 6 nga KZ);
- A marrin pjesë redaktorët, gazetarët, prezantuesit dhe moderatorët e programeve televizive dhe radio edhe në aktivitetet parazgjedhore të partive politike, koalicioneve apo kandidatëve (neni 75-v nga KZ);
- A po respektohet ndalimi i transmetimit të reklamave politike me pagesë (neni 75-d paragrafi 1 nga KZ);
- A transmetohen njoftimet për mbledhjen e nënshkrimeve në mbështetje të kandidaturave të kandidatëve të pavarur në pajtim me rregullat e përcaktuara (neni 75-d paragrafët 2 dhe 3 nga KZ);
- A po respektohet ndalimi i transmetimit të reklamave të financuara nga fondet buxhetore (neni 75-d paragrafi 4 nga KZ);
- A respektohen rregullat për publikimin e rezultateve nga hulumtimi i mendimit publik (neni 77 paragrafi 2 nga KZ);
- A transmetohen debatet në Shërbimin publik radiodifuziv (neni 76a paragrafi 11 nga KZ); dhe
- A po respektohen ndalesat e veçanta për diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes të përcaktuara në nenin 48 të LShMAAV.

Në periudhën nga shpallja e zgjedhjeve deri në fillimin e fushatës zgjedhore, nuk u konstatua shkelje e dispozitave të KZ. Në përgjithësi, nga një perspektivë mediatike, përmbajtja parazgjedhore u reduktuan në një raport publik mbi punën e bërë nga qeverisja aktuale lokale dhe në akuza dhe justifikime ndërpartiake - qoftë për mundësi politike të humbura nga mandati i kaluar, qoftë për mungesën aktuale të zbatimit të detyrimeve të kompetencave në nivele të ndryshme të qeverisë (ekzekutive) - nga ministritë, përmes administratës shtetërore, deri te organet e vetëqeverisjes lokale. Gjatë gjithë periudhës parazgjedhore, vëmendje e veçantë mediatike - kryesisht me lajme të njëpasnjëshme, deklaratat dhe intervista të shkurtra - i kushtua pasigurisë parazgjedhore në lidhje me statusin dhe mundësitë zgjedhore të kandidatëve të pavarur, përkatësisht vazhdimësisë së përpjekjeve të tyre organizative dhe përpjekjeve për performancë të mundshme kolektive zgjedhore përmes një platforme të përbashkët politike. Disa nga fragmente në periudhën parazgjedhore rezultuan nga aktivitetet e Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KShZ) në lidhje me Listën e votuesve, plotësimin e listave të kandidatëve për kryetarë bashkie dhe këshilltarë, dhe disa lidheshin me spekulime partiake rreth koalicioneve të mundshme dhe pritjet e komunikuesve rreth (jo)kulturës së komunikimit politik në fushatën zgjedhore. Jashtë temës së zgjedhjeve, pothuajse i gjithë angazhimi gazetaresk në verën e vitit 2025 ishte i preokupuar me analiza të përditshme të pasojave ekonomike dhe shëndetësore-ekologjike të pastërtisë dhe shkallës së zjarreve që shpërthyen në disa zona të vendit, deri në atë masë sa zyrtarë të caktuar

të qeverisë ekzekutive i përshkruan si një lloj "ekoterrorizmi" me dimensione të një "luftë speciale" dhe një "sulmi hibrid/shumëpartiak", kështu që pritej zjarret të nxisnin edhe kundër-reagime partiake parazgjedhore. Prandaj, angazhimi informativ gazetaresk në përgjithësi ka qenë në analizën e dekadave të mosfunksionimit – mungesës së pajisjeve dhe mungesës së përditësimit të institucioneve ekzistuese të qeverisjes lokale dhe shtetërore.

Mund të thuhet se stacionet televizive të analizuara gjatë periudhës parazgjedhore iu përmbajtën parimit të prezantimit objektiv dhe të paanshëm të ngjarjeve socio-politike (neni 47-a, paragrafi 1, nënparagrafi 9 të LShMAAV), me trajtim të barabartë të pikëpamjeve dhe mendimeve të ndryshme, duke i mundësuar kështu publikut të gjerë të formojë në mënyrë të pavarur mendime dhe qëndrime. Gjatë periudhës parazgjedhore, redaksitë informative të stacioneve televizive Alfa, Kanal 5, 21-M, Sitel, 24 Vesti dhe Telma bënë përpjekje që zgjedhjet t'i përpunojnë dhe nëpërmjet emisioneve informative: intervistave, debateve dhe llojeve të tjera të emisioneve informative.

Mënyra e raportimit në rrethin e parë zgjedhor të ZL25

Monitorimi i raportimit mediatik mbi aktivitetet zgjedhore nga rrethi i parë i Zgjedhjeve lokale u realizua nga 29 shtatori deri më 17 tetor. Mostra metodologjike u zgjerua në 11 stacione televizive kombëtare me programe në gjuhën shqipe dhe maqedonisht, përkatësisht u përfshinë: tre shërbime programore nga ShPR RTM (RTM1, RTM2 dhe Kanali kuvendor) dhe tetë shërbime programore komerciale: (Alsat-M, Alfa, Kanal 5, Sitel, Telma, 24 Vesti, 21-M dhe Shenja). Veprimi për shkelje të mundshme nga shërbimet programore të të gjithë transmetuesve të tjerë ekzistues u realizua në bazë të ankesave.

Me monitorim të përfaqësimit mediatik zgjedhor gjatë fushatës zgjedhore, Agjencia monitoron nëse transmetuesit:

- Në lajme respektuan parimet kvantitative dhe kualitative për arritjen e balansit në raportim për fushatat e pjesëmarrësve në procesin zgjedhor. Në pajtim me nenin 75-a nga KZ3, balansi në mënyrë kvantitative sigurohet nëse – për zgjedhjen për kryetar bashkie respektohet parimi i barazisë (kohë afërsisht të barabartë ndërmjet kandidatëve), dhe për zgjedhje të anëtarëve të këshillit – parimin e proporcionalitetit (kohë afërsisht të barabartë ndërmjet pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore me të njëjtin numër listash të kandidatëve të konfirmuar dhe afërsisht të njëjtin intesitet të fushatës). Në mënyrë kualitative, balansi arrihet me qasje identike, përkatësisht të tonit në raportim dhe kuadrit;
- Respektuan ndalimin sipas të cilit raportimi mbi aktivitetet e organeve qeveritare nuk duhet të jetë në funksion të përfaqësimit mediatik zgjedhor të asnjë subjekti politik gjatë gjithë periudhës, që nga shpallja e zgjedhjeve deri në përfundimin e tyre (neni 75-b nga KZ);
- Në emisionet e veçanta informative për zgjedhjet respektuan rregullin për sigurimin e balansit, trajtim të drejtë dhe të paanshëm (neni 75 nga KZ);
- ShPR dhe televizionet në nivel shtetëror respektuan detyrimet për informimin e procesit zgjedhor për personat me aftësi të kufizuara (neni 75 nga KZ);
- Respektuan rregullin që redaktorët, gazetarët, drejtuesit e programeve dhe prezantuesit e angazhuar në përgatitjen e programeve nuk mund njëkohësisht të marrin pjesë në aktivitete parazgjedhore të partive dhe koalicioneve, përkatësisht të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor (neni 75-v nga KZ);
- Respektuan rregullat për publikimin e rezultateve të hulumtimit të mendimit publik (neni 77 nga KZ);
- Respektuan rregullat për transmetim të reklamave politike me pagesë, të cilat i referohen: kufijve të lejuar për RPP të pjesëmarrësve në zgjedhje dhe në kohë reale transmetim të programit, si dhe për bashkimin e RPP në dy orë në kohë reale (neni 75-gj nga KZ); për shënim të qartë të porositesit të reklamës; për shkak se RPP

nuk transmetohet në programe të veçanta informative, në programe arsimore për fëmijë dhe në transmetim të ngjarjeve fetare, sportive, kulturore, argëtuese dhe të tjera; se në RPP nuk mund të marrin pjesë të miturit; dhe se programet e veçanta informative nuk duhet të shfrytëzohen si RPP (neni 76 nga KZ);

- Respektuan ndalimin e transmetimit të reklamave të financuara nga fondet buxhetore (neni 75-d nga KZ);
- Shërbimi publik radiodifuziv shpërndan kohën e lejmeve sipas rregullit: 30 % të kohës për ngjarjet e përditshme nga vendi dhe bota, 30 % për aktivitetet e partive politike në pushtet, 30 % për aktivitetet e partive politike në opozitë dhe 10% për aktivitetet e partive politike jashtëparlamentare dhe kandidatëve të pavarur (neni 76-a nga KZ);
- ShPR transmeton emisione debatuuese/ballafaqim të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor (neni 76-a nga KZ);
- ShPR dhe Kanali i Kuvendit respektojnë rregullat për transmetim të përfaqësimit politik papagesë (neni 76-a nga KZ);
- Respektuan ndalimet e veçanta për nxitjen e urrejtjes dhe intolerancës (neni 48 të LShMAAV);
- Respektuan detyrimin gjatë procesit zgjedhor, korigjimin, përkatësisht përgjigjen e informacioni të publikuar t'i publikojnë në emisionin e radhës, përkatësisht në programin e parë të radhës të llojit të njëjtë, menjëherë pas pranimit të korigjimit ose përgjigjesh (nenet 19 dhe 27të Ligjit për Mediat).

Prandaj, fokusi i monitorimit të Agjencisë ishte në lajmet dhe reportazhet nga edicionet qendrore të lajmeve televizive, pastaj intervistat dhe debatet mbi temat zgjedhore, si dhe përshtatja e tyre për personat me aftësi të kufizuara shqisore, por edhe reklamat politike të paguara (PPA) dhe mundësitë për përfaqësim politik falas (FPP).

Në raundin e parë të zgjedhjeve morën pjesë 153 kandidatë, të mbështetur nga: 9 parti/koalicionet parlamentare; 24 parti/koalicionet joparlamentare, si dhe 120 kandidatë të pavarur. Në vetvete, ky vëllim pjesëmarrësish në fushatën zgjedhore i vuri një detyrë të pamundur redaksive gazetareske - të zbatonin profesionalisht dhe në mënyrë të vazhdueshme parimet e IZ-së për trajtim të barabartë dhe proporcional mediatic të secilit prej kandidatëve, qoftë për kryetar bashkie apo këshilltar bashkiak.

Sipas (para)kushteve të mësipërme, përfundimi i monitorimit ishte se - gjatë raundit të parë zgjedhor, shumica e redaksive, mjaft të pritshme, e përqendruan vëmendjen e tyre te kandidatët e mbështetur nga partitë parlamentare dhe/ose partnerët e tyre të koalicionit (VMRO-DPMNE në pushtet dhe VLEN; në krahasim me LSDM dhe NAI të opozitës), dhe dukshëm më pak hapësirë mediatike iu dha kandidatëve të pavarur dhe atyre të mbështetur nga partitë joparlamentare. Një përpjekje më e dukshme editoriale për një prezantim pluralist të ofertave politike zgjedhore u regjistrua në MRT1, MRT2, TV Alfa, TV Kanal 5 dhe TV Telma.

Rreptësisht në temën e Zgjedhjeve Vendore 2025, gjatë fushatës për raundin e parë zgjedhor, kanalet televizive Alsat-M, Sitel dhe Alfa i kushtuan më shumë kohë lajmeve televizive. Mediat e analizuar raportuan kryesisht në mënyrë neutrale. Dhjetë redaksi organizuan dhe transmetuan intervista me pjesëmarrës në fushatën zgjedhore, dhe ekipi gazetaresk i TV Alsat-M mori drejtimin në këtë angazhim. Stafi redaktues i TV 24 Vesti dhe TV Telma realizoi më shumë përballje debatuese.

Raportimi mbi zgjedhjet në një format të kuptueshëm për personat me aftësi të kufizuara shqisore është detyrim për JRS MRTV (MRT1 dhe MRT2), si dhe për televizionet kombëtare komerciale që transmetojnë PPR (neni 75 paragrafët 4 dhe 5 të IZ). Të gjitha televizionet e detyruara, që para fillimit të fushatës zgjedhore, e njoftuan AVMU-në për programet e tyre të përshtatura teknikisht, pas së cilës u përgatit një pasqyrë e përshtatshme me tituj specifikë dhe orare transmetimi të programeve, e publikuar në kohën e duhur në faqen e internetit të AVMU-së. Monitorimi tregoi se televizionet e përmbushën detyrimin e treguar ligjor.

Me kriteret metodologjike të pandryshuara dhe përfshirje të njëjtin të mostrës së analizuar të stacioneve televizive, monitorimit të përfaqësimit mediatic të 66-të kandidatëve për kryetarë bashkie që kaluan në rrethin e dytë zgjedhor zgjati nga 20 deri më 31 tetor.

Në shpërndarjen e kohës televizive për prezantimin e kandidatëve për kryetarë bashkie, asnjë redaksi informative nuk arriti të përmbushte kërkesën ideale ligjore të përcaktuar nga KZ për barazi. Vetëm redaksitë e RTM1 dhe RTM2 arritën t'i përmbahen detyrimeve të veçanta ligjore për strukturimin e programeve të informative ditore në kushte zgjedhore sipas formulës matematikore 30 % + 30 % + 30 % + 10 %.

Përfundimi i përgjithshëm i monitorimit të AShMA-së është se shërbimet programore të analizuar të ShPR RTM dhe tetë televizioneve komerciale të mbuluara nga monitorimi - u përpoqën, varësisht nga kapacitetet e tyre prodhuese, kadrovike dhe teknike, përmes lajmeve, intervistave dhe debateve të paraqesin një pamje sa më të gjerë të mjedisit ekzistues socio-politik në të cilin u zhvillua fushata zgjedhore, përkatësisht investuan angazhim profesional gazetaresk për të ofruar informacione të hollësishme për shumicën e kandidatëve për kryetarë bashkie. Në përgjithësi, disa redaksi informative u përpoqën të paraqisnin më shumë kandidatë, ndërsa të tjera, si në ciklet e mëparshme zgjedhore, u përqendruan në kandidatët e mbështetur nga katër koalicionet kryesore - VMRO-DPMNE, LSDM, VLEN, NAI, dhe politika editoriale e disa redaksive, nga ana tjetër, ishte e kufizuar ekskluzivisht në kandidatët për kryetarë bashkie nga komunat e Shkupit, si dhe rivalët për kryetari bashkie të Shkupit.

Sa i përket emisioneve informative të veçanta - 9 nga 11 shërbime programore televizive transmetuan intervista dhe debate mbi temat zgjedhore, në të cilat, përveç pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë në procesin zgjedhor, mendimet e tyre shprehën edhe politologë/analistë të skenës politike në vend. Sa i përket numrit të intervistave të realizuara dhe debateve me kandidatët për kryetarë bashkie, në krye ishin stacionet televizive Sitel, Telma dhe Kanal 5.

Të gjitha stacionet televizive që ndoqën në mënyrë aktive rrjedhën e rrethit të dytë të fushatës zgjedhore, për personat me aftësi të kufizuara shqisore teknike kanë përshtatur një nga edicionet e tyre të emisionit të lajmeve dhe një edicion javor të ndonjë prej emisioneve të tyre aktuale-informative (intervistë/debat).

Heshtje zgjedhore

Heshtja zgjedhore në rrethin e parë të zgjedhjeve përfshinte periudhën nga mesnata e 18 tetorit deri në orën 19:00 të 19 tetorit, dhe në rrethin e dytë nga mesnata e 1 nëntorit deri në orën 19:00 të 2 nëntorit. Sipas dispozitave (neni 76-b i Kodit Zgjedhor), redaksitë gjatë këtyre periudhave të procesit zgjedhor nuk lejohen të publikojnë përmbajtje që janë në funksion të ndonjë fushate politike, përkatësisht përmbajtje që mund të ndikojë mbi vullnetin zgjedhor të qytetarëve.

Mostra për analizë gjatë heshtjes në rrethin e parë u zgjerua, kështu që përveç 11-të televizioneve kombëtare, u përfshinë edhe shërbimet televizive rajonale të Shkupit: Edo, Era, Shutel, Vistel dhe MTM (Prva Skopska). Në rrethin e parë katër redaksi nuk e respektuan heshtjen: televizionet kombëtare 24 Vesti dhe 21-M dhe televizionet rajonale Vistel dhe Shutel. Kundër tyre, në afatin e parashikuar ligjor, AShMA paraqiti kërkesa për inicim të procedurës kundërvajtëse.

Ekzemplar për analizë gjatë heshtjes në rrethin e dytë, gjithashtu u zgjerua dhe përveç 11-të stacioneve televizive kombëtare, ajo përfshinte edhe stacionet televizive në komunat ku kishte zgjedhje në rrethin e dytë. Nuk u konstatuan shkelje të heshtjes zgjedhore në rrethin e dytë të fushatës.

Përfaqësimi politik papagesë (PPP)

Edhe në këtë proces zgjedhor, pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore treguan shumë pak interes për të shfrytëzuar të drejtën ligjore (neni 76-a, paragrafët 5, 6, 7, 8 dhe 9 të Kodit Zgjedhor) për përfaqësimin e tyre politik papagesë në shërbimet programore të RTM1, RTM2 dhe/ose Kanalit Kuvendor. Në RTM1, mundësinë në këtë mënyrë për t'u prezantuar para votuesve e shfrytëzuan 26 kandidatë, me një kohëzgjatje në total prej 54 minuta dhe 56 sekonda; në RTM2 - dy kandidatë me një kohëzgjatje në total prej 5 minuta dhe 44 sekonda; dhe në Kanalën Kuvendor 13 pjesëmarrës në fushatën zgjedhore me një kohëzgjatje në total prej 3 orë 49 minuta dhe 12 sekonda.

Mungesa e interesit për RPP ishte edhe më e theksuar në rrethin e dytë, kur gjithsej u transmetuan rreth 43 minuta RPP, dhe vetëm në Kanalën e kuvendit nga ShPR RTM, të ndara midis kandidatëve për kryetarë bashkie të mbështetur nga dy rivalët kryesorë politikë – në pushtet VMRO-DPMNE dhe LSDM në opozitë. Asnjë kandidat i zgjedhjeve lokale²⁵ nuk e shfrytëzoi mundësinë për RPP që u ofrohej si RTM1 ashtu edhe RTM2.

Reklamim i paguar politik (RPP)

Monitorimi i RPP në rrethin e parë të fushatës zgjedhore përfshiu 68-të transmetues (33 stacione televizive dhe 35 radio), të cilët lidhën kontratë për këtë lloj përfaqësimi zgjedhor dhe ishin të regjistruar në Regjistrin për RPP që udhëhiqet nga KShZ.

Midis të gjithë 68-të transmetuesve, më shumë kohë për RPP blenë: Koalicioni Tvoja makedonija, udhëhequr nga VMRO-DPMNE; Koalicioni Aleanca Kombëtare për Integrim - AKI, udhëhequr nga BDI; Koalicioni për Zgjedhjet lokale 2025, udhëhequr nga LSDM, dhe Koalicioni Vlen.

Në rrethin e parë të zgjedhjeve, limiti për transmetim të RPP (neni 75-gj, paragrafi 1 i Kodit Zgjedhor) u tejkalua vetëm nga TV Gurra, pas së cilës AShMA kundër tij paraqiti kërkesë për inicim të procedurës kundërvajtëse.

Në rrethin e dytë të fushatës, gjithsej 41 transmetues, nga të cilët 22 televizione dhe 19 radio, lidhën kontratë me pjesëmarrësit në zgjedhje. Hapësira mediatike për RPP u ble kryesisht nga katër koalicionet kryesore të udhëhequra nga VMRO-DPMNE, LSDM, AKI dhe VLEN. Në një masë më të vogël, në këtë mënyrë u përfaqësuan në media dhe kandidatët e pavarur për kryetarë të komunave Kumanovë dhe Strugë.. Në këtë fazë të zgjedhjeve nuk u regjistruan shkelje të KZ lidhur me RPP.

Parashtresa në lidhje me ZL25

Para fillimit të fushatës zgjedhore, një media online reagoi ndaj regjistrimit të TV Gurra në Regjistrin e KShZ për transmetimin e reklamave politike me pagesë, duke ia dërguar komunikimin e saj Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve në lidhje me përmbajtjen e listës së çmimeve të stacionit televiziv për reklamim të paguar politik (RPP) për Zgjedhjet lokale të vitit 2025. Agjencia informoi dërguesin për reagimin se nuk ka kompetenca mbi Regjistrin e udhëhequr nga KShZ, por edhe se asnjë nga zhanret gazetareske (fragment, emision) ligjërisht nuk mund të shfrytëzohet për reklamim të paguar politik, dhe se, nëse gjatë fushatës zgjedhore stacioni televiziv transmeton zhanër gazetaresk si RPP, Agjencia do të ndëmarrë masat përkatëse ligjore.

Gjatë rrethit të parë të zgjedhjeve, në AShMA u dorëzuan dy parashtresa. E para ishte nga kandidat i partisë Levica për kryetar të komunës Koçan, i cili akuzoi stafin redaktues të Radios lokale Koçanë për selektim, përkatësisht për trajtim të pabarabartë ndaj gjashtë kandidatëve për vetëqeverisje lokale të cilët nëpërmjet radios duhej të debatoheshin

rreth ofertës të tyre programore. Pas një reagimi nga ASHMA-ja, redaksia e radios me telefon dhe me e-mail konfirmoi se kishte planifikuar tre duele ndarazi për përballje për shkak sepse nuk kishte kushte të përshtatshme në studio për një debat ndërmjet gjashtë pjesëmarrësve në procesin zgjedhor. Parashresa e dytë u paraqit nga Koalicioni VLEN kundër një gazetari nga portali i internetit *TetovaSot*, duke e akuzuar për raportim të anshëm dhe devijim nga standardet profesionale të gazetarëve - të gjitha në favor të kandidatit për kryetar të Koalicionit rival të Aleanca Kombëtare për Integritet – AKI. ASHMA iu përgjigj parashtresës së ankesës në kohën e duhur se - as sipas Kodit zgjedhor dhe as sipas Ligjit për Median (LM) - nuk ka kompetencë për të vepruar mbi publikimet në mediat online, por pas parashtresës u mor vendim në kuadër të Organit Koordinues për monitorimin e respektimit të Kodeksit të sjelljes në hapësirën online gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve³.

Udhëzim për transmetuesit

Si zakonisht, si për Zgjedhjet lokale të vitit 2025 ashtu edhe për Zgjedhjet e përsëritura për kryetarë bashkie në katër komuna, Agjencia hartoi udhëzime për transmetuesit në të cilat shpjegoi se si, në pajtim me karakteristikat e procesit konkret zgjedhor, ata duhet të zbatojnë dispozitat e Kodit Zgjedhor në lidhje me: ndarjen e kohës për reklamim të paguar politik (RPP) - neni 75-gj paragrafi 1; shënjimin e porositesit të reklamës - neni 76; ndarjen e kohës në lajme në Shërbimin Publik Radiodifuziv (ShPR) - neni 76-a paragrafi 2; prezantimin politik papagesë të Shërbimit Programor të destinuar për transmetimin e aktiviteteve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut - neni 76-a paragrafi 8; dhe sigurimin e aksesit të përmbajtjes për procesin zgjedhor - neni 75 paragrafët 1 dhe 4.

Gjatë përgatitjes së Udhëzimit për transmetuesit për Zgjedhjet lokale të mbajtura në tetor, u përcaktua se formulimi i nenet 75-gj paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor në lidhje me ndarjen e kohës për RPP do të çonte në përjashtimin e partive politike Levica dhe ZNAM, të cilat kanë grupet e tyre parlamentare në Kuvend, por nuk janë ndër katër partitë më të mëdha në qeveri dhe opozitë. Për këtë shkak, Agjencia nisi takime konsultative me institucionet e tjera kompetente për zbatimin e KZ: Komisionin Shtetëror Zgjedhor, Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit dhe Enti shtetëror për revizion. Si rezultat, katër institucionet dërguan shkresë të përbashkët Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në të cilën raportuan për pasaktësitë dhe i bënë thirrje Ligjvënësit të ndërmarrë veprime për të rregulluar në mënyrë të përshtatshme këtë çështje. Megjithatë, këto dispozita të KZ mbetën të pandryshuara. Kjo, gjatë procesit zgjedhor, çoi në reagime dhe padi të shumta nga Partia e Majtë kundër Agjencisë, por të gjitha instancat gjyqësore dhe institucionet e tjera konfirmuan se Agjencia nuk kishte zgjidhje tjetër përveç zbatimit në vazhdimësi të Kodit.

Për zgjedhjet e përsëritura për kryetar bashkie në komunat Gostivar, Vrapçisht, Mavrovë-Rostushë dhe Qendër Zhupë, u hartua udhëzim i ri në të cilat ky problem nuk u shfaq sepse të dy partitë nuk kishin kandidatë të tyre për kryetar bashkie.

Për qëllim harmonizimit me dispozitat e KZ dhe praktikën e veprimit, përpara fillimit të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet lokale, Agjencia bëri ndryshime dhe plotësime të Udhëzimit për konfirmimin e raporteve për transmetimin e reklamave politike me pagesë.

³ Gjatë kohës së ZL25, Trupi koordinues i Kodeksit të sjelljes në hapësirën online gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve miratoi konkluzione për gjithsej tetë parashtresa në lidhje me: dezinformim; publikime të pasakta në mediat online; komunikime të papërshtatshme dhe ofenduese në rrjetet sociale; akses të pabarabartë në hapësirën online dhe keqpërdorim të faqeve zyrtare për promovim zgjedhor. Për këtë proces zgjedhor, Kodit iu bashkuan dhe: Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut; redaksia e PressOnline.mk dhe StrumicaNet.mk; partitë politike „Desnica“ dhe „bashkimi Demokratik“; dhe 4 grupe votuesish. Përndryshe, Trupi koordinues përfshin përfaqësues të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (ShGM), Këshilli i Etikës në Media të Maqedonisë (KEMM), Instituti Maqedonas për Media (IMM), Instituti i Studimeve të Komunikimit (ISK), Fondacioni Metamorfozis dhe ASHMA. Për më shumë informacion rreth Trupit dhe konkluzioneve të arritura mbi parashtresat e pranuar janë të disponueshme në: <https://izborenkodeksonline.mk>.

Aktivite të tjera lidhur me zgjedhjet

Gjatë proceseve zgjedhore, Agjencia menjëherë me shkrim u kujtoi transmetuesve detyrimet që duhej të përmbushnin në secilën fazë: periudhën parazgjedhore, fushatën, heshtjen, publikimin e rezultateve të anketave, etj.

Gjithashtu zhvilloi takime dhe komunikime të rregullta me Misionin vëzhgues tzgjedhor të OSBE/ODIHR-it, veçanërisht me analistin e tyre të medias. Ndërkohë, në kohë dhe detajisht iu përgjigj të gjitha pyetjeve dhe shkresave të tjera mbi temën zgjedhje.

Me qëllim avancimin e procesit të monitorimit, me mbështetje financiare nga IFES, Agjencia inicoi përgatitjen e një softueri të ri për njohjen automatike të RPP. Softueri pritet të jetë funksional deri në fund të vitit 2026.

Zgjedhje të përsëritura për kryetar komune në komunat Gostivar, Vrapçisht, Mavrovë – Rostushë dhe Qendër Zhupë

Në katër komuna, në rrethin e parë të Zgjedhjeve lokale, nuk pati pjesëmarrje të mjaftueshme të votuesve, përkatësisht nuk u zgjodh asnjë kryetar komune, prandaj më 17 nëntor 2025, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut shpalli Zgjedhje të përsëritura për kryetar në komunat: Gostivar, Vrapçisht, Mavrovë-Rostushë dhe Qendër Zhupë, caktuar për më 11 janar 2026. Fushata zgjedhore për këto zgjedhje filloi më 22 dhjetor 2025 dhe zgjati deri më 9 janar 2026. Duke pasur parasysh faktin se kishte më pak komuna dhe fushatë me intensitet të ulët të udhëhequr vetëm nga shtatë kandidatë, metodologjikisht u vendos - për mënyrën e raportimit, të kryhet monitorim në bazë të parashtrësive për parregullsi të mundshme, ndërsa për transmetimin e RPP, monitorimi u krye mbi të gjithë transmetuesit që kishin lidhur kontrata për transmetim. Në KShZ janë regjistruar 13 televizione dhe 5 radio por RPP transmetuan vetëm 7 televizione dhe 2 radio.. Deri në fund të vitit 2025 nuk pati shkelje apo parashtrësia. Të gjitha informacionet e tjera do të ofrohen në Raportin e vitit 2026.

DETYRIME PROGRAMORE DHE TË TJERA TË TRANSMETUESVE

Si gjithmonë, respektimi i detyrimeve nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Ligjit për Median, akteve nënligjore, si dhe detyrimeve të përcaktuara në lejet për transmetim, Agjencia i ndjek nëpërmjet mbikëqyrjeve të rregullta, të jashtëzakonshme dhe kontrolluese me karakter programor dhe administrativ. Në vitin raportues, u kryen mbi 300 mbikëqyrje të transmetuesve.

Mbikëqyrje programore

Mbikëqyrje të rregullta, të cilat ishin parashikuar nga Plani Vjetor për kryerje të mbikëqyrjes programore në vitin 2025, u realizuan plotësisht. Përveç tyre, u realizuan disa mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore, të iniciuara sipas detyrës zyrtare, si dhe mbikëqyrje kontrolli në rastet kur u shqiptuan masa paralajmërimi publik për shkelje të konstatuara. Për disa nga masat paralajmim publik të shqiptuara në vitin 2025, mbikëqyrje kontrolli u realizuan në vitin 2026, kur skadoi afati për harmonizimin e transmetuesve të përcaktuar në aktvendimet për shqiptimin e masës.

Prandaj, ato nuk janë përfshirë në këtë Raport. Prandaj, mbikëqyrjet programore në vitin 2025 rezultuan në total prej 117 raportesh individuale - 91 nga mbikëqyrjet e rregullta, 25 nga kontrollet dhe 1 nga mbikëqyrje e jashtëzakonshme.

Në përmbledhjen e të gjitha mbikëqyrjeve programore të dhëna në vazhdim, ato paraqiten muaj pas muaji, në pajtim me periudhën në të cilën janë përfunduar. Përmbledhja nuk përfshin vetëm mbikëqyrjet që lidhen me respektimin e standardeve profesionale në raportim dhe ndalimin e nxitjes së gjuhës së urrejtjes, të cilat janë vendosur në kapitullin “Promovimi i lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias”.

Mbikëqyrjet e rregullta u zbatuan mbi respektimin e katër grupeve të detyrimeve nga LShMAAV dhe akteve nënligjore përkatëse, përkatësisht dispozitat për: **1. Transmetimi i komunikimeve komerciale audio dhe audiovizuale** (neni 53 – Rregullat e përgjithshme për transmetimin e komunikimeve komerciale; neni 54 – Sponsorizimi; neni 55 – Plasim i produkteve; neni 98 – Kushtet për reklamim dhe teleshoping; neni 99 – Mënyra e reklamimit dhe teleshoping; neni 100 – Kohëzgjatja e spoteve reklamuese dhe teleshoping dhe neni 101 – Ndalimi i pjesëmarrjes në reklama dhe teleshoping nga persona të caktuar); **2. Mbrojtja e të miturve nga programet që mund të dëmtojnë zhvillimin e tyre fizik, mendor ose moral** (neni 50 – Mbrojtja e të miturve dhe neni 50-a - Mbrojtja e të dhënave personale të të miturve); **3. Promovimi dhe mbrojtja e identitetit kulturor** (neni 64 – Përdorimi i gjuhës; neni 80 – Detyrimet e ndërmarra vullnetarisht për transmetimin e muzikës vendase, neni 91 – Veprat audiovizuale evropiane dhe veprat nga producentë të pavarur dhe neni 92 – Muzika vendase të ShPR dhe veprat audiovizuale maqedonase në televizion) dhe **4. Detyrimet e tjera programore** (neni 52 – Ofrimi i kuizeve ose programeve të tjera me pjesëmarrje shpërblyese; neni 90 – Kohëzgjatja e transmetimit ditor nga transmetuesit; neni 93 – Shërbimet telefonike me vlerë të shtuar dhe votimi telefonik dhe neni 94 – Transmetimi i lojërave të fatit).

Janar

- **Mbikëqyrje të rregullta programore** mbi shërbimet programore televizive të Shërbimit Publik Radiodifuziv (RTM1, RTM2, RTM3, RTM4 dhe RTM5). Nga mbikëqyrjet nuk u konstatuan shkelje.

Shkurt

- **Mbikëqyrje të rregullta programore** mbi shërbimet programore në radio të Shërbimit Publik Radiodifuziv (MPA1, MPA2 dhe MPA3), gjatë të cilave nuk u konstatuan shkelje.
- **Tre mbikëqyrje të kontrollit programor** mbi TV Due për respektim të:
 - Neni 92, paragrafët (1) dhe (3) të LShMAAV (transmetimi i një përqindjeje të caktuar të programeve të krijuara burimore). Mbikëqyrja konstatoi se transmetuesi pjesërisht veprroi sipas aktvendimit për shqiptimin e masës - paralajmërim publik, përkatësisht ka mënjanuar shkeljen e kryer të nenit 92, paragrafi (3) të LShMAAV, por vazhdoi të kryente shkeljen e nenit 92, paragrafi (1) të LShMAAV, për shkak të së cilës u shqiptua masë paralajmërim publik;
 - Neni 64, paragrafi (1) të LShMAAV (përdorimi i gjuhës). Mbikëqyrja konstatoi se transmetuesi iplotësisht ka vepruar sipas masës së shqiptuar dhe ka mënjanuar shkeljen;
 - Neni 50, paragrafi (3) të LShMAAV (mbrojtja e të miturve) dhe nenet 16, 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve. Mbikëqyrja konstatoi se transmetuesi kishte mënjanuar vetëm shkeljen e nenit 16 (periudhën kohore për transmetimin e kategorive të ndryshme programore), por vazhdoi të shkelte nenet 20 dhe 21, të cilat i referohen mënyrës së aplikimit, pamjes dhe përmbajtjes së sinjalistikës paralajmëruese të Rregullores për mbrojtjen e të miturve, për këtë shkak u shqiptua masë paralajmërim publik.

- **Dy kontrolle të mbikëqyrjes programore** mbi TV News për respektim të:
 - Nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të LShMAAV (programi i krijuar burimor); dhe
 - Nenit 50, paragrafi (3) të LShMAAV (mbrojtja e të miturve) dhe nenet 17 dhe 19 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.

Nga dy mbikëqyrjet u konstatua se transmetuesi plotësisht i kishte mënjanuar shkeljet.

- **Mbikëqyrja e kontrollit programor** mbi TV Protel për respektim të nenit 50, paragrafi (3) të LShMAAV (mbrojtja e të miturve) dhe nenet 16, 17 dhe 19 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve. Nga mbikëqyrja u konstatua se transmetuesi plotësisht ka vepruar sipas masës së shqiptuar.
- **Mbikëqyrja e kontrollit programor** mbi TV Spektra për respektim të nenit 50, paragrafi (3) të LShMAAV (mbrojtja e të miturve) dhe nenet 16 dhe 17 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve, ku është përcaktuar se televizioni ka mënjanuar shkeljen. Meqenëse gjatë mbikëqyrjes së kontrollit u konstatua se mediumi shfrytëzoi sinjalizim të paplotë gjatë shënimit të programeve që mund të dëmtojnë të miturit, drejtuar TV Spektra iu dërgua shkresë duke shpjeguar se cilat mangësi janë regjistruar gjatë shënimit të programeve dhe njoftimeve vetëpromovuese dhe si t'i korrigjojnë.
- **Mbikëqyrja e kontrollit programor** mbi TV Star për respektim të nenit 50, paragrafi (3) të LShMAAV (mbrojtja e të miturve) dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve, e cila tregoi se transmetuesi veproi sipas masës.

Mars

- **Mbikëqyrje e rregullt programore** mbi shërbimet kombëtare të programeve televizive komerciale satelitore (Nasha TV dhe TV 24 Vesti). Nga mbikëqyrjet u konstatua shkelje tek: Nasha TV - të nenit 98, paragrafi (2) të LShMAAV dhe nenit 14, paragrafi (4) të Rregullores për teknikat e reja të reklamimit (mbi transmetimin e reklamave në ekran të ndarë); dhe në TV 24 Vesti - të nenit 55, paragrafi (2), nënparagrafët 2, 3 dhe 4 të LShMAAV (kushtet për plasim të produkteve) dhe të neneve 25 dhe 26 (shënim të plasimit të produkteve) të Udhëzimit për plasim të produkteve.
- **Mbikëqyrje të rregullta programore** mbi shërbimet kombëtare të programeve televizive komerciale (TV 21 - M, TV Shenja, TV Klan Macqedoni dhe TV Sonce), të cilat transmetohen përmes operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik (ORRPKE). Nga mbikëqyrjet u konstatuan shkelje tek TV Klan, TV Shenja dhe TV 21-M. TV Klan për shkelje të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të LShMAAV (programi i krijuar burimor) dhe nenit 50, paragrafi (3) të LShMAAV, dhe në lidhje me nenin 16 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve. Në rastin e TV Shenja, shkelja i referohej nenit 92, paragrafëve (1) dhe (3) të LShMAAV (programi i krijuar burimor), dhe në rastin e TV 21-M – të nenit 98, paragrafi (2) të LShMAAV, dhe në lidhje me nenin 14, paragrafi (4) të Rregullores për Teknikat e Reja të Reklamimit (transmetimi i reklamave në ekran të ndarë), nenit 52 të LShMAAV (mbi transmetimin e programeve me pjesëmarrje shpërblyese) dhe nenit 53, paragrafi (2) të LShMAAV (transmetimi i komunikimeve të fshehta komerciale audiovizuale). Për shkeljet e konstatuara u shqiptuan masa paralajmërim publikk.
- **Dy mbikëqyrje të kontrollit programor** mbi TV Spektra për detyrimet e:
 - Nenit 92, paragrafi (1) të LShMAAV (programi i krijuar burimor), ku është konstatuar se transmetuesi vazhdoi me shkeljen, për shkak të së cilës u iniciua procedurë kundërvajtëse;
 - Neni 64, paragrafi (1) të LShMAAV (përdorimi i gjuhës). Nga mbikëqyrja u konstatua se transmetuesi veproi sipas masës së shqiptuar.

- **Mbikëqyrja e kontrollit programor** mbi TV Due për respektim të nenit 50, paragrafi (3) të LShMAAV dhe nenet 20 dhe 21 (mënyra e aplikimit, pamjes dhe përmbajtjes të sinjalistikës paralajmëruese) të Rregullores për mbrojtjen e të miturve. Televizioni nuk kishte vepruar sipas masës së shqiptuar paralajmërim publik dhe për këtë shkak u inicua procedurë kundërvajtëse.
- **Mbikëqyrje e jashtëzakonshme programore** realizuar sipas detyrës zyrtare ndaj Radios Universitare UGD FM për respektim të nenit 67, paragrafi (6) të LShMAAV (përmbushja e konceptit programor në bazë të të cilit radioja jofitimprurëse mori lejen për transmetim në radio). Nga mbikëqyrja u konstatua se radioja nuk e përmbush konceptin programor, prandaj iu shqiptua masë paralajmërim publik.
- **Mbikëqyrje e jashtëzakonshme tetëditore e programit** u zbatua pas zjarrit tragjik në diskoteken "Puls" në Koçan, gjatë së cilës programet e transmetuesve u monitoruan për sa i përket mënyrës së raportimit mbi tragjedinë, si dhe harmonizimit të programit gjatë ditëve të zisë.

Prill

- **Mbikëqyrje të rregullta programore** mbi shërbimet kombëtare të programimit televiziv tokësor (TV Alsat-M, TV Alfa, TV Kanal 5, TV Sitel dhe TV Telma), me të cilat nuk u konstatuan shkelje.
- **Mbikëqyrje të kontrollit programor** mbi Nasha TV për respektim të nenit 98, paragrafi (2) të LShMAAV dhe nenit 14, paragrafi (4) të Rregullores për Teknikat e Reja të Reklamimit (mbi transmetimin e reklamave në ekran të ndarë). Nga mbikëqyrja u konstatua se transmetuesi plotësisht ka vepruar sipas masës së shqiptuar dhe ka mënjanuar shkeljen.
- **Dy mbikëqyrje të kontrollit programor** mbi TTV Kompani 21-M për respektim të:
 - Nenit 98, paragrafi (2) të LShMAAV dhe nenit 14, paragrafi (4) të Rregullores për Teknikat e Reja të Reklamimit; dhe
 - Nenit 53, paragrafi (2) të LShMAAV-së (ndalim i komunikimeve të fshehta audiovizuele komerciale).
 Nga mbikëqyrja u konstatua se transmetuesi veproi sipas masës së shqiptuar.
- **Mbikëqyrje e kontrollit programor** mbi TV Due për respektim të nenit 92, paragrafi (1) të LShMAAV (transmetim i programit të krijuar burimor). Nga mbikëqyrja u konstatua se transmetuesi ka mënjanuar shkeljen.

Maj

- **Mbikëqyrje të rregullta programore** mbi gjashtë shërbime programore televizive komerciale rajonale (TV Era, TV MTM, TV Shutel, TV M, TV Tera dhe TV Topestrada). Nga mbikëqyrja u konstatuan shkelje tek TV M dhe TV Tera të nenit 50, paragrafi (3) të LShMAAV dhe nenet 20 dhe 21 (mënyra e aplikimit, pamja dhe përmbajtja e sinjalit paralajmërues) të Rregullores për mbrojtjen e të miturve, për të cilat u vshqiptuan masa paralajmërim publik.

Qershor

- **Mbikëqyrje të rregullta programore** mbi pesë shërbime lokale programesh televizive komerciale (TV Koçani-LD, TV Kaltrina, TV Kanal Festa, TV Plus dhe TV Uskana Media). Nga mbikëqyrjet u konstatua shkelje tek TV Kanal Festa të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) (transmetim i programit të krijuar burimor) dhe nenit 50, paragrafi (3) të LShMAAV (mbrojtja e të miturve), dhe në lidhje me nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve (mënyra e aplikimit, pamja dhe përmbajtja e sinjalit paralajmërues); në TV Plus të nenit 92, paragrafët

(1) dhe (3) të LShMAAV (transmetim i programit të krijuar burimor); dhe në TV Uskana Media të nenit 64, paragrafi (1) (përdorimi i gjuhës) dhe nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të LShMAAV (transmetim i programit të krijuar burimor), për të cilat u shqiptuan maasa paralajmërim publik.

- **Mbikëqyrje e rregullt programore** mbi 11 shërbime programore televizive në nivel shtetëror (RTM1, TV Sitel, TV Kanal 5, TV Telma, TV Alfa, TV Alsat-M, TV 24 Vesti, Nasha TV, TV Sonce, TV 21-M dhe TV Shenja) në lidhje me detyrimin vjetor për transmetimin e veprave audiovizuale evropiane. Mbikëqyrja tregoi se të gjithë transmetuesit e përmbushën këtë detyrim në vitin 2024.
- **Mbikëqyrje e rregullt programore** mbi 11 shërbime programore televizive në nivel shtetëror (RTM1, TV Sitel, TV Kanal 5, TV Telma, TV Alfa, TV Alsat-M, TV 24 Vesti, Nasha TV, TV Sonce, TV 21-M dhe TV Shenja) në lidhje me detyrimin për të ndarë së paku 10% të buxhetit vjetor të programit për blerjen e veprave audiovizuale evropiane nga producentët të pavarur, si dhe në lidhje me faktin se së paku nga gjysma e veprave të tilla të transmetuara nuk do të jenë më të vjetra se 5 vjet. Në vitin 2024, televizionet gjithashtu e përmbushën këtë detyrim.
- **Mbikëqyrje e kontrollit programor** mbi TV 21-M për respektim të nenit 52 të LShMAAV (detyrimet gjatë organizimit të programeve me pjesëmarrje në shpërblim). Nga mbikëqyrja u konstatua se transmetuesi veproi sipas masës së shqiptuar duke mënjanuar shkeljen.
- **Mbikëqyrje e kontrollit programor** mbi TV 24 Vesti për respektim të nenit 55, paragrafi (2), nënparagrafët 2, 3 dhe 4 të LShMAAV (kushtet për plasim të produkteve) dhe nenet 25 dhe 26 (shënimi i plasimit të produktit) të Udhëzimit për Plasimin e Produkteve, të cilat treguan se transmetuesi veproi sipas masës së shqiptuar.
- **Mbikëqyrje e kontrollit programor** mbi TV Shenja për respektim të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të LShMAAV (transmetim të programit të krijuar burimor). Transmetuesi e ka mënjanuar shkeljen.

Korrik

- **Mbikëqyrje të rregullta programore** mbi shërbimet kombëtare të programeve në radio komerciale (RA Antena 5, RA Metropolis, RA Kanal 77 dhe RA Jon), në të cilat nuk u konstatuan shkelje.
- **Mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore të kryera sipas detyrës zyrtare për zbatimin e detyrimeve për të ofruar programe të qasshme për personat me aftësi të kufizuara** (neni 26 të LShMAAV) mbi shërbimet programore televizive të Shërbimit Publik Radiodifuziv: RTM1, RTM2 dhe RTM5, dhe dhjetë televizioneve kombëtare komerciale: TV Alsat-M, TV Alfa, TV Kanal 5, TV Sitel, TV Telma, TV 21-M, TV Sonce, TV Shenja, TV 24 Vesti dhe Nasha TV. Mbikëqyrjet u kryen në periudhën maj-korrik. Më shumë informacion mbi gjetjet e mbikëqyrjes mund të gjendet në rubrikën "Arsimimi mediatic dhe përfshirja sociale" të këtij raporti.

Gushtë

- **Mbikëqyrje të kontrollit programor** mbi TV Terra për respektim të nenit 50, paragrafi (3) të LShMAAV dhe nenet 20 dhe 21 (mënyra e aplikimit, pamja dhe përmbajtja e sinjalit paralajmërues) të Rregullores për mbrojtjen e të miturve. Nga mbikëqyrja u konstatua se transmetuesi plotësisht ka vepruar sipas masës së shqiptuar dhe ka mënjanuar shkeljen.
- **Mbikëqyrja e kontrollit programor** mbi TV M për respektim të nenit 50, paragrafi (3) të LShMAAV dhe nenet 20 dhe 21 (metoda e aplikimit, pamja dhe përmbajtja e sinjalit paralajmërues) të Rregullores për mbrojtjen e të

miturve. Nga mbikëqyrja u konstatua se transmetuesi plotësisht ka vepruar sipas masës së shqiptuar dhe ka mënjanuar shkeljen.

Shtator

- **Mbikëqyrje e kontrollit programor** mbi TV Kanal Festa për respektim të nenit 50, paragrafi (3) të LShMAAV dhe nenet 20 dhe 21 (mënyra e aplikimit, pamja dhe përmbajtja e shenjës paralajmëruese) të Rregullores për mbrojtjen e të miturve. Transmetuesi plotësisht ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Tetor

- **Mbikëqyrje e kontrollit programor** mbi TV Plus për respektim të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) (programi i krijuar burimor) nga LShMAAV. Nga mbikëqyrja u konstatua se televizionii ka mënjanuar shkeljen.
- **Dy mbikëqyrje të kontrollit programor** mbi TV Uskana Media për respektim të:
 - Nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) (programi i krijuar burimor); dhe
 - Nenit 64 paragrafi (1) (përdorimi i gjuhës) nga LShMAAV.

U konstatua se transmetuesi plotësisht i ka mënjanuar shkeljet.

- **Mbikëqyrje e kontrollit programor** mbi TV Kanal Festa për respektim të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) (programi i krijuar burimor) të LShMAAV, në të cilën u përcaktua se transmetuesi ka harmonizuar programin me detyrimet ligjore.

Nëntor

- **Mbikëqyrje e rregullt programore** mbi pesë shërbime rajonale komerciale të programeve në radio (Radio Xhez FM, Radio RFM, EF-EM 90.3 - Sports Radio, Skaj Radio dhe Urban FM). Nga mbikëqyrja tek RA Xhez FM u konstatua shkelje të nenit 80, paragrafët (7), (8) dhe (9) të LShMAAV, dhe në lidhje me pikën 4 të Udhëzimeve për raportimin vullnetar të radiove për transmetim të muzikës vendase (shërbimet programore në radio janë të detyruar përqindjen e raportuar të muzikës në gjuhën maqedona dhe në gjuhët e bashkësive ta transmetojnë çdo ditë, në periudhën nga ora 6 deri në orën 00). Këtij radiostacioni i është shqiptuar masë paralajmërim publik.

Dhjetor

- **Mbikëqyrje të rregullta programore** mbi pesë shërbime lokale komerciale të programeve në radio (Super Radio, Radio Meff, Radio Modea, Radio Aleksandar Makedonski dhe Radio Jehona FM). Nga mbikëqyrja u konstatua shkelje në Radio Modea të nenit 53, paragrafi (4), nënparagrafi 3 dhe nenit 53, paragrafi (5) dhe në lidhje me nenin 53, paragrafët (6) dhe (19) të LShMAAV-së, (transmetim i komunikimit audio komercial në të cilin në mënyrë të rreme paraqitet natyra dhe karakteristikat e shërbimit të reklamuar dhe ndërkohë nxisin sjellje që është e dëmshme për shëndetin) dhe u shqiptua masë paralajmërim publik.

Mbikëqyrje administrative

Mbikëqyrje mbi përmbushjen e detyrimit për publikim impresum dhe informacion identifikues

Në vitin 2025, mbikëqyrje të rregullta administrative mbi transmetuesit në lidhje me publikim impresum dhe informacion identifikues që transmetuesi duhet t'i vërë në dispozicion publikut u realizuan në përputhje me planifikimin në Planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes administrative. Duke qenë se gjatë mbikëqyrjeve të rregullta të disa transmetues u konstatuan shkelje dhe iu shqiptuan masa paralajmërim publik, pas skadimit të afatit për mënjanimin e shkeljes së ligjit, përcaktuar në aktvendimin për shqiptimin e masës, u realizuan dhe mbikëqyrje kontrolli. Për transmetuesit të cilëve masat për paralajmërim publik iu shqiptuan në fund të vitit 2025, mbikëqyrjet e kontrollit do të realizohen në vitin 2026 dhe ato nuk janë të përfshirë në këtë Raport. Nga gjithsej 58 mbikëqyrje administrative të zbatuara, 46 ishin të rregullta, 11 ishin kontrolluese dhe 1 ishte i jashtëzakonshëm.

Mbikëqyrja e rregullt administrative e transmetuesve për dorëzimin e raporteve mbi respektimin e konceptit programor në vitin 2024 u zbatuan në gjithsej 90 media (36 shërbime televizive dhe 54 radio).

Pasqyra e të gjitha mbikëqyrjeve administrative të paraqitura më poshtë është organizuar sipas periudhës së përfundimit të tyre.

Janar

- **Mbikëqyrje të rregullta administrative** mbi shërbimet programore televizive të Shërbimit Publik Radiodifuziv (RTM1, RTM2, RTM3, RTM4 dhe RTM5). Gjatë mbikëqyrjes, në RTM3 u konstatua shkelje të nenit 51, paragrafi (1) (publikim të informacionit të disponueshme për shfrytëzuesit) dhe u shqiptua masë paralajmërim publik.

Shkurt

- **Mbikëqyrje të rregullta administrative** mbi shërbimet programore në radio të Shërbimit Publik Radiodifuziv (RTM1, RTM2 dhe RTM3), gjatë të cilave nuk u konstatuan shkelje.
- **Dy mbikëqyrje të kontrollit administrativ** mbi TV News për respektim të:
 - Nenit 14 të LM (impresum); dhe
 - Nenit 51, paragrafi (1) të LShMAAV-së (informacion i disponueshëm për përdoruesit).

Të dy mbikëqyrjet treguan se transmetuesi vazhdoi me shkeljet, prandaj iu shqiptua masë paralajmërim publik.

- **Mbikëqyrje e kontrollit administrativ** mbi TV Due për respektim të nenit 51, paragrafi (1) të LShMAAV (informacion i disponueshëm për përdoruesit). Nga mbikëqyrja u konstatua se mediumi ka shkelur dispozitën dhe është shqiptuar masë paralajmërim publik.

Mars

- **Mbikëqyrje të rregullta administrative** mbi shërbimet kombëtare të programimit televiziv komercial satelitor (Nasha TV dhe TV 24 Vesti), gjatë të cilave nuk u konstatuan shkelje.
- **Mbikëqyrje të rregullta administrative** mbi shërbimet kombëtare të programeve televizive komerciale të transmetuara nëpërmjet ORRPKE (TV Kompani 21-M, TV Shenja, TV Klani Maqedoni dhe TV Sonce). Nga mbikëqyrjet është konstatuar shkelje në TV Klan, TV Shenja dhe TV 21-M. Stacionet televizive nuk respektojnë nenin 14 të Ligjit për Median (detyrimi për transmetim impresum), dhe në TV Klan u konstatua shkelje të nenit

51, paragrafi (1) të LShMAAV (informacioni që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve). Për shkeljet u shqiptuan masa paralajmërim publik.

- **Mbikëqyrje e kontrollit programor** mbi RTM3 për respektim të nenit 51, paragrafi (1) të LShMAAV-së (informacion që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve). Nga mbikëqyrja konstatua se media plotësisht ka vepruar sipas masës së shqiptuar.
- **Mbikëqyrje të kontrollit administrativ** mbi TV News për respektim të nenit 51, paragrafi (1) të LShMAAV-së (informacioni që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve) dhe nenin 14 të Ligjit për Median (impresium). Nga mbikëqyrja u konstatua se media u harmonizua me kërkesat ligjore.
- **Mbikëqyrje e jashtëzakonshme administrative e kryer sipas detyrës zyrtare** për respektim të nenit 14 të LM (publikim impresium) mbi TV Due, në të cilin u konstatua se media ka shkelur dispozitën dhe është shqiptuar masë paralajmërim publik.

Prill

- **Mbikëqyrje të rregullta administrative** mbi shërbimet kombëtare të programeve televizive tokësore (TV Alsat-M, TV Alfa, TV Kanal 5, TV Sitel dhe TV Telma), me të cilat nuk u konstatuan shkelje.

Maj

- **Mbikëqyrje të rregullta administrative** mbi gjashtë shërbime programimi televizive komerciale rajonale (TV Era, TV MTM, TV Shutel, TV M, TV Terra dhe TV Topestrada), me të cilat nuk u konstatuan shkelje.

Qershor

- **Mbikëqyrje të rregullta administrative** mbi të gjithë transmetuesit që transmetojnë programe televizive dhe radio në vitin 2024, për respektim të nenit 15, paragrafi (5) të Ligjit për Media (dorëzim raport mbi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejet për transmetim televiziv dhe radio në vitin 2024). Sipas gjetjeve të mbikëqyrjeve, të gjithë 90 transmetuesit përmbushën detyrimin për dorëzim të raporteve dhe të gjithë transmetuesit, gjatë vitit 2024, në përgjithësi transmetuan program që ishin brenda kornizës së koncepteve të tyre programore.
- **Mbikëqyrje të rregullta administrative** mbi pesë shërbime lokale programore televizive komerciale (TV Koçanë - LD, TV Kaltrina, TV Kanal Festa, TV Plus dhe TV Uskana Media). Nga mbikëqyrjet u konstatua shkelje tek TV Kanal Festa të nenit 14 të Ligjit për Median (impresium) dhe nenit 51, paragrafi (1) të LShMAAV (informacione të disponueshme për përdoruesit). Për shkeljet u shqiptuan masa paralajmërim publik.
- **Mbikëqyrje të kontrollit administrativ** mbi TV 21-M për respektim të nenit 14 të Ligjit për Median (detyrim për transmetim impresium). Nga mbikëqyrja u konstatua se transmetuesi plotësisht ka vepruar sipas masës së shqiptuar.
- **Mbikëqyrje e kontrollit administrativ** mbi TV Shenja për respektim të nenit 14 të Ligjit për Median (detyrim për transmetim impresium). Transmetuesi ka mënjanuar shkeljen.
- **Mbikëqyrje e kontrollit administrativ** mbi TV due për respektim të nenit 14 të Ligjit për Median (detyrim për transmetim impresium). Nga mbikëqyrja u konstatua se transmetuesi veproi sipas masës së shqiptuar dhe ka mënjanuar shkeljen.

Korrik

- **Mbikëqyrje të rregullta administrative** mbi shërbimet kombëtare të programeve komerciale në radio (RA Antena 5, RA Metropolis, RA Kanal 77 dhe RA Jon), nga ku nuk u konstatuan shkelje.

Shtator

- **Mbikëqyrje të kontrollit administrativ** mbi TV Kanal Festa për respektim të nenit 14 të Ligjit për Median (impresium) dhe nenit 51, paragrafi (1) të LShMAAV-së (informacion në dispozicion të përdoruesve). Nga mbikëqyrjet u konstatua se TV Kanal Festa plotësisht i ka mënjanuar shkeljet.

Nëntor

- **Inspektime të rregullta administrative** mbi pesë shërbime rajonale komerciale të programeve në radio (Radio Xhez FM, Radio RFM, EF-EM 90.3 - Sport Radio, Skaj Radio dhe Urban FM). Nga mbikëqyrjet nuk u konstatuan shkelje të detyrimeve administrative të LM dhe të LShMAAV.

Dhjetor

- **Inspektime të rregullta administrative** mbi pesë shërbime lokale komerciale të programeve në radio (Super Radio, Radio Meff, Radio Modea, Radio Aleksnadar Makedonski dhe Radio Jehona FM). Nga mbikëqyrjet u konstatua shkelje tek Radio Jehona FM të nenit 51, paragrafi (1) të LShMAAV-së (informacion i disponueshëm për përdoruesit) dhe është shqiptuar masë paralajmërim publik.

Përmbushja e kushteve minimale kuadrovice

Në vitin raportues, Agjencia zbatoi gjithsej 94 mbikëqyrje (89 të rregullta, katër të jashtëzakonshme dhe një kontrollus) për të përcaktuar nëse transmetuesit i përmbushin kushtet minimale kuadrovice të përcaktuara në "Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovice për dhënie e lejes për transmetim televiziv dhe radio".

Mbikëqyrje të rregullta u zbatuan gjatë nëntorit dhe dhjetorit 2025, nga ku është konstatuar se të 89 transmetuesit i plotësojnë kushtet e nevojshme kuadrovice.

Mbikëqyrje të jashtëzakonshme u kryen mbi TV Klan (në prill), TV Telma (në prill), RA Enxhels (në qershor) dhe TV Kobra (në shtator).

Agjencia kreu mbikëqyrje mbi TV Klan sipas detyrës zyrtare. Sipas Rregullores përkatëse, ky transmetues duhej të kishte të punësuar së paku 20 persona që marrin pjesë në krijimin e programit, në marrëdhënie të rregullt pune dhe me orar të plotë, dhe kryeredaktori duhej të ishte në marrëdhënie të rregullt pune. Mbikëqyrja e jashtëzakonshme e kryer në prill konstatoi se numri i të punësuarve në marrëdhënie të rregullt pune në TV Klan ishte 18 persona, përkatësisht se ky televizion nuk i plotëson kushtet minimale kuadrovice.. Prandaj, u iniciua procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv. Për të përcaktuar gjendjen faktike para se të merrej vendimi për heqjen e lejes, dhe bazuar në të dhënat e ofruara nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut,, u krye një mbikëqyrje tjetër, e cila konstatoi se televizioni kishte të punësuar vetëm një person. Për këtë shkak dhe njëkohësisht për shkak të mospagesës së taksës vjetore të lejes, Agjencia ka hequr lejen e transmetimit

këtij televizioni.

Mbikëqyrjet mbi TV Telma dhe RA Enxhls u kryen pasi dy transmetuesit e informuan Agjencinë se kishin kryer ndryshim të redaktorëve përgjegjës. Duke pasur parasysh se, në përputhje me Rregulloren, redaktori përgjegjës i shërbimit programor duhet të jetë në marrëdhënie të rregullt pune dhe i punësuar me orar të plotë nga radiodifuzeri, Agjencia kërkoi nga TV Telma dhe RA Enxhls të paraqisnin dokumente nga të cilat do të ishte e mundur të konstatohej se personat e emëruar si redaktorët përgjegjës janë të punësuar në përputhje me Rregulloren e lartpërmendur. Nga mbikëqyrjet mbi dy transmetuesit u konstatua se personat e emëruar si kryeredaktorë janë në marrëdhënie të rregullt pune dhe janë të angazhuar me orar të plotë në stacionin televiziv dhe radio.

Mbikëqyrja e jashtëzakonshme mbi TV Kobra u krye në bazë të një parashtrese të paraqitur nga person fizik. Sipas rregullores së lartpërmendur, kushtet minimale kuadrore që duhet të përmbushë ky televizion janë - të ketë së paku pesë punonjës në marrëdhënie të rregullt pune dhe me kohë të plotë që marrin pjesë në krijimin e programit dhe kryeredaktori i shërbimit programor të jetë në marrëdhënie të rregullt pune. Në përputhje me dokumentacionin që TV Kobra paraqiti pas kërkesës paraprake nga Agjencia, u konstatua i përmbush kushtet minimale kuadrore të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë.

Monitorim i detyrimit për pagesën e tarifës vjetore të lejes për transmetim televiziv ose radio për vitin 2025

Në vitin 2025, Agjencia kreu gjithsej 15 mbikëqyrje mbi transmetues që nuk paguan kompensimin në afatin e përcaktuar ligjor. Këto janë: TV Alfa, TV Shutel, TV Edo, TV MTM, TV Kaltrina, TV Koçani-LD, RA RFM, RA Xhez FM, RA Galaksi 2002, RA Eko, RA Red FM, TV Klan, TV Sonce, TV Shenja dhe RA Jon. Nga këta, TV Edo dhe RA Eko e paguan tarifën para se të inicohen procedurat për heqjen e lejes, ndërsa për 13 të tjerët, Agjencia inicoi procedurat për heqjen e lejes. Procedurat për 11 nga këta 13 transmetues u ndaluan për shkak se plotësisht e përmbushën detyrimin para skadimit të afatit për miratimin e vendimeve për heqjen e lejeve, ndërsa për TV Shutel dhe TV Klan u morën vendime për heqjen e lejeve. Vendimi për heqjen e lejeve për transmetim televiziv të TV Shutel u anulua në prill 2025, pasi transmetuesi ka mënjeluar shkakun për arsyet për të cilat u miratua.

Mbikëqyrje në lidhje me detyrimet e tjera të transmetuesve

Në bazë të mbikëqyrjes së jashtëzakonshme të zbatuar në periudhën dhjetor 2025 deri në janar 2026, mbi TV Sonce, Agjencia ka konstatuar se ky televizion kishte ndërprerë transmetimin e shërbimit programor për më shumë se 30 ditë, prandaj në vitin 2026 u mor vendimi për heqjen e lejes për transmetim televiziv.

Mbikëqyrje profesionale

Në vitin 2025, Agjencia kreu pesë mbikëqyrje profesionale mbi transmetues për të përcaktuar nëse i plotësojnë kushtet teknike për kryerjen e veprimtarisë. Katër mbikëqyrje u kryen mbi katër radio stacione, të cilëve lejet për transmetim në radio u dhanë në vitin 2025. Këto ishin radiot lokale Buba Mara nga Prilepi, Buba Mara Studio nga Shtipi, Struga nga Struga dhe Skver nga Kumanova. Nga mbikëqyrjet u konstatua se të gjithë i plotësojnë kushtet themelore teknike të nevojshme për transmetim të programit në nivel lokal. Mbikëqyrja e pestë profesional u krye mbi televizionin rajonal MTM nga Shkupi për shkak të ndryshimit të vendndodhjes së hapësirave në të cilat prodhohet programi. Dhe me këtë mbikëqyrje nuk u konstatuan shkelje.

TRANSPARENÇË NË PUNËN E TRANSMETUESVE

Në vitin 2025, Agjencia për të katërtën herë kreu mbikëqyrje mbi 89 transmetues në lidhje me përmbushjen e detyrimit për sigurimin e transparencës në punë, përcaktuar në nenin 15 të LM-së.

Në prill, u krye mbikëqyrje në lidhje me detyrimin sipas nenit 15, paragrafi (1) të këtij ligji, sipas të cilit transmetuesit janë të detyruar t'nderi më 31 mars të vitit aktual, në formular të veçantë të përcaktuar nga Agjencia, të paraqesin të dhëna mbi strukturën pronësore, kryeredaktorin/redaktorët, burimet e financimit në vitin paraprak (reklamë, sponsorizim, shitje të përmbajtjeve, shërbime të ofruara palëve të treta, etj.) mbi të ardhurat dhe shpenzimet totale të realizuara në vitin paraprak nga veprimtaria e kryer dhe mbi shikueshmërinë ose dëgjueshmërinë mesatare në vitin paraprak. Ky detyrim u përmbush nga të gjitha televizionet dhe radiot që transmetojnë programe (gjithsej 89).

Po atë muaj, Agjencia kreu mbikëqyrjen e parë të rregullt administrative (nga gjithsej tre) në lidhje me përmbushjen e detyrimit sipas nenit 15, paragrafi (3) të LM (tani neni 15, paragrafi 4). Sipas kësaj dispozite, transmetuesit janë të detyruar të publikojnë të dhëna në program e tyre mbi strukturën pronësore, kryeredaktorin dhe burimet e financimit në vitin paraprak, së paku tre herë në vit, gjatë kohës së shikueshmërisë më të madhe, dhe regjistrim të publikimit të dorëzojnë në Agjenci në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit.

Dy mbikëqyrjet e tjera që lidhen me këtë detyrim ligjor u kryen në korrik dhe nëntor, në përputhje me Planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes administrative në vitin 2025.

Transmetuesit treguan një nivel jashtëzakonisht të lartë të përmbushjes së këtij detyrimi – nga asnjë mbikëqyrje nuk u konstatuan shkelje.

MBROJTA E PLURALIZMIT DHE TRANSPARENÇË TË PRONËSISË SË TRANSMETUESVE

Monitorim i ndryshimeve në pronësinë e transmetuesve

Gjatë gjithë vitit, nëpërmjet kontrolleve të vazhdueshme në ueb- faqen zyrtare të Regjistrimit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Agjencia monitoron nëse ndonjëri prej transmetuesve ka zbatuar ndryshim në strukturën pronësore pa njoftim paraprak të Agjencinë dhe pa kërkuar miratim për ndryshimin e planifikuar.

Plotësuese, në maj 2025, në lidhje me të dhënat mbi pronarët e listuar në statusin aktual të transmetuesve, Agjencia kreu një mbikëqyrje të jashtëzakonshme mbi të gjitha televizionet dhe radiot, ku është konstatuar se asnjë transmetues nuk kishte shkelur nenin 41 të LShMAAV-së, përkatësisht nuk kishte kryer ndryshim të pronësisë pa njoftuar paraprakisht Agjencinë dhe para se të miratonte ndryshimin.

Veprimi pas njoftimeve të paraqitura për ndryshim të strukturës pronësore

Në vitin 2025, pas një kontrolli paraprak të plotësisë dhe rregullsisë së kërkesave të paraqitura për ndryshim të pronësisë nga tre transmetues dhe pasi u konstatua se me ndryshimet e planifikuara pronësore nuk shkelnin ndalimet e veçanta për fitimin e pronësisë dhe nuk krijonin përqendrim të paautorizuar mediatik sipas kuptimit të LShMAAV, Agjencia miratoi vendime që lejon ndryshim në strukturën pronësore të tre transmetuesve - televizioneve rajonale të Shkupit MTM dhe Shutel dhe radiostacionit lokal Plus Forte nga Tetova.

Ndryshimi i pronësisë së TV MTM nga Shkupi u realizua në prill, kur nga televizioni plotësisht u tërhoq pronari i vetëm, personi fizik Gordana Andreevska, dhe hyri personi fizik Nikolla Tasev.

TV Shutel nga Shkupi kërkoi nga Agjencia pëlqim për tërheqjen e personit fizik Antonie Stojçeski dhe hyrjen e personit Beadin Sulejmanovski si pronar i vetëm i televizionit. Në kohën e shkrimit të këtij Raporti, ndryshimi ende nuk është realizuar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pronari i RA Plus Forte nga Tetova, personi fizik Nebojsa Karapejovski, u tërhoq nga pronësia e radios për shkak se pas përfundimit të zgjedhjeve parlamentare në maj 2024, për deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut u zgjodh anëtar i familjes së tij, që paraqet shkelje të ndalimit të nenit 38 të LShMAAV. Në përputhje me nenin, bartësit e funksioneve publike dhe anëtarët e familjeve të tyre nuk mund të kryejnë veprimtari radiodifuzive, as të jenë themelues, bashkëthemelues ose të marrin pjesë në pronësinë e radiodifuzerëve. Pronari i ri i radiostacionit që nga marsi 2025 është bërë personi fizik Millan Pavlovski.

Në janar 2025, Agjencia ka ndërprerë procedurën në lidhje me Njoftimin për ndryshim të strukturës pronësore të TV Klan (paraqitur në shkurt 2024) dhe vendimin në mars 2024 që lejonte ndryshimin e pronësisë të këtij transmetuesi. Procedura u ndërpre për shkak se televizioni, edhe pas dhjetë muajsh pasi Agjencia e miratoi ndryshimin, nuk e zbatoi në Regjistrin Qendror të RMV-së. Duke marrë parasysh këtë, rregullatori i kërkoi Qeverisë të paraqesë kërkesë të Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për dhënien e interpretimi autentik të nenit 42, paragrafi (1) të LShMAAV-së, në lidhje me atë nëse të dhënat që transmetuesi ka paraqitur para gjashtë muajsh ose më shumë, dhe në bazë të të cilës është marrë vendim që lejon ndryshim në strukturën e pronësisë të transmetuesi, të cilin transmetuesi nuk e ka realizuar, mund të llogariten të sakta dhe/ose të plota sipas kuptimit të nenit 42, paragrafi (1) të LShMAAV-së, ose nëse të njëjtat, me skadimin e periudhës prej gjashtë muajsh ose më shumë, janë bërë të pasakta dhe/ose të paplota, që është bazë për anulimin e vendimit të marrë që lejon ndryshim në strukturën e pronësisë së transmetuesi. Interpretim autentik nuk është paraqitur, por në dhjetor 2025, neni 42 të LShMAAV-së u plotësua me paragraf të ri që përcakton se Agjencia, me vendim, do të anulojë vendimin që lejon zbatimin e ndryshimit në strukturën pronësore, nëse transmetuesi nuk e zbaton ndryshimin e strukturës pronësore në Regjistrin Qendror në afat prej 90 ditësh nga dita e miratimit të vendimit të Agjencisë. Ndërkohë (në prill 2025), Agjencia ia hoqi lejen për transmetim televiziv të TV Klan për shkak të ndodhjes së rrethanave që paraqesin pengesa ligjore për kryerjen e veprimtarisë, përkatësisht transmetuesi nuk ka përmbushur kushtet minimale kuadrore që nevojiten për transmetimin e programi televiziv dhe nuk ka paguar tarifën vjetore të llesjes në afatin e përcaktuar ligjor.

Monitorimi i strukturës pronësore të transmetuesve nga aspekti i respektimit të dispozitave ligjore lidhur me kufizimet për fitimin e të drejtës pronësore dhe parandalimin e përqendrimit të paligjshëm mediatik

Duke marrë parasysh se pas përfundimit të zgjedhjeve lokale në vitin 2025, ekzistonte mundësia e mospërputhjes së mundshme të punës së transmetuesve me dispozitat e LShMAAV-së, Agjencia në nëntor u dërgoi shkresë të

gjithë transmetuesve duke u treguar ndalimet e veçanta për fitimin e pronësisë nga transmetuesit të përcaktuara në nenin 38 të këtij ligji. Sipas këtij neni, partitë politike, organet shtetërore, organet e administratës shtetërore, ndërmarrjet publike, njësitë e vetëqeverisjes lokale, bartësit e funksioneve publike dhe anëtarët e familjeve të tyre nuk mund të kryejnë veprimtari radiodifuzive dhe as të jenë themelues, bashkëthemelues ose të fitojnë pjesëmarrje në pronësinë e transmetuesve. Në këtë drejtim, transmetuesit u njoftuan për detyrimin e tyre ligjor për të harmonizuar punën e tyre me dispozitat e LShMAAV-së nëse ndodhnin ndryshime që mund të çonin në shkelje të nenit 38 të këtij ligji.

Transparenca e pronësisë së medias

Me qëllim rritjen e transparencës së pronësisë së transmetuesve dhe botuesve të mediave të shtypit, Agjencia dhe këtë vit ka përgatitur botim mbi pronësinë e mediave - "Pronësia e Medias në vitin 2025".⁴ Publikimi ofron një pasqyrë të përgjithshme të pronësisë së televizioneve, radiove dhe botuesve të mediave të shtypit, përkatësisht të personave juridikë dhe fizikë në vend dhe të huaj që paraqiten si pronarë të drejtpërdrejtë ose indirekt të medias.

Përveç kësaj, ai përfshin të dhëna mbi ndryshimet në strukturën pronësore të transmetuesve që Agjencia miratoi gjatë vitit 2024, të dhëna mbi integrimin ekzistues horizontal, si dhe mbi aktivitetet që Agjencia ndërmori në vitin 2024 me qëllim monitorimin e pronësisë së transmetuesve nga perspektiva e respektimit të kufizimeve për fitimin e pronësisë të përcaktuara në LShMAAV.

Gjatë gjithë vitit, rregullatori vazhdimisht përditësoi të dhënat mbi strukturën e pronësisë së stacioneve televizive dhe radio, të cilat publikohen në regjistra të veçantë në ueb-faqen zyrtare..

Për t'i ofruar publikut qasje të lehtë, të thjeshtë dhe papagesë në të dhënat mbi pronarët përfundimtarë të botuesve të mediave, në nëntor 2025 Agjencia filloi aktivitetet për krijimin e një regjistri të vetëm për strukturën e pronësisë së të gjithë botuesve të mediave. Regjistri u përfundua dhe u postua në ueb-faqen e Agjencisë në fillim të vitit 2026, dhe përmban të dhëna mbi personat fizikë dhe juridikë që janë pronarë të të gjitha televizioneve, radiove, mediave online - portaleve të internetit dhe mediave të shtypit, me të dhëna mbi aksionet që ata posedojnë në pronësinë e botuesve të mediave dhe me të dhëna mbi pronarët përfundimtarë të mediave.

Përveç kësaj, me iniciativën e Agjencisë, pesë transmetuesit më të rëndësishëm - televizionet tokësore në nivel shtetëror, duke vepruar në përputhje me udhëzimin e recitalit 32 të Aktit Evropian për Lirinë e Medias, pavarësisht faktit se ky akt ende nuk është transpozuar në legjislacionin maqedonas, publikuan të dhënat për pronarët e tyre në ueb-faqet dhe vendosën link për regjistrat e Agjencisë.

ARSIMIMI MEDIATIK DHE PËRFSHIRJA SOCIALE

Rrjeti për Arsimim Mediatik dhe Ditët e Arsimimit Mediatik 2025

Për të shtatën herë radhazi Ditët e Arsimimit Mediatik (DAM) 2025 u mbajtën nga 17 deri më 24 nëntor 2025, nën moton "Ti e di tjetri nuk e di. Komenti yt mund të ndihmojë!" Ato u organizuan nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe anëtarë të tjerë të Rrjetit për Arsimim Mediatik (RrAM) dhe mbështetësit e tyre, ku janë

⁴ E disponueshme në linkun e mëposhtëm: <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2025/07/Сопственоста-на-медиумите-во-2025-лекториано-со-прифатени-промени.pdf>

realizuar më shumë se 20 evente në lokacione të ndryshme në vend dhe online, dhe vendi iu bashkua përsëri Javës Globale të Arsimit Mediatik dhe Informativ të UNESCO-s.

Këtë vit, fokusi i DAM ishte në përdorimin e të menduarit kritik për të trajtuar dezinformimin nga vendi dhe bota, në përgjegjësinë personale në hapësirën digjitale, si dhe në motivimin e "të aftëve në media" për të ekspozuar praktikatat e dëmshme në sferën online.

Në vitin 2025, për herë të parë, të fillimit zyrtar të DAM 2025 i parapriu një program i organizuar nga Fondacioni "Metamorfozis", në kuadër të projektit rajonal – Kamioni balkanik mediatik, i cili u zhvillua midis 2 dhe 15 nëntorit në lokacione të hapura në Manastir, Gostivar, Shtip dhe Shkup.

DAM 2025 u hap më 17 nëntor me "Konferencën e Arsimit Mediatik UE - Ballkani Perëndimor 2025", të organizuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian, në hapje të së cilës foli Drejtori i Agjencisë, dhe një punonjës i organit rregullator moderoi sesionin "Gjenerata e ardhshme dhe platformat: Lundrimi në rreze dhe mundësi".

Më 18 nëntor u mbajtën tre evente:

- Eksperti holandez Ono Hansen-Stashinjski mbajti një punëtori me temën "Master Evropian në trajtimin e dezinformimit", në të cilin morën pjesë punonjës të ASHMA-së dhe përfaqësues të medias. Në të njëjtin event, Lazo Petrushevski, ish-kryetar i Këshillit të Agjencisë, prezantoi online kuiz për arsimimin mediatik ku autori ishte ai vetë.
- Agjencia organizoi gjithashtu punëtori me nxënës të shkollave të mesme, të titulluar "Interdemokracia", në të cilën eksperti holandez Ono Hansen - Stashinjski foli për avantazhet dhe rreziqet e përdorimit të inteligjencës artificiale gjenerative. Punëtorja iu kushtua ndërtimit të rezistencës tek të rinjtë gjatë përdorimit të inteligjencës artificiale (IA), por në fakt funksionoi si simulim për këshill nxënësish, duke pasur parasysh faktin se në punën e saj morën pjesë 45 nxënës nga tre shkolla të mesme: "Nikola Karev", "Josip Broz - Tito" dhe "Koço Racin". Diskutimi rezultoi në tre rekomandime nga nxënësit e shkollave të mesme, të cilat theksuan aspektet pozitive, por edhe disa nga dobësitë e përdorimit të IA-së në arsim. Rekomandimet nga punëtorja iu përcollën Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
- Instituti për Studime të Komunikimit mbajti punëtori me anëtarët e Shoqatës së Pensionistëve - Kumanovë, kushtuar dezinformimit, ndërhyrjes së huaj dhe manipulimit të informacionit (NHMI), si dhe sulmeve hibride.

Tre evente u mbajtën më 19 nëntor:

- Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (ShGM) organizoi aktivitet kushtuar sigurisë së punonjësve të medias me titull: "Sulmet online, pasojat offline: mbrojtja e gazetarëve sot", në të cilin foli edhe përfaqësues i Agjencisë.
- Fondacioni "Metamorfozis" promovoi raportin "Mundësuesit dhe nxitësit e ndërhyrjes së huaj dhe manipulimit të informacionit gjatë zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut". Midis panelistëve ishte edhe përfaqësues i Agjencisë.
- Instituti për Studime të Komunikimit (IKS) mbajti punëtori për arsimimin mediatik në Shkollën fillore "Petar Pop Arsov", Shkup, me temë "A është një mashtrim apo e meriton klikimin tim?".

Më 20 nëntor u mbajtën tre aktivitete të tjera:

- Në shkollën fillore "Lirija" në fshatin Zherovane të Tetovës, "Ballë për ballë" në partneritet me organizatën "Nisma" mbajti punëtorinë "Zërat e përfshirjes", që synonte krijimin e përmbajtjes mediatike dhe inkurajimin e energjisë lokale.

- Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë organizoi panel- diskutimi me temën "Paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike - SLAPP".
- Një lligjëratë dhe punëtori me temë "Përdorimi i burimeve të disponueshme publikisht për të ekspozuar dezinformimin" u mbajt në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, të organizuar nga Ambasadat e Lituanisë dhe Suedisë, Delegacioni i Bashkimit Evropian dhe Shtëpia e Evropës.

Numri më i madh i aktiviteteve u zhvillua më 21 nëntor, kur u mbajtën katër ngjarje:

- Instituti për Studime të Komunikimit, në Universitetin "Nënë Tereza", organizoi debat me temën "Rinia në Fokus: Ndërhyrja e huaj dhe manipulimi me informacion", ku përfaqësues nga Agjencia ishte midis panelistëve që diskutuan për ndikimin e hapësirës së parregulluar online tek të rinjtë.
- Fondacioni "Metamorfozis" mbajti vebinar me titull "Narrativat anti-UE në Ballkanin Perëndimor: Sfidat dhe Përgjigjet".
- Diskutim dhe punëtori "Ekspozimi i ndikimeve të dëmshme të huaja - teknika për gazetarët dhe organizatat e Shoqërisë Civile" u mbajt në Europe House Skopje, organizuar nga Ambasadat e Lituanisë dhe Suedisë, Delegacioni i UE-së dhe Europe House.
Në fillim të vitit 2025, katër subjekte u regjistruan në regjistrin e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë: Shoqëria Aksionare për Komunikime Elektronike Makedonski Telekom Shkup (Max TV Videoteka), Shoqëria e Shërbimeve SVOD MASTER ShPK Shkup (GLEJ/ГЛЕЈ), Shoqëria e Tregtisë dhe Shërbimeve MTEL ShPKNJ P Shkup (MOVE TV) dhe Shoqëria e Shërbimeve të Komunikimit A1 MAQEDONI ShPKNJ P Shkup (Vip Now). Në korrik, Shoqëria e Shërbimeve të Komunikimit A1 MAQEDONI ShPKNJ P Shkup (Vip Now) njoftoi Agjencinë se ndalon me kryerje të veprimtarisë, për këtë shkak është fshirë nga regjistri.

Mbikëqyrje programore

Në vitin 2025, sipas Planit vjetor të mbikëqyrjes programore, mbikëqyrja e rregullt programore mbi ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë ishte planifikuar të kryhej dy herë në vit, një herë në çdo gjysmë viti. Në përputhje me këtë, u kryen shtatë mbikëqyrje të rregullta (katër në maj dhe tre në shtator) dhe u konstatua se të gjithë ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë plotësisht i përmbushin detyrimet e LShMAAV-së që i referohen ndalimit të transmetimit të veprave kinematografike në periudhën e përcaktuar në marrëveshjet me zotëruesit e të drejtave (neni 49) dhe mbrojtjen e të miturve (neni 50 paragrafi 1).

Personat fizik që ofrojnë shërbime mediatike audiovizuale me kërkesë

Në vitin raportues, pas miratimit të Rregullores për personat fizikë që ofrojnë shërbime mediatike audiovizuale me kërkesë (influenser/vlogerë/kreator), Agjencia ndërmori disa aktivitete që synonin njohjen e publikut dhe subjekteve të reja të rregullimit mediatik me dispozitat e Rregullores dhe detyrimet që rrjedhin nga LSHMAAV për ta. U mbajtën disa takime me influencer, në të cilat u diskutuan këto çështje, dhe përfaqësuesit e Agjencisë diskutuan në disa raste për këtë temë në media.

BOTUES TË MEDIAS SË SHTYPIT

Gjatë vitit 2025, Agjencia kreu 10 mbikëqyrje administrative mbi punën e botuesve të mediave të shtypit - shtatë të rregullta, dy të jashtëzakonshme dhe një kontroll.

Në përputhje me Planin Vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes administrative në vitin 2025, në prill u krye një mbikëqyrje e rregullt në lidhje me përmbushjen e detyrimit sipas nenit 15, paragrafi (2) të Ligjit për Median (Publiciteti në Punë), sipas të cilit botuesit e mediave të shtypit janë të detyruar të dhënat mbi strukturën e pronësisë, përkatësisht të dhëna mbi emrin dhe selinë e regjistruar të personave juridikë ose emrin dhe vendin e banimit të personave fizikë që janë pronarë të aksioneve ose pjesëmarrjeve në botuesin e medias, me të dhëna mbi përqindjen e aksioneve ose pjesëmarrjeve të fituara dhe datën e blerjes, t'i publikojnë së paku në një gazetë ditore, një herë në vit, jo më vonë se 31 marsi i vitit aktual, dhe t'i dorëzojnë rregullatorit në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit. Mbikëqyrja përfshiu të gjithë botuesit e mediave të shtypit që janë të regjistruar në regjistrin e mbajtur nga Agjencia (gjithsej 19) dhe u konstatua se të gjithë e kishin përmbushur këtë detyrim.

Nëntë mbikëqyrjet e tjera administrative lidheshin me përmbushjen e detyrimit sipas nenit 14, paragrafi (1) të Ligjit për Median (Impresium). Sipas këtij detyrimi, botuesi i medias është i detyruar në vend të dukshëm në çdo kopje të medias së shtypit të sigurojë publikimin e të dhënave të mëposhtme: emri dhe adresa e selisë dhe e redaksisë së botuesit të medias, emri i personit përgjegjës të botuesit të medias, emri dhe mbiemri i kryeredaktorit, përkatësisht redaktorëve në përputhje me organizimin e brendshëm të redaksisë, emri dhe adresa e shtypshkronjës, data e botimit ose ribotimit dhe numri i kopjeve të shtypura. Mbikëqyrjet në lidhje me këtë detyrim u kryen si më poshtë:

- Në shkurt u kryen tre mbikëqyrje – dy të rregullta dhe një kontrolli. Mbikëqyrja e parë programore ishte kryer mbi 14 botues dhe përfshinte 14 media të shtypit, përkatësisht: „Nova Makedonija“, „Sloboden pečat“, „Veçer“, „Koha“, „Lajm“, „Kapital“, „Fokus“, „Bahçe“, „Ekonomija i Biznis“, „Portret“, „Ubavina i zdravje“, „Porta 3“, „Emiter“ dhe „Naroden lekar“. Mbikëqyrja e dytë, që u realizua mbi pesë botues, përfshinte mediat „Shtipski gllas“, „Shenja“, „InStore“, „Zenit“ dhe „Lice v lice“. Mbikëqyrje kontrolli u krye mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime KOLOR MEDIA PLUS ShPK Shkup, me qëllim të konstatimit nëse botuesi ka vepruar sipas paralajmërimit që Agjencia i shqiptoi në vitin 2024 sepse në botimin me nr. 6 të medias së shtypit „The Economist“ nuk bulikoi në tërësi të dhënat që duhet t'i përmbajë impresium. Nga mbikëqyrjet e rregullta nuk u konstatuan shkelje në asnjë botues dhe me mbikëqyrjen e kontrollit u konstatua se KOLOR MEDIA PLUS ShPK Shkup, plotësisht veproi sipas masës së shqiptuar dhe ka mënjeluar shkeljen e kryer paraprake.

- Në qershor u kryen dy mbikëqyrje – të dy të rregullt. I parë u krye mbi 12 botues të media së shtypit dhe përfshiu si në vijim 12 gazeta dhe revista: „Nova Makedonija“, „Sloboden pečat“, „Veçer“, „Koha“, „Fokus“, „Bahçe“, „Lajm“, „Ekonomija i biznis“, „Ubavina i zdravje“, „InStore“, „Shenja“ dhe „Naroden lekar“. I dyti është kryer mbi katër botues të media së shtypit ku përfshihen „Kapital“, „Shtipski gllas“, „Porta 3“ dhe „Zenit“. Nga këto mbikëqyrje nuk u konstatuan shkelje.

- Në gusht, u krye një mbikëqyrje e jashtëzakonshme – mbi Shoqatën e qytetarëve për hulumtim, komunikim dhe zhvillim PABLIK Shkup, botues i revistës „Lice v lice“ (Ballë për ballë). U konstatua se botuesi ka përmbushur plotësisht detyrimin për publikim impresium.

- Në nëntor u kryen dy mbikëqyrje të rregullta. Mbikëqyrja e parë, e cila u realizua mbi 11 botues u përfshinë këto media „Nova Makedonija“, „Sloboden pečat“, „Veçer“, „Koha“, „Lajm“, „Fokus“, „Bahçe“, „Ekonomija i biznes“, „Ubavina i zdravje“, „InStore“ dhe „Porta 3, ndërsa i dyti u realizua mbi pesë botues të medias „Kapital“, „Shenja“, „Shtipski gllas“, „Zenit“ dhe „Naroden lekar“. Nga dy mbikëqyrjet nuk u konstatuan shkelje.

- Në dhjetor është kryer mbikëqyrje e jashtëzakonshme mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime KOLOR MEDIA PLUS Shkup, botues i „The Economist“, ku është konstatuar se plotësisht ka përbushur detyrimin e nenit 14, paragrafi (1) të Ligjit për Media, përkatësisht impresiumi i përmban të gjitha të dhënat të përcaktuara në këtë nen.

BOTUES TË MEDIAS ONLINE – INTERNET PORTALIT

Ndryshimet në Ligjin për Median nga prilli i vitit 2025 përcaktuan kompetencën e Agjencisë për të mbajtur Regjistër të Botuesve të Medias Online - Portaleve të Internetit. Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Median (7 maj 2025), Agjencia ishte e detyruar të miratonte akt nënligjor që do të përcaktonte formën dhe përmbajtjen e aplikimit që botuesit e medias online - portalet e internetit paraqesin për regjistrim në regjistër dhe të përcaktonte mënyrën e mbajtjes së regjistrit, si dhe brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Ligji të krijonte regjistrin.

Më 5 qershor 2025, Agjencia miratoi "Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e aplikimit për evidentim në regjistrin e botuesve të medias online - portaleve të internetit dhe për mënyrën e mbajtjes së regjistrit të botuesve të medias online - portaleve të internetit". Po atë ditë, bëri thirrje publike drejtuar botuesve të medias online - portaleve të internetit për të paraqitur aplikim për evidentim në Regjistër.

Në vitin raportues, u paraqitën gjithsej 68 aplikime për regjistrim në regjistër. Më 31.12.2025, në regjistër⁶ u regjistruan 48 persona juridikë që publikojnë 60 media online - portale interneti. Bëhet fjalë për botues të mediave të cilët, pas mbikëqyrjes nga Agjencia, u konstatua se plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligj për regjistrim në regjistër - 1. të kenë regjistruar veprimtarinë në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2. të kenë selinë dhe redaksinë e tyre në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 3. të kenë domen interneti të maqedonisë .mk ose .mkd të regjistruara në emrin e tyre dhe 4. të kenë të punësuar së paku dy persona në marrëdhënie të rregullt pune me orar të plotë, ose në rastin e medias online - portali interneti me një fushëveprim të vogël dhe/ose të specializuar - një person në marrëdhënie të rregullt pune me orar të plotë dhe një person të angazhuar me kontratë për shërbime.

Në gusht dhe shtator, Agjencia kreu mbikëqyrje fillestar të kopjeve(impresium) të mediave të regjistruara, i cili përcaktoi se kopjet(impresiumi) e disa prej tyre nuk përmbanin të gjitha të dhënat e parashikuara në LM.

Prandaj, më 4 shtator, Agjencia iu drejtua të gjitha mediave të regjistruara online – portaleve të internetit dhe u vuri në dukje detyrimet e Ligjit për Media që duhet të zbatohet dhe për të cilat Agjencia ka kompetencë të kryerjen e mbikëqyrjes. Këto janë detyrimet e mëposhtme të Ligjit për Media: neni 6 – sigurimi i mbrojtjes së të miturve, neni 8 – kryeredaktori, neni 14 – impresium dhe neni 15 – publiciteti në punën e botuesve të mediave.

Në përputhje me Ligjin për Mediat, Agjencia mban Regjistrin e botuesve të mediave online - portaleve të internetit në formë elektronike, i cili përmban të dhëna për: kompaninë dhe selinë, përkatësisht emrin dhe adresën e botuesit të medias online - portalit të internetit; emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës të botuesit të medias online -

⁶ ASHMA, Regjistri i botuesve të mediave online – internet-portale, i disponueshëm në: <https://avmu.mk/online-mediumi/>

portalit të internetit; emrin e medias online - portalit të internetit; adresën e internetit të medias online - portalit të internetit; dhe regjistruetin e domenit të internetit maqedonas .mk ose .mkd.

MASAT E NDËRMARRA

Në vitin 2025, për shkelje të konstatuara të LShMAAV-së, Ligjit për Median dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të tyre, Agjencia kundër transmetuesve, botuesve të mediave të shtypit dhe operatorëve të rrjetit publik të komunikimit elektronik shqiptoi gjithsej 50 (pesëdhjetë) masa:

- 40 aktvendime për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik (përkatësisht: 32 aktvendime për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik ndaj transmetuesve⁷ dhe tetë aktvendime për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik/paralajmërim publike dhe përjashtim të rritimit të shërbimeve programore ndaj operatorëve të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike⁸);
- katër procedura kundërvajtëse/procedura paqësimi – procedura për dhënien urdhër pagese për kundërvajtje, përkatësisht (një procedurë kundërvajtëse e inicuar para gjykatës kompetente kundër një transmetuesi dhe tre procedura paqësimi të përfunduara me sukses – procedura për dhënien e urdhër pagese kundërvajtëse kundër dy transmetuesve dhe një operatori të rrjetit publik të komunikimit elektronik)⁹;
- një vendim për heqjen e lejes¹⁰ dhe
- pesë aktvendime për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve¹¹.

Masat e ndërmarrja kundër transmetuesve

Masat e shqiptuara – paralajmërim publik

Gjatë vitit 2025, Agjencia miratoi gjithsej 32 aktvendime për ndërmarrjen e masës - paralajmërim publik, si më poshtë vijon:

- gjashtë aktvendime për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik për konstatimit të shkeljes së nenit 14 të LM – mospërbushje e detyrimit për publikim të të dhënave që transmetuesi është i detyruar t'i transmeton në vend të përshtatshëm për çdo përmbajtje në veçanti të shërbimit programor përkatësisht mospublikim të të dhënave për impresium;
- pasë aktvendime për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik për konstatim të shkeljes së nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të LShMAAV, përkatësisht për mospërbushje të detyrimit për transmetim ditor së paku 30%

⁷ Të dhënat e detajuara për masat e shqiptuara – paralajmërim publike ndaj transmetuesve janë renditur në tabelën e kontrollit në fund të Raportit „Aktvendim për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik ndaj transmetuesve në vitin 2025“ (Shtojca nr. 1.2.)

⁸ Të dhënat e detajuara për pasat e shqiptuara – paralajmërim ndaj operatorëve të rrjetit publik për komunikim elektronik janë renditur në tabelë Kontrollit në fundit të Raportit „Aktvendim për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik dhe vërejtje publike dhe përjashtim të rritimit të shërbimeve programore ndaj operatorëve të rrjetit publik të komunikimit elektronik në vitin 2025“ (Shtojca nr. 1.3.).

⁹ Të dhënat e detajuara për procedurë kundërvajtëse/procedurat e zbatuara për paqësim janë renditur në kontrollin tabelare në fund të Raportit „Procedurat e inicuar kundërvajtëse/procedurat e zbatuara për paqësim kundër transmetuesve dhe operatorëve të rrjetit publik të komunikimit elektronik për shkeljet e konstatuara të LShMAAV dhe akteve nënligjore në vitin 2025“ (Shtojca nr. 1.4.).

¹⁰ Të dhëna të detajuara për propozimet e dorëzuara drejtuar Këshillit të Agjencisë për heqjen e lejes për transmetim televiziv/radio janë renditur në tabelën e kontrollit në fund të Raportit „Procedura në lidhje me heqjen e lejeve për transmetim televiziv/radio në vitin 2025“ (Shtojca nr. 1.6.).

¹¹ Të dhëna të detajuara për aktvendimet e marra për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve janë renditur në tabelën e kontrollit në fund të Raportit „Aktvendim për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve në vitin 2025“ (Shtojca nr. 1.7.).

program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase si dhe së paku gjysmën e minimumit ligjor në periudhën nga ora 07:00 deri në orën 19:00;

- pesë aktvendime për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik për konstatim të shkeljes së nenit 51, paragrafi (1) të LShMAAV, përkatësisht për shkak se transmetuesi në kuadër të shërbimeve televizive nuk siguroi informacione që duhet t'i vihet në dispozicion përdoruesve;

- katër aktvendime për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik për konstatim të shkeljes së nenit 50, paragrafi (3) të LShMAAV dhe neneve 20 dhe 21 të RrMPPM, përkatësisht për mosrespektim të rregullores për mbrojtjen e të miturve – para dhe pas transmetimit të disa programeve të kategorisë së parë, dytë dhe katërt është përdorur sinjalistikë e parregullt paralajmëruese për mbrojtjen e të miturve, që nuk është përcaktuar në RrMPPM, përkatësisht në tërësinë e pamjes së përcaktuar të sinjalit paralajmërues mungonte numri „8“, dhe shenja „+“, si tregues të grupmoshës së shikuesve për të cilën është destinuar programi;

- dy aktvendime për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik për konstatim të shkeljes së nenit 92, paragrafi (1) të LShMAAV, përkatësisht për mospërbushje të detyrimit të ShTR që transmetojnë shërbime programore televizive për transmetim ditore së paku 30 % program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase;

- dy aktvendime për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik për konstatim të shkeljes së nenit 98, paragrafi (2) të LShMAAV dhe nenit 14, paragrafi (4) të RrTRR, përkatësisht për mosrespektim të rregullores për teknika e reja të reklamimit – transmetim i pop-ap reklamave që shfaqen në ekran të ndarë pa kaluar një periudhë e përcaktuar së paku prej 15 minuta;

- dy aktvendime për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik për konstatim të shkeljes së nenit 64, paragrafi (1) të LShMAAV, përkatësisht për përdorimin e gjuhës në kundërshtim me nenin 64 të LShMAAV;

- një aktvendim për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik për konstatim të shkeljes së nenit 67, paragrafi (6) të LShMAAV, përkatësisht për mospërbushje të detyrimit nga transmetuesi për zbatim së paku 80% të konceptit programor për të cilën i është dhënë leja gjatë një jave;

- një aktvendim për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik për konstatim të shkeljes së nenit 50, paragrafi (3) të LShMAAV dhe nenit 16 të RrMPPM, përkatësisht për mosrespektim të rregullores për mbrojtjen e publikut të mitur – transmetim të programeve të kategorisë së tretë (12+) në periudhë të papërshtatshme kohore gjatë ditë-natës;

- një aktvendim për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik për konstatim të shkeljes së nenit 52 të LShMAAV, përkatësisht për shkak se ofruesi i shërbimit mediatic audiovizual në kuadër të shërbimit programor televiziv, në emisionin informativ aktual në të cilin shikuesit kanë mundësinë të marrin pjesë në shpërblim, nuk ofroi asnjë publikim të qartë të rregullave për përmbajtjet, as informacion për shpërblimin e premtuar publikisht;

- një aktvendim për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik për konstatim të shkeljes së nenit 53, paragrafi (2) të LShMAAV, përkatësisht për transmetim të fshehtë të komunikimit komercial audiovizual;

- një aktvendim për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik për konstatim të shkeljes së nenit 55, paragrafi (2), nënparagrafët 2, 3 dhe 4 të LShMAAV dhe pikat 25 dhe 26 të PPPA, përkatësisht për shkak se në emisionin e specializuar informativ nuk u respektuan kushtet për plasim të produkteve në programet audiovizuale, si dhe rregullat për shënimin e programeve që përmbajnë plasim të produkteve; dhe

- një aktvendim për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik për konstatim të shkeljes së nenit 80, paragrafët 7, 8 dhe 9 të LShMAAV, dhe në lidhje me pikën 4 të Udhëzimeve për raportim vullnetar të radiove për transmetim të muzikës vendase, përkatësisht për mostransmetim së paku 10 % të muzikës në gjuhën maqedone në periudhën nga ora 6 deri në orën 00, nga totali i muzikës së transmetuar gjatë ditë-natës së analizuar.

Procedurat e inicuar kundërvajtëse/procedurat e zbatuara për paqësim

Në përputhje me Ligjin për Kundërvajtje, Agjencia zhvilloi tre procedura për paqësim kundër tre radiodifuzerëve (ShTR SPEKTRA, komuna Labunishtë ShPKNJ, ShTR KOMPANI 21-M ShPNJP Shkup dhe ShTR TV DUE Nazmi ShPKNJ Gostivar), pas mbikëqyrjes kontrolluese përcaktoi se pavarësisht paralajmërimeve publike të shqiptuara

për shkelje të dispozitave të LShMAAV dhe RrMM, ata vazhduan të kryejnë të njëjtën shkelje për të cilën ishin paralajmëruar më parë. Dy nga procedurat e inicuar për paqësim përfunduan me sukses (kundër ShTR KOMPANI 21-M ShPKNJ P Shkup dhe ShTR TV DUE Nazmi ShPKNJ P Gostivar), ndërsa një procedurë për paqësim përfundoi pa sukses, pas së cilës Agjencia paraqiti kërkesë për iniciim të procedurës kundërvajtëse në gjykatën kompetente (kundër ShTR SPEKTRA, Komuna Labunishtë ShPKNJ P).

Masat e marra si rezultat i monitorimit të prezantimit mediatic të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2025

Për shkelje të konstatuara të KZ, në vitin 2025 Agjencia inicioi pesë procedura kundërvajtëse para gjykatës kompetente kundër pesë transmetuesve, si më poshtë:

- kundër ShTR TV GURRA ShPKNJ P Kërçovë dhe personit përgjegjës të transmetuesit për vazhdim të shkeljes së nenit 75-gj, paragrafi (1) të KZ, përkatësisht për shkak se gjatë rrethit të parë të Zgjedhjeve Lokale 2025 transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor të transmetuar më 30 shtator dhe në 2, 3 dhe 4 tetor 2025, në disa orë reale të programit të transmetuar ka tejkaluar limitet e lejuara për reklamim të paguar politik (RPP), përkatësisht: me transmetim të RPP për Koalicionin „VLEN“ i tejkaloi limitet e lejuara së paku për 4 minuta (240 sekonda) në orë reale për dy partitë më të mëdha në vend që në zgjedhjet e fundit për deputetë fituan më shumë vota dhe me transmetim të RPP për Kolacionin „Aleanca Kombëtare për Integrim – AKI“ i kaloi limitet e lejuara së paku prej 4 minuta (240 sekonda) për dy partitë më të mëdha politike të opzites që në zgjedhjet e fundit për deputetë fituan më shumë vota. Procedura është në vijim para gjykatës kompetente;

- kundër ShTR KOMPANI 21-M ShPKNJ P Shkup dhe personave përgjegjës të transmetuesit për shkelje të nenit 76-b, paragrafi (3), dhe në lidhje me nenin 69-a, paragrafi (2) të KZ, përkatësisht për shkak se gjatë raportimit ka shkelur heshtjen zgjedhore para rrethit të parë të zgjedhjeve, në mënyrë që në kuadër të shërbimit programor të transmetuar më 18.10.2025 ka transmetuar reprizë të programit special informativ Klik plus – Debate zgjedhore, të transmetuara premierë më 17.10.2025, të realizuar si debat në cilën marrin pjesë tre kandidatë për kryetar të Komunës Qendër, përkatësisht ka transmetuar informacion dhe materiale audiovizuale në të cilat marrin pjesë pjesëmarrësit në zgjedhje. Gjykata Themelore Penale Shkup miratoi aktgjykim me të cilin personi juridik dhe personat përgjegjës në personin juridik i shpalli fajtor dhe u shqiptoi sanksion kundërvajtës-paralajmërim;

- kundër ShTR TV SHUTEL ShPKNJ P SHKUP dhe personit përgjegjës të transmetuesit për vazhdim të shkeljes së nenit 76-b, paragrafi (3), dhe në lidhje me nenin 69-a, paragrafi (2) të KZ, përkatësisht për shkak se pas raportimit gjatë hrshtjes zgjedhore për rrethin e parë të fushatës zgjedhore transmetuesi në kuadër të shërbimit programor më 18 dhe 19 tetor 2025 ka transmetuar informacione dhe materiale audiovizuale në të cilin marrin pjesë pjesëmarrës në zgjedhje, përkatësisht ka transmetuar spot muzikor dhe emision dokumentar në të cilin shfaqet Elvis Bajram, kandidati për kryetar i komunës Shuto Orizar si bartës i listës Unioni i Romëve të Maqedonisë. Gjykata Themelore Penale Shkup miratoi aktgjykim me të cilën personin juridik e shpalli përgjegjës dhe i shqiptoi sanksion kundërvajtës – paralajmërim, dhe personi përgjegjës në personin juridik e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksion kundërvajtës – paralajmërim;

- kundër ShTR VISTEL ShPKNJ P Shkup dhe personit përgjegjës të transmetuesit për shkelje të nenit 76-b, paragrafi (3), dhe në lidhje me nenin 69-a, paragrafi (2) të KZ, përkatësisht për shkak se gjatë raportimit ka shkelur heshtjen zgjedhore para rrethit të parë të zgjedhjeve, në mënyrë që në kuadër të shërbimit programor të transmetuar më 19.10.2025 dy herë ka transmetuar pres-konferencë të ministrit të punëve të brendshme Pançe Toshkovski, përkatësisht ka transmetuar deklarata nga bartës të funksioneve të organeve qeveritare. Gjykata Themelore Shkup miratoi aktgjykim me të cilën personi juridik dhe personi përgjegjës në person juridik i liroi nga përgjegjësia. Në afatin e parashikuar ligjor Agjencia ka parashtruar ankesë, pas së cilës procedura para gjykatës kompetente është në vijim; dhe

- kundër ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip dhe personit përgjegjës të transmetuesit për shkelje të nenit 76-b, paragrafi (3), dhe në lidhje me nenin 69-a, paragrafi (2) të KZ, përkatësisht për shkak se gjatë raportimit ka

shkelur heshtjen zgjedhore para rrethit të parë të zgjedhjeve, në mënyrë që në kuadër të shërbimit programor të transmetuar më 19.10.2025, në lajmet e orës 10 ka transmetuar deklaratë të ministrit të punëve të brendshme Pançe Toshkovski, përkatësisht ka transmetuar deklarata të bartësve të funksioneve të organeve qeveritare. Gjakata Themelore Penale Shkup miratoi aktgjykim me të cilën personi juridik dhe personi përgjegjës në person juridik i liron nga përgjegjësia. Në afatin e parashikuar ligjor Agjencia ka parashtruar ankesë, pas së cilës procedura para gjykatës kompetente është në vijim.

Procedurat për heqjen e lejeve të transmetuesve

Në vitin raportues, Agjencia inicioi 13 procedura për heqjen e lejeve për transmetim televiziv dhe radio, nga të cilat:

- 12 procedura u inicuan për shkak të mospagesës së kompensimit vjetor të lejes për transmetim televiziv dhe radio. Nga të cilat, një procedurë u ndërpre sepse transmetuesi (Ra Jon) njoftoi Agjencinë se nuk ka mundësi të paguante pagesën e kompensimit për shkak të llogarive të bllokuara. Pas paraqitjes së kundërshtim në gjykatën kompetente dhe zhblokimit të llogarive, transmetuesi ka paguar kompensimin e lejes dhe procedura u ndalua. Dhjetë procedura u ndaluan, duke pasur parasysh se transmetuesit paguan në tërësi kompensimin vjetor të lejes, dhe një procedurë (për TV Shutel) përfundoi me heqjen e lejes sepse transmetuesi nuk pagoi kompensimin as në afatin shtesë që kishte nga fillimi i procedurës deri në marrjen e vendimit për heqjen e lejes. Ky transmetues paraqiti padi para gjykatës kompetente dhe plotësisht e pagoi kompensimin vjetor, për këtë shkak Agjencia në prill miratoi vendim për anulimin e vendimit për heqjen e lejes për transmetim televiziv;

- një procedurë (për TV Klan) u inicua njëkohësisht bazuar në dy arsye – për shkak të mospërmbushjes së kushteve minimale kuadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio dhe për shkak të mospagesës së kompensimit vjetor të lejes, pas së cilës në prill 2025 u miratua vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv.

Fshirja nga regjistri i radiodifuzerëve

Agjencia miratoi 5 aktvendime për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve, në bazë të të cilave nga regjistri u fshinë:

- tre radiodifuzer të cilëve iu hoqën lejet për transmetim të programit televiziv: ShTR TV-KANAL VIS ShPKNjP Strumicë (leja iu hoqë në dhjetor 2024), ShTR TV SHUTEL ShPKNjP Shkup dhe ShTR KLAN MAQEDONI ShPKNjP eksport-import Saraj, Shkup. Duke pasur parasysh se Agjencia miratoi vendim për anulimin e vendimit për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TV SHUTEL ShPKNjP Shkup, sepse transmetuesi plotësisht e pagoi kompensimin vjetor të lejes, radiodifuzeri përsëri u evidentua në regjistrin e radiodifuzerëve që udhëhiqet nga Agjencia dhe
- dy radiodifuzer që njoftuan Agjencinë se ndërpresin transmetimin e programeve në radio (RSM - Universitet „Shn. Kirili dhe Metodi“ në Shkup – Njësi organizative radiodifuzive jofitimprurëse RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM 92.9 dhe RSM – Universiteti shtetëror „GOCE DELLÇEV“ Shtip – Njësi universitare jofitimprurëse RADIO STUDENTORE UGD FM).

Përfundimi i vlefshmërisë së lejeve për transmetim televiziv dhe radio sipas ligjit

Në vitin 2025, sipas ligjit, pushoi vlefshmëria e lejeve për transmetim televiziv dhe radio gjithsej të pesë radiodifuzerëve - dy radio dhe tre televizione.

Agjencia u hoqi lejet tre prej tyre për transmetim televiziv ndërsa dy të tjerave nëpërmjet deklaratave me shkrim e njoftuan Agjencinë se po ndërprisnin transmetimin e programit në radio.

Agjencia u hoqi lejet tre transmetuesve të mëposhtëm:

- ShTR TV-KANAL VIS ShPKNJ P Strumicë në dhjetor 2024 – për shkak se transmetuesi nuk ka përmbushur kushtet minimale kuadroviqe të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale kuadroviqe, hapësinore, financiare dhe kadroviqe për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio (neni 62, paragrafi (6) të LShMAAV dhe nenit 21 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadroviqe për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio dhe nenit 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të LShMAAV);

- ShTR TV ShUTEL ShPKNJ P Shkup, të cilit i mbaroi vlefshmëria e lejes për transmetim televiziv sipas ligjit – me heqjen e lejes, për shkak se transmetuesi në afatin e parashikuar ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv (neni 80, paragrafi 5 dhe neni 85, paragrafi 1, nënparagrafi 4 të LshMAAV). Pas heqjes së lejes të transmetuesit Agjencia miratoi vendim për anulimin e e vendimit për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TV ShUTEL ShPKNJ P Shkup, sepse transmetuesi plotësisht e pagoi kompensimin vjetor të lejes;

- ShTR KLAN MAQEDONI ShPKNJ P eksport – import Saraj, Shkup të cilit i mbaroi vlefshmëria e lejes për transmetim televiziv sipas ligjit – me heqjen e lejes, për shkak se transmetuesi nuk ka përmbushur kushtet minimale kuadroviqe të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadroviqe për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio në afatin e parashikuar ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes (neni 62, paragrafi 6 të LShMAAV dhe nenit 21 të Rregullores dhe nenit 80, paragrafi (5) dhe nenit 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të LShMAAV).

Transmetuesit, lejet e të cilëve ka pushuar së vlefshmi për këtë shkak njoftoi Agjencinë se ndërpresin me ritransmetim të shërbimeve në radio:

- RSM - Universiteti „Shn. KIRILI DHE METODI“ në Shkup – Njësi organizative jofitimprurëse universitare RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM 92.9 dhe

- RSM – Universiteti Shtetëror „GOCE DELÇEV“ Shtip – Njësi organizative jofitimprurëse RADIO UNIVERSITARE RADIO UGD FM.

Masat e ndërmarra kundër operatorëve të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike

Masat e shqiptuara – paralajmërime publike

Për shkak të shkeljeve të LShMAAV, konstatuar nëpërmjet mbikëqyrjes së kryer programeve të operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik, në vitin 2025 Agjencia miratoi tetë aktvendime për sqiptim të masës paralajmërim publik, nga të cilat pesë aktvendime për shkak të ritransmetimit të shërbimeve programore që nuk janë të regjistruara në Agjenci (shkelje e nenit 141 të LShMAAV), dy aktvendime për shkak se operatori në paketën programore nuk ofron shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv (shkelje të nenit 144 paragrafi 3 të LShMAAV) dhe një aktvendim për shkak të ritransmetimit të shërbimi programor të transmetuesi vendas jashtë zonës së shërbimit për të cilën ka marrë lejen për transmetim televiziv (neni 143 paragrafi 1 të LShMAAV).

Procedurat e inicuar kundërvajtëse/procedurat e zbatuara për paqësim

Gjatë vitit 2025, në përputhje me dispozitat e Ligjit për kundërvajtje, është zbatuar një procedurë për paqësim - procedurë për dhënien e urdhërpagesës për kundërvajtje me një operator të rrjetit publik të komunikimeve elektronike (Total TV) dhe personin përgjegjës të operatorit. Procedura e zbatuar është përfunduar me sukses në vitin 2026, përkatësisht kryerësit e shkeljes në afatin e pëcaktuar ligjori kanë paguar gjatë e përcaktuara në urdhërpagesën për kundërvajtje.

KONTESTE ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURA PARA GJYKATËS KUSHTETUESE

Në vitin 2025 u inicua një procedurë kundërvajtëse¹² kundër akti të miratuar nga Agjencia.

Partia Politike Levica Shkup (PP Levica), e përfaqësuar nga prof. dr. Dimitar Apasiev, ngriti padi kundër Udhëzimit për Radiodifuzerët për Zgjedhjet Lokale të vitit 2025. Agjencia më 6.10.2025, drejtuar Gjykatës Administrative dorëzoi Përgjigje ndaj padisë, dhe po atë ditë gjykata miratoi Aktvendim me të cilin refuzon padinë, kundër të cilit paditësi ngriti ankesë në Gjykatën e Lartë Administrative të Shkupit. Agjencia gjithashtu dorëzoi përgjigje ndaj ankesës, dhe më 6.11.2025, Gjykata e Lartë Administrative miratoi Aktvendim me të cilin ankesën e PP Levica e refuzon si të pabazë, dhe konfirmoi Aktvendimin e Gjykatës Administrative me të cilin e refuzoi padinë e PP Levica për anulimin e Udhëzimit të Agjencisë.

Iniciativa për iniciimin e procedurave për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe për të kërkuar mbrojtje të lirive dhe të drejtave në Gjykatën Kushtetuese të RMV-së¹³

Gjatë vitit 2025, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut i kërkoi Agjencisë të deklarohet dhe të paraqesë mendim në lidhje me iniciativat e paraqitura për të vlerësuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë të:

- nenit 2 dhe 3 të Rregullores për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve platformë për ndarjen e videove paraqitur nga Igorço Toçev nga Shkupi dhe
- pika 3 dhe pika 10 të Udhëzimit për radiodifuzerët për Zgjedhjet Lokale 2025, paraqitur nga Partia Politike Levica.

Agjencia paraqiti mendime për dy nisma në afatin e përcaktuar ligjor, pas të cilave Gjykata Kushtetuese miratoi aktvendime sipas të cilës nuk inicohet procedurë për vlerësimin e kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë.

Në dhjetor të vitit 2025, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Agjencia të paraqesë përgjigje në lidhje me kërkesën për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave sipas nenit 110, paragrafi (3) të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut (diskriminim në bazë të përkatësisë politike), të paraqitur nga Partia Politike Levica. Gjykata Kushtetuese për kërkesën e lartpërmendur vendosi në seancën e dytë, të mbajtur më 28.1.2026, gjatë së cilës miratoi vendim për refuzim.

ANALIZA, STUDIME DHE HULUMTIME

Transmetuesit rajonalë dhe lokalë (arsyetim dhe mundësi për vënien e masave mbështetëse)¹⁴

¹² Të dhëna të detajuara për fillimin e kontestit administrativ janë paraqitur në pasqyrën tabelare në fund të Raportit „Konteste administrative në vitin 2025“ (Shtojcë nr. 1.8.).

¹³ Të dhëna të detajuara për iniciativat e paraqitura për iniciim të procedurës për vlerësim të kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe kërkesës së paraqitur për mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave të nenit 110 nënparagrafi 3 të Kushtetutës së RMV-së drejtuar Gjykatës Kushtetuese të RMV-së janë paraqitur në Shtojcë nr. 1.9. të Raportit „Iniciativat e paraqitura dhe kërkesa në Gjykatën Kushtetuese të RMV-së në vitin 2025“.

¹⁴ Disponueshëm në: <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2025/05/Мерки-за-поддршка-на-регионалните-и-локалните-радиодифузери.pdf>

Duke marrë parasysh sfidat me të cilat përballen transmetuesit rajonalë dhe lokalë (të ardhura të ulëta, jofitimprurës, shikueshmëri/dëgjueshmëri e ulët, resurse të pamjaftueshme njerëzore dhe teknike dhe treg i kufizuar reklamash), Agjencia përgatiti analizën "Transmetuesit rajonalë dhe lokalë (arsyetim dhe mundësi për vënien e masave mbështetëse)", e cila synon të përcaktojë se cilat masa mbështetëse duhet të futen për të inkurajuar zhvillimin dhe për të forcuar qëndrueshmërinë ekonomike të këtyre mediave. Për nevojat e analizës, ndër të tjera, Agjencia shqyrtoi mundësitë për futjen e disa stimuljeve tatimorë për këto media dhe si më të rëndësishme analizoi taksën mbi fitimin dhe taksën mbi vlerën e shtuar. Analiza tregoi se sfidat me të cilat përballen televizionet dhe radiot rajonale dhe lokale nuk mund të kapërcehen me format klasike të stimuljeve tatimorë dhe se është e nevojshme të vihet fond për zhvillimin e pluralizmit mediatic. Krijimi i fondi të tillë do të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë financiare për krijimin e përmbajtjeve të ndryshme dhe me cili të lartë mediatiche, forcimin e produksionit vendas, inkurajimin e gazetarisë investigative dhe të pavarur, si dhe punësimin dhe trajnimin e stafit profesional.

Analiza e tregut të shërbimeve mediatiche audio dhe audiovizuale për vitin 2024 ¹⁵

Në tremujorin e tretë të vitit, Agjencia përgatiti Analizën e Tregut të Shërbimeve Mediatiche Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024, e cila analizoi në detaje punën ekonomike të shërbimit publik (Radiotelevizioni i Maqedonasë - RTM) dhe transmetuesve komercialë në vitin 2024 nga aspekti i të ardhurave, shpenzimeve, rezultateve financiare të punës, si dhe nga aspekti i numrit të të punësuarve. Analiza u përgatit në bazë të të dhënave relevante që vetë transmetuesit i dorëzuan Agjencisë në kuadër të përmbushjes së detyrimit sipas nenit 15, paragrafi (1) të Ligjit për Mediat për të siguruar transparencë të punës, dhe besueshmëria e tyre u konfirmua përmes shqyrtimi të llogarive përfundimtare të transmetuesve, të dhëna nga Regjistri Qendror i RMV-së. Gjetjet kryesore të Analizës u prezantuan në takimimin e tretë publik të Agjencisë në vitin 2025, i cili u mbajt në shtator.

Struktura e të punësuarve në industrinë e mediave audio dhe audiovizuale në vitin 2024 ¹⁶

Në qershor, Agjencia përgatiti analizën "Struktura e të punësuarve në industrinë e mediave audio dhe audiovizuale në vitin 2024", e cila paraqet të dhëna për numrin dhe strukturën e të punësuarve në shërbimin publik radiodifuziv (RTM) dhe në transmetuesit komercialë, të analizuar nga aspekti i vendeve të punës në të cilat janë të angazhuar, nga aspekti i statusit të tyre (punësim i rregullt ose angazhim honorar), si dhe nga aspekti i gjinisë, nivelit të arsimit të përfunduar dhe përkatësisë etnike.

Studim për përcaktimin e arsyeshmërisë për shpallje të konkursi publik për dhënie e lejes për radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Prilepit ¹⁷

Në përputhje me kompetencat ligjore, dhe bazuar në kërkesën e paraqitur nga palë e interesuar, Agjencia në prill përgatiti studim që kishte si qëllim të përcaktonte nëse ekziston arsyeshmëri për dhënie e lejes për transmetim në radio në zonën e Prilepit. Për të përcaktuar më saktë arsyeshmërinë për hapjen e një radiostacioni të ri, studimi

¹⁵ Disponueshëm në: <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2025/09/Анализа-на-пазарот-на-аудио-и-аудиовизуелни-медиумски-услуги-за-2024-година-1.pdf>

¹⁶ Disponueshëm në: <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2025/06/Структура-на-вработените-во-аудио-и-аудиовизуелната-медиумска-индустрија-во-2024-година.pdf>

¹⁷ Disponueshëm në: <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2025/04/Студија-за-утврдување-на-оправданоста-за-објавување-јавен-конкурс-за-радио-во-Прилеп-1.pdf>

ka bërë analizë të ofertës programore të radiostacioneve ekzistuese në këtë zonë, performancën e tyre ekonomike, si dhe potencialin e tregut, përkatësisht publikun potencial dhe reklamuesit potencialë në Prilep. Studimi tregoi se ekziston arsyeshmëri për shpallje të konkursi publik, për shërbim programor radio muzikore me format të specializuar ku muzika e transmetuar është kryesisht argëtuese, dhe gjuha e transmetimit të shërbimit programor është maqedonisht dhe serbisht.

Studim për përcaktimin e arsyeshmërisë për shpallje të konkursi publik për dhënien e lejes për radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës ¹⁸

Pas kërkesës së dorëzuar nga palë e interesuar për dhënien e lejes për radio muzikore-folëse me format kryesisht të përgjithshëm informativ në zonën e komunës së Strugës, Agjencia në prill përgatiti studim për përcaktimin e arsyeshmërisë për shpallje të konkursi publik për radiostacion të tillë. Për të perceptuar në mënyrë objektive gjendjen e tregut në zonën e caktuar, për përgatitjen e studimit u shfrytëzuan të dhëna relevante në bazë të të cilit u analizua oferta programore dhe kushtet e tregut në Strugë. Duke marrë parasysh se mbi gjysma e banorëve në këtë komunë janë të përkatësisë etnike shqiptare, dhe në atë kohë radiostacioni i vetëm në këtë zonë transmetonte program në gjuhën maqedonase, si dhe faktin se Struga është komunë me potencial të konsiderueshëm tregu, studimi konstatoi se ekziston arsyeshmëri për shpallje të konkursi publik për radio lokale muzikore-folëse me format të përgjithshëm kryesisht informativ, ku pjesa folëse e programit do të transmetohet në gjuhën shqipe dhe maqedonisht.

Studim për përcaktimin e arsyeshmërisë për shpallje të konkursi publik për dhënien e lejes për radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Shtipit ¹⁹

Në prill, Agjencia përgatiti edhe studim për radion lokale në Shtip - gjithashtu me kërkesë të pale të interesuar. Për të përmbushur qëllimin për të cilin është përgatitur, ky studim analizoi gjendjen aktuale të tregut të radios në Shtip, përkatësisht ofertën ekzistuese programore, performancën ekonomike, reklamuesit potencialë dhe publikun potencial. Studimi tregoi se ekziston arsyeshmëri për shpallje të konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal në zonën e komunës së Shtipit, për shërbim programor radio muzikore me format të specializuar, në gjuhën maqedonase, në të cilin muzika e transmetuar është kryesisht popullore.

Analiza e tregut mediatik në Maqedoni (karakteristikat strukturore dhe performanca ekonomike)

Në vitin 2025, me qëllim që të ofrojë pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe të saktë mbi fushëveprimin dhe karakteristikat e tregut mediatik në Maqedoni, Agjencia filloi përgatitjen e Analizës së tregut të medias në Maqedoni (karakteristikat strukturore, qëndrueshmëria ekonomike dhe mundësitë e zhvillimit). Fokusi i kësaj analize janë katër sektorë mediatikë: media e shkruar, media online - portalet e internetit, stacionet televizive dhe radio, dhe shqyrton karakteristikat strukturore të tregut; barrierat për hyrje dhe shkallën e rregullimit sipas sektorëve; numrin e subjekteve në secilin prej sektorëve mediatikë; dhe të ardhurat, strukturën e të ardhurave, shpenzimet dhe rezultatet e punës në vitin 2024. Analiza u finalizua në vitin 2026 dhe u publikua në ueb-faqen e Agjencisë.

¹⁸ Disponueshëm në: https://avmu.mk/wp-content/uploads/2025/04/Studim_për_përcaktim_të_arsyeshmërisë_për_publikim_konkurs_public_për_radio_në_Strugë.pdf

¹⁹ Disponueshëm në: https://avmu.mk/wp-content/uploads/2025/04/Studim_për_përcaktim_të_arsyeshmërisë_për_publikim_konkurs_public_për_radio_në_Shtip.pdf

Hulumtime mbi mendimin dhe qëndrimin e publikut në lidhje me mediat ²⁰

Në gjysmën e dytë të vitit, Agjencia konceptoi hulumtimin e mendimit publik, qëllimi i së cilës ishte të ofronte njohuri më të mira mbi qëndrimet dhe pritjet e qytetarëve, zakonet dhe preferencat në përdorimin e medias, si dhe cilat lloje të përmbajtjes mediatike mungojnë ose kërkojnë përmirësim të cilësisë, që do të paraqet bazë të rëndësishme për krijimin e politikave dhe masave për avancim cilësor dhe diversitet të përmbajtjes mediatike. Agjencia konstatoi se hulumtimi duhet të kryhet në mostër të përfaqësuar statistikisht prej së paku 1,000 anketues, duke shfrytëzuar instrumentin e kërkimit pyetësor gjysmë të strukturuar, për intervista ballë për ballë, dhe se duhet të ofrojë të dhëna së paku për: teknologjinë dhe zakonet e qytetarëve në shfrytëzimin e saj; burimet nga të cilat qytetarët marrin informacion dhe besim në media; nivelin e kënaqësisë nga oferta ekzistuese televizive; nivelin e kënaqësisë me ofertën ekzistuese radiofonike; qëndrimet e qytetarëve ndaj ofruesve të rinj të përmbajtjeve mediatike (influencues/vlogerë/kreator të përmbajtjeve). Përfaqësues të Agjencisë morën pjesë gjithashtu në finalizimin e pyetësorit, i cili u bazua në gjetjet e studimit pilot. Studimi në terren u krye në periudhën nga 27 dhjetor 2025 deri më 25 janar 2026, dhe raporti përfundimtar iu dorëzua Agjencisë në mars 2026.

AKTIVITETE TË TJERA TË AGJENCISË**U miratuan dhe ndryshimet e akteve të brendshme dhe të përgjithshme të Agjencisë**

Në vitin raportues, Agjencia miratoi/ndryshoi aktet e mëposhtme:

- Rregulloren e punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele;
- Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele;
- Rregullore për masat teknike dhe organizative për sigurimin e fshehtësisë, mbrojtjes dhe sigurisë së përpunimit të të dhënave personale të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele;
- Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mënyrën e kryerjes së video mbikëqyrjes në objektin ku ndodhet selia e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele;
- Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përcaktimin e kohëzgjatjes së pushimit vjetor të punonjësve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele;
- Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mënyrën e shfrytëzimit, drejtimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve zyrtare të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele;
- Udhëzim për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës;
- Metodologjia e vlerësimit të rrezikut;
- Politika për privatësi;
- Politika për mbrojtjen e të dhënave personale të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele;
- Plani vjetor për parandalimin e korrupsionit të Agjencisë për vitin 2026;
- Plani Vjetor për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026.

²⁰ Disponueshëm në: [Raport mbi zbatimin e hulumtimit të mendimit publik](#)

Veprimi sipas kërkesave që rrjedhin nga Ligji për qasje të lirë në informacion me karakter publik dhe përditësimi i listave me informacion me karakter publik

Drejtuar Agjencisë, si posedues i informacionit publik, gjatë vitit 2025 iu paraqitën gjithsej tre kërkesa për informacion me karakter publik. Për një kërkesë, Agjencia ofroi qasje të plotë në informacionin e kërkuar, për një kërkesë ka kryer dërgesë në organin kompetent për veprim, ndërsa në një rast pjesa e dërguar e kërkesës iu kthye dërguesit sepse Agjencia nuk e kishte informacionin e kërkuar.

Bëhet fjalë për kërkesat e mëposhtme:

- **Në janar**, nga ana e Qeverisë së RSM-së – Sekretar i përgjithshëm, drejtuar Agjencisë iu dërgua pjesë e kërkesës për qasje në informacione me karakter publik (e dorëzuar më në tetor 2024). Meqënëse Agjencia konstatoi se nuk disponon me informacionet e kërkuara, pjesën e lëndës së kërkesës iu kthye Sekretariatit të përgjithshëm;
- **Në shtator**, nga prof.dr. Dimitar Apasiev, drejtuar Agjencisë është paraqitur kërkesë për qasje të lirë në informacione me karakter publik, duke kërkuar të dhëna për fondet që i takojnë partisë politike Levica për reklamim të paguar politik (RPP) në televizione, media të shtypit dhe portale për Zgjedhjet e ardhshme Lokale. Argjencia konstatoi se nuk e krijoi dhe nuk disponon me informacionin e kërkuar, prandaj në përputhje me nenin 18 të Ligjit, në afatin e përcaktuar ligjor e dërgoi kërkesën në komisionin Shtetëror Zgjedhor si posedues kompetent të informacionit dhe të njoftoi me shkrim kërkuuesin në fjalë;
- **Në dhjetor**, nga personi fizik Joana Treneska është paraqitur kërkesë për qasje të lirë në informacion me karakter publik, që i referohej pyetjes se kur do të publikohen raportet për reklamim të paguar politik dhe raporti mbi përfaqësimin mediatik në rrethin e dytë të Zgjedhjeve lokale 2025. Argjencia konstatoi se disponon me informacionin e kërkuar dhe mundësoi qasje të plotë.

Informacione më të hollësishme në lidhje me kërkesat e paraqitura dhe përgjigjet ndaj kërkesave janë të disponueshme në ueb- faqen e Agjencisë, në linkun e mëposhtëm: [Барања и одговори - АБМУ](#).

Bashkëpunimi me institucionet e tjera

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme

Agjencia ka bashkëpunuar me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme në tre raste. Së pari, u dërgua Mendim në lidhje me Informacionin mbi Raportin e Gjashtë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas Konventës Kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare, më pas punonjësit e Agjencisë u nominuan si përfaqësues të organit rregullator në dy grupe pune në kuadër të iniciativës "Partneriteti për Informacion dhe Demokraci", njëri prej të cilëve më vonë mori pjesë në takimin online "Partneriteti për informacion dhe forcimi

demokratik i integritetit të platformave për ndarjen e mesazheve", të bashkëkryesuar nga Luksemburgu dhe Ukraina.

Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, Demografi dhe Rini

Bashkëpunimi me Ministrinë për Politikë Sociale, Demografi dhe Rinisë në vitin 2025 u përqendrua në dy tema - barazia gjinore dhe të rinjtë. Informacioni i detajuar mbi aktivitetet që lidhen me çështjet gjinore ofrohen në pjesën e këtij raporti kushtuar Barazisë Gjinore dhe Transmetimit.

Komunikimi në lidhje me Planin e Veprimit 2023-2025 për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2023-2027 u zhvillua në disa faza. Kërkesa e parë nga Ministria për mendim mbi përmbajtjen e Planit të Veprimit konstatoi se Agjencia nuk ishte konsultuar dhe as nuk ishte njoftuar fare për miratimin e këtij Plani të Veprimit, as për tre aktivitetet për të cilat ASHAMA ishte treguar si institucioni përgjegjës dhe udhëheqës. Ministria u njoftua për këtë, por gjatë komunikimit tjetër - kërkesës që Agjencia të përgjigjej në pyetësorin mbi nivelin e zbatimit të Planit të Veprimit për Rininë 2023 - 2025, u konstatua se informacioni i mëparshëm nga Agjencia nuk ishte marrë parasysht. Prandaj, edhe në këtë rast, Agjencia tregoi se, megjithëse ishte aktive në procesin e përgatitjes së Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2023-2027, nuk ishte konsultuar dhe as nuk ishte njoftuar për përgatitjen e Planit të Veprimit, prandaj roli dhe kompetencat e saj ishin të definuara në mënyrë të pamjaftueshme, dhe aktivitetet e parashikuara ishin të pazbatueshme. Njëkohësisht, u rikujtua se cilat aktivitete mbi temën e të rinjve dhe medias kishte ndërmarrë Agjencia me iniciativën e saj, në kuadër të kompetencave të saj. Në fund të vitit, gjatë thirrjes për diskutim mbi versionin e dytë të draftit të Planit të Veprimit 2026-2027 për Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2023-2027, u konstatua se sugjerimet e mëparshme me shkrim ishin përfshirë plotësisht në tekst.

Sa i përket monitorimit të gjendjes së përfshirjes së të rinjve në shoqëri, Agjencia mori pjesë në eventin "Rinia, Media dhe Integrimi në BE" me ftesë të Unionit Rinor - Krushevo. Eventu shërbeu si platformë për prezantimin e rezultateve kryesore të Analizës së përfshirjes së të rinjve në procesin e Integritimit në BE, perceptimet e tyre, interesat, niveli i informacionit dhe mbulimi i politikave evropiane. Përveç prezantimit të rezultateve, u ndanë edhe rekomandime konkrete të krijuara nga të rinjtë, me qëllim përmirësimin e komunikimit publik rreth procesit të integritimit evropian dhe forcimin e pjesëmarrjes së të rinjve.

Aktivite të tjera

Disa nga aktivitetet gjatë vitit lidheshin me luftën kundër ekstremizmit, siç ishte pjesëmarrja në debatin e ekspertëve: "Hetimet në Internet mbi Ekstremizmin dhe të Drejtat e Njeriut" të organizuar nga "Horizon Civitas" dhe Qendra për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (Holandë), si dhe paraqitja pasuese e propozimeve/rekomandimeve për zbatimin e kornizës ligjore për hulumtim të përmbajtjes terroriste, i cili do të shërbejë për krijimin e dokumenti me përfundime nga ngjarja.

Gjithashtu, përfaqësues të Agjencisë morën pjesë në eventin "Përmirësimi i rregullimit të medias në Maqedoninë e Veriut - Harmonizimi me normat e UE-së", të organizuar nga Fondacioni "Konrad Adenauer" dhe Qendra për Studime Evropiane "Vilfried Martens", dhe folën për ndryshimet e nevojshme në Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, si dhe regjistrin vullnetar të mediave online të parashikuara në ndryshimet në Ligjin për Median.

Përfaqësuesit e Agjencisë morën pjesë edhe në aktivitete të tjera:

- Konferenca „Klikovi, paratë dhe ndikimi: rolet dhe përgjegjësitë e mediave online në zgjedhje“, organizuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES) me mbështetje të Ambasadës Britanike, në të cilën përfaqësuesja e Agjencisë ishte paneliste në ditën e dytë të eventit dhe foli për mbikëqyrjen e reklamave politike me pagesë, rolet institucionale dhe kushtet në ndryshim në epokën dinamike digjitale.
- Konferenca „Votues të informuar: Strategji për edukim dhe informin efektiv“, e organizuar nga KShZ, EShR, IFES dhe OSBE/ODIHR, në të cilën panelist ishte drejtori i Agjencisë.
- Konferenca shkencore „Kurthi narativ: zbulimi i narrativave të dëmshme të politikanëve dhe mediave“, organizuar nga Instituti për Studime të Komunikimit (IKS).
- Konferenca „Së bashku për të vërtetën: Qasje gjithëpërfshirëse e të gjithë shoqërisë për mbrojtjen e demokracisë“, organizuar nga „Metamorfozis“ me rastin e Ditës Ndërkombëtare të verifikimit të fakteve, në të cilën paneliste ishte përfaqësuese e Agjencisë.
- Diskutim „Nyja Goediane e e narrativave të dëmshme në politikë dhe mediat“ organizuar nga IKS.
- Takim pune mbi implementimin e zbatimit të Ligjit të shërbimeve digjitale të UE-së (DSA), organizuar nga Fondacioni „Metamorfozis“.
- Punëtori „Platformat digjitale dhe udhëheqja me mediat online në Maqedoninë e Veriut“, organizuar nga Fondacioni „Metamorfozis“ dhe „Partnes Serbia“.
- Takime pune të grupit koordinues ndërinstitucional mbi ndërhyrje e huaja në manipulimit me informacione (SMMI), të inicuar nga Instituti për Studime të Komunikimit. Në kuadër të këtij aktiviteti u zhvilluan intervista të thella dhe u prezantuan rezultatet e arritura. Si pjesë e përgatitjes së dokumentit të politikave publike mbi sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e lidhshmërisë dhe koordinimit ndërinstitucional për të siguruar përgjigje më sistematike ndaj ndërhyrjeve të huaja dhe manipulimit të informacionit, është kryer hulumtim nëpërmjet grupi fokusi, në të cilën përveç AshMA-së morën pjesë dhe përfaqësues të Ministrisë për Transformim Digjital, Ministria për Administratë Publike, QKRIK dhe KShZ.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Pjesëmarrja në punën e shoqatave të organeve rregullatore në fushën audiovizuale: Platforma evropiane e organeve rregullatore (EPRA), Rrjeti mesdhetar i organeve rregullatore (MNRA), Grupi i rregullatorëve evropian për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ERGA)/ Bordi evropian i shërbimeve mediatike, në evente me karakter ndërkombëtar relevante për fushën audiovizuale, realizim i bashkëpunimit dhe marrëdhënieve dypalëshe me organet rregullatore në Evropë, veçanërisht me organet rregullatore nga rajoni

Bordi Evropian i Shërbimeve të Medias

Më 27 janar, përfaqësues i Agjencisë online mori pjesë në takimin e jashtëzakonshëm plenar të Grupit të Rregullatorëve Evropianë për Shërbime Mediatike Audiovizuale (ERGA). Takimi miratoi disa nga raportet e nëngrupeve që po përgatiteshin gjatë vitit 2024, u diskutua për rregulloren e punës të organit të ri rregullator në të cilin ERGA duhet të transformohet në përputhje me Aktin Evropian të lirisë së medias të miratuar dhe programet e

punës së nëngrupeve në vitin 2025, dhe u shqyrtuan informacioni në lidhje me ndryshimin në politikën e Metës në lidhje me verifikimin e fakteve nga aspekti i ndikimit të mundshëm në tregun evropian.

Më 11 prill, përfaqësuesi i Agjencisë mori pjesë në takimin plenar online të Bordit të ri Evropian të Shërbimeve të Medias (Media Board) të rregullatorëve të medias të UE-së, i cili zëvendësoi platformën e mëparshme të Grupit të Rregullatorëve Evropianë për Shërbimet Mediatike Audiovizuale (ERGA) të rregullatorëve evropianë.

Më 5 qershor, përfaqësuesi i Agjencisë online mori pjesë në takimin e Rrjetit të kontaktit të Bordit Mediatik të mbajtur në Bruksel. Takimi ishte në funksion të përgatitjes të takimin plenar të Bordit, të planifikuar për 30 qershor, dhe u shqyrtuan draft-raportet dhe dokumente të tjera nga puna e nëngrupeve.

Më 30 qershor, përfaqësuesi i Agjencisë online mori pjesë në pjesë të takimit plenar të Bordit Mediatik të mbajtur në Bruksel.

Më 20 nëntor, përfaqësuesi i Agjencisë mori pjesë në Takimin e Tretë të Kontakt-rrjetit të Bordit Mediatik, i cili u mbajt në Bruksel, në ambientet e Komisionit Evropian. Takimi iu kushtua aktiviteteve në vazhdim dhe grupeve të punës të Bordit Mediatik në kontekstin e zbatimit të Aktit Evropian për lirinë e medias dhe Direktivës së Shërbimeve Mediatike Audiovizuale. Në kuadër të programit të punës u diskutua për zhvillimet në politikat evropiane të medias, mbrojtjen e të miturve, rregullimin e influenserëve, pluralizmin e tregut, matjen e publikut, integritetin e hapësirës së informacionit, arsimimin mediatik dhe mekanizmat për bashkëpunim ndërinstytucional. U prezantuan draft - raportet e grupeve të punës, detyrat e rregullatorëve që rrjedhin nga Akti Evropian për lirinë e medias dhe përgatitjet për Takimin Plenar në dhjetor 2025.

Më 9 dhe 10 dhjetor, përfaqësuesi i Agjencisë online mori pjesë në punëtorin dhe në takim plenar të Bordit Mediatik në Barcelonë, Spanjë, në prag të Takimit Plenar.

EPRA

Përfaqësuesit të Agjencisë morën pjesë në takimet e pranverës dhe të vjeshtës të EPRA-s.

Nga data 14 deri më 16 maj, përfaqësuesi i Agjencisë morën pjesë në takimin e 61-të të Platformës Evropiane të Organeve Rregullatore (EPRA), i cili u mbajt në Kishinau, Republika e Moldavisë. Në takim u diskutuan për zhvillimet kryesore të rregullativës mediatike, me theks të veçantë në mbrojtjen e fëmijëve në internet, si dhe në përmirësimin e punës dhe praktikës së rregullatorëve të bazuar në prova.

Më 23 dhe 24 tetor, përfaqësuesit e Agjencisë morën pjesë në takimin e 62-të të Platformës Evropiane të Organeve Rregullatore të Medias (EPRA), i cili u mbajt në Jerevan, Armeni. Takimi paraqiti gjendjen aktuale në kuadrin e pronësisë së medias dhe gjetjet kryesore të iniciativës së Monitorimit të pronësisë së medias (Media Ownership Monitor). Sesioni i parë i takimit iu kushtua pluralizmit mediatik në epokën digjitale, ku pjesëmarrësit diskutuan për kompleksitetin e pluralizmit, ndikimin e qeverisjes së platformës dhe inteligjencës artificiale, si dhe rreziqet që lidhen me paragjykimin algoritmik dhe transparencën. Sesioni i dytë tematik u përqendrua në proceset e planifikimit strategjik dhe zbatimit të politikave në kontekstin e ndryshimit të shpejtë të mjedisit, me shkëmbimin e praktikave më të mira nga organe të ndryshme rregullatore.

Më 7 mars, Agjencia dorëzoi përgjigje të mendimit të kërkuar nga EPRA mbi rolin dhe punën e Komitetit drejtues për median dhe shoqërisë së informacionit (Steering Committee on Media and Information Society-CDMSI), organ

në të cilin ekspertë nga shtetet anëtare përgatisin proceset për marrjen e vendimeve të Këshillit të Evropës në lidhje me median dhe lirinë e shprehjes.

Gjatë vitit, përfaqësueset e Agjencisë mori pjesë në tre takimet e Rrjetit të Arsimit Mediatik EPRA - EMIL (10 janar, 7 mars dhe 5 dhjetor), në të cilat u shkëmbyen informacione dhe përvoja nga projektet dhe aktivitetet e anëtarëve.

Gjatë vitit, Agjencia iu përgjigj gjashtë pyetësorëve që u postuan në faqen e EPRA-s. Dy prej tyre lidheshin me temat e seancave plenare të platformës - "Rregullorja e bazuar në prova", për takimin e pranverës dhe "Si të vihen strategji në mjedis dinamik dhe si të zbatohen?", për takimin e vjeshtës të EPRA-s. Gjatë vitit, rregullatorët iu përgjigjën edhe disa pyetësorëve - "Kuptimi i rolit të organeve të tjera rregullatore kombëtare në avancimin dhe mbrojtjen e pluralizmit mediatik në vendin e tyre" nga rregullatori irlandez, "Fusha e zbatimit të rregullave të plasimit" nga rregullatori francez, "Kanalet televizive të dedikuara ekskluzivisht për reklama" nga rregullatori malazez i medias, si dhe pyetësi i rregullatorit maltez që lidhej me shpërndarjen e shërbimeve televizive.

MNRA

Mbledhja e 24-të Plenare e MNRA-së u mbajt në Prishtinë, Kosovë, nga 1 deri më 3 tetor, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Agjencisë. Temat kryesore të konferencës ishin mbrojtja e të miturve në hapësirën online, gazetaria e gjelbër, arsimimi mediatik dhe barazia gjinore në media, si dhe lufta kundër gjuhës së urrejtjes dhe manipulimit të informacionit.

Aktivitete të tjera ndërkombëtare

Më 8 janar, përfaqësuesit e Agjencisë patën takim online me përfaqësuesit e rregullatorit nga Letonia, në të cilin u diskutua monitorimi gjatë zgjedhjeve, si dhe u prezantuan mjetet e monitorimit të përdorura nga ky rregullator.

Më 5 shkurt, përfaqësuesi i Agjencisë mori pjesë në panel-diskutimin "Raportimi etik dhe rezistenca ndaj manipulimit të informacionit", të cilin Ministria e Çështjeve Evropiane e organizoi në Shkup si pjesë e projektit pilot "Dialogu midis Shoqërisë Civile nga Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria", i financuar nga Delegacioni i UE-së në Shkup.

Më 6 dhe 7 shkurt, përfaqësuesit e Agjencisë zhvilluan një vizitë dy-ditore në Komisionin e Pavarur të Medias të Republikës së Kosovës në Prishtinë. Gjatë takimit dypalësh, u shkëmbyen përvoja dhe praktika të mira në fushën e rregullimit mediatik, veçanërisht në kontekstin e proceseve zgjedhore. Fokus i veçantë iu kushtua kornizës ligjore dhe rolit të rregullatorit gjatë proceseve zgjedhore, mënyrës së zbatimit të monitorimit të përmbajtjeve mediatike gjatë proceseve zgjedhore - rregullimit zgjedhor, resurseve teknike dhe njerëzore të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të monitorimit, si dhe shkeljeve më të zakonshme të dispozitave të rregullativës zgjedhore që janë konstatuar nga të dy rregullatorët. Gjatë takimeve u prezantua edhe sistemi i Kosovës për monitorimin e përmbajtjeve programore të transmetuar në radio dhe televizion dhe për marrjen e sinjaleve nga operatorët që rritshmetojnë shërbime programore.

Më 20 mars, përfaqësuesit e Agjencisë mbajtën takim pune me Ambasadorin e Republikës së Francës, Sh.t.z. Kristofer Le Rigoler. Gjatë takimit u diskutua puna e rregullatorit dhe sfidat me të cilat përballlet, zbatimi i legjislacionit

maqedonas që është në përputhje me Direktivën për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale të Unionit Evropian dhe nevoja për përafrimin e tij të mëtejshëm me aktet dhe standardet evropiane, si dhe Kodin Zgjedhor në pjesën për median dhe monitorimin e prezantimit mediatic të zgjedhjeve.

Më 4 qershor, përfaqësues i Agjencisë mori pjesë në konferencën me temë “Rishikimi i ardhshëm i Direktivës së Shërbimeve Mediatike Audiovizuale (AVMSD): Gjithçka varet nga definicioni!”, e cila u mbajt në Vjenë, Austri. Në konferencë u mbajtën dy panel-diskutime. Tema e diskutimit të parë ishte “Cilat rregulla vlejnë për kë?”, dhe theksi u vu në kompleksitetin dhe domosdoshmërinë e saktësisë ligjore në përcaktimin e shërbimeve mediatike. Diskutimi i dytë në panel ishte me temën “(Si) duhet të zhvillohet rregullimi i reklamave në epokën e influencerëve?” dhe u përqendrua në ndikimin në rritje të influencerëve.

Më 2 tetor, përfaqësues i Agjencisë mori pjesë në Samitin e shtatë për transformimin digjital të Ballkanit Perëndimor në Shkup, të organizuar bashkërisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Këshilli për bashkëpunim rajonal. Eventi theksoi angazhimin ndaj transformimit digjital rajonal, integritetit evropian dhe zhvillimit të shërbimeve dhe aftësive digjitale.

Më 27 tetor, në ambientet e Agjencisë u zhvillua përsëri takim pune me Ambasadorin e Republikës së Francës, Sh.t.z. Kristof Le Rigoler. Takimi iu kushtua çështjeve të rregullimit mediatic, me theks në mundësitë për prani më të madhe të përmbajtjeve audiovizuale franceze që ritransmetohet në vend. Diskutimi përfshinte dhe tema që lidhen me harmonizimin e legjisllacionit kombëtar me kornizat ligjore evropian, veçanërisht në pjesën e Aktit për shërbime digjitale si dhe nevojën për ndryshime dhe plotësime në Kodin Zgjedhor në drejtim të kapërcimit të dobësive ekzistuese në sistemin zgjedhor dhe mediatic.

Më 6 nëntor, përfaqësues i Agjencisë mori pjesë në takimin online "Partneriteti për informacion dhe forcimin demokratik të integritetit të platformave për ndarjen e Mesazheve", të bashkëkryesuar nga Luksemburgu dhe Ukraina

Më 16 dhjetor, përfaqësues i Agjencisë mori pjesë në takim koordinues me përfaqësues të "ACT" ShPK dhe pesë organe rregullatore nga rajoni në lidhje me aktivitetet e projektit të financuar nga UE për "Ndërtimi i besimit në media në Evropën Juglindore: Mbështetja e Gazetarisë si e mirë publike".

Bashkëpunimi me misionin e OSBE-së në Shkup, përfaqësuesi i për lirinë e shprehjes i OSBE-së, OSBE/ODIHR dhe me organe të tjera ndërkombëtare, aktivitetet e të cilave lidhen me lirinë e mediave dhe monitorimin e prezantimit mediatic gjatë fushatës zgjedhore

Më 5 shkurt, u mbajt takim pune mbi procesin e përgatitjes së specifikimit teknik për furnizim publik për përgatitjen e aplikacioni softuerik për monitorimin e reklamave politike me pagesë, të financuara nga IFES. Specifikimi u finalizua në prill, i ndjekur nga disa takime të tjera pune me përfaqësues nga IFES dhe operatorit ekonomik përgjegjës për përgatitjen e aplikacionit, në të cilat u shqyrtua dhe u diskutua procesi për përgatitjen e zgjidhjes softuerike, që synon të sigurojë transparencë, monitorim efektiv dhe llogaridhënie të reklamave politike në media. U shkëmbyen detaje teknike dhe operacionale mbi zhvillimin, zbatimin dhe bashkëpunimin e mëtejshëm.

U vrealizua bashkëpunim me IFES-in dhe u mbajtën disa takime në lidhje me hulumtimin që Agjencia planifikonte të kryente si aktivite shtesë ndaj detyrimeve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Konkretisht, bëhej fjalë për pilot-

monitorimin të publikimeve të influencerëve gjatë Zgjedhjeve Lokale 2025. Përdorimi i këtij mjeti softuerik u mundësua edhe financiarisht nga IFES. Pas trajnimit të punonjësve dhe kontrollit të mostrës, më 29 shtator filloi mbledhja e të dhënave përmes softuerit për pilot-monitorimin e publikimeve të influencerëve gjatë Zgjedhjeve Lokale 2025.

Më 4 dhe 5 mars, disa përfaqësues të Agjencisë morën pjesë në konferencë me temë: "Klikimet, paratë dhe ndikimi: rolet dhe përgjegjësitë e mediave online në zgjedhje", si pjesë e projektit "Paratë, mediat dhe zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut", të organizuar nga IFES dhe të financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Shkup. Më 4 mars, përfaqësues i Agjencisë kishte prezantim në sesionin "Numërimi deri në zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut: Si të forcohet transparenca dhe mbikëqyrja e reklamimit të paguar politik gjatë fushatës mediatike, përfshirë dhe portalet online?" Në ditën e dytë të eventit, paneliste nga Agjencia foli për mbikëqyrjen e reklamave politike me pagesë, rolet institucionale dhe kushtet në ndryshim në epokën dinamike digjitale.

Më 11 dhe 12 mars, përfaqësuesit e Agjencisë morën pjesë në punëtorinë "Mësime nga zgjedhjet Rumune të vitit 2024: Forcimi i integritetit zgjedhor në Ballkanin Perëndimor", të organizuar nga Zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (ODIHR) dhe Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES), në kuadër të projektit "Mbështetja e reformave zgjedhore në Ballkanin Perëndimor". Punëtorja synonte ta transformonte momentin e krizës në mundësi për të mësuar, bashkëpunim dhe reforma dhe për të siguruar transparenca, efikasitet dhe qëndrueshmëri të proceseve zgjedhore ndaj manipulimeve në Ballkanin Perëndimor. Fokusi kryesor ishte vënë në rrjetet sociale, fushatat (online) dhe financimin e tyre, si dhe sfidat që lidhen me median.

Më 17 qershor, përfaqësues i Agjencisë mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare "Qytetarë të informuar: Strategji për edukim efektiv dhe informim të votuesve", organizuar nga IFES. Në fjalimin e tij, ai trajtoi rëndësinë e informacionit dhe edukimit si bazë për ndërtimin e besimit të votuesve.

Më 25 qershor, përfaqësuesit e Agjencisë mbajtën takim pune me përfaqësues të OSBE/ODIHR-it. Takimi u mbajtë në kuadër të vendosjes së misionit të OSBE/ODIHR-it për të vëzhguar Zgjedhjet lokale të vitit 2025. Në takim u diskutua puna e Agjencisë gjatë zgjedhjeve, duke përfshirë kornizën ligjore për prezantimin mediatik të zgjedhjeve, si dhe mënyrën se si kryhet monitorimi i transmetuesve gjatë kësaj periudhe.

Më 15 korrik, përfaqësuesit e Agjencisë morën pjesë në eventin "Llogaridhënia financiare e zgjedhjeve", e cila u mbajt në hotelin "Holidej in" në Shkup. Në kuadër të sesionit të dytë, "Ndikimet institucionale para zgjedhjeve të vitit 2025", përfaqësuesi i Agjencisë trajtoi rolin e rregullatorit në sigurimin e prezantimit të drejtë dhe transparent mediatik gjatë fushatave zgjedhore, si dhe aktivitetet dhe vizionin e planifikuar për kapërcimin e sfidave në vitin 2025. Event i cili u organizua nga Enti shtetëror për revizion, me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup dhe Ambasadës së Zvicrës, mbledhi së bashku përfaqësues të institucioneve përkatëse me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe praktikave për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe besimit në procesin zgjedhor.

Më 19 gusht, përfaqësuesit e Agjencisë zhvilluan takim pune me një punonjëse të Komitetit për të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara, lidhur me bashkëpunimin e mundshëm në aktivitete që lidhen me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara shqisore, në përgjithësi, dhe gjatë zgjedhjeve.

Përfaqësuesit e Agjencisë, në periudhën 16-17 shtator, në Varshavë të Polonisë, morën pjesë në seminarin rajonal "Mbrojtja e integritetit zgjedhor në Ballkanin Perëndimor: Forcimi i mbikëqyrjes dhe besimit", të organizuar nga

ODIHR. Eventi përfshinte prezantime hyrëse mbi mekanizmat institucionalë dhe bashkëpunim, leksion kryesor mbi besimin në demokraci dhe institucionet mbikëqyrëse, si dhe sesione kushtuar mekanizmave ligjor për mbrojtje, mbikëqyrjes së zgjedhjeve, reklamave mediatike dhe politike, inteligjencës artificiale, financimit të fushatave dhe rolit të shoqërisë civile. Ndër të tjera, u prezantuan sfidat dhe praktikatat më të mira për transparencë dhe koordinim midis institucioneve dhe përballjen me dezinformim.

Më 22 shtator, në ambientet e AShMA-së u mbajtë takim pune midis përfaqësuesve të Agjencisë dhe OSBE/ODIHR-it, me fokus në monitorimin e të dy institucioneve gjatë Zgjedhjeve lokale 2025.

Më 30 shtator, ODIHR-it iu dorëzua përgjigje në lidhje me pyetjen e tyre për dorëzim të parashtrës në Agjenci nga partia politike Levica në lidhje me Draft-udhëzimin për transmetuesit për Zgjedhjet lokale 2025.

Më 18 tetor, përfaqësues i Agjencisë mori pjesë në takim me delegacionin e Kongresit të autoriteteve lokale dhe rajonale të Këshillit të Evropës, të organizuar në kuadër të Misionit të për vëzhgimin e Zgjedhjeve Lokale 2025. Takimi u organizua në formën e panel-diskutimi me përfaqësues të mediave në vend dhe u përqendrua në prezantimin mediatik të fushatës zgjedhore, respektimin e parimeve të raportimit të drejtë dhe të balancuar, rolin e institucioneve me kompetenca në mbikëqyrjen e mediave dhe përvojat me procedurat e ankesave. Përveç kësaj, u ngritën pyetje që lidhen me gjendjen e mediave dhe lirinë e shprehjes në Maqedoninë e Veriut, gjatë të cilave u prezantuan kompetencat dhe aktivitetet e Agjencisë gjatë periudhës zgjedhore.

Më 27 tetor, përfaqësuesit e Agjencisë patën takim pune me analisten e medias të OSBE/ODIHR-it, në të cilin diskutuan mbi prezantimin mediatik të fushatës dhe rregullativën e medias zgjedhore.

Bashkëpunimi me Këshillin e Evropës në aktivitete që synojnë inkurajimin e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias dhe krijimin e mjedisi të favorshëm për mediat

Më 19 shkurt, përfaqësues i Agjencisë mori pjesë në Bordin e tretë drejtues të projektit "Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias në Maqedoninë e Veriut (PROFLEX)". Në takim u diskutuan për aktivitetet e realizuara, si dhe nevojat e Agjencisë në periudhën e ardhshme.

Përfaqësuesit e Agjencisë më 4 mars morën pjesë në takimin online të komponentit rajonal të PROFLEX. Në takim u diskutuan aktivitetet e ardhshme në komponentin rajonal të projektit, mundësitë e mbajtjes së takimit rajonal dhe pjesëmarrja në Dialogun Evropian mbi drejtimin e internetit (EuroDIG), event i organizuar nga Këshilli i Evropës dhe Luksemburgu.

Më 10 mars, përfaqësuesit e Agjencisë kishin takim pune me përfaqësues të Zyrës së Këshillit të Evropës në Shkup, në të cilin u diskutua përgatitja e studimi/analize mbi temën e hartëzimit të përdorimit të inteligjencës artificiale nga transmetuesit, i cili do të ndihmojë në kuptimin se si mediat përdorin teknologjitë e reja për të përmirësuar punën e tyre dhe për t'u përshtatur me trendet moderne. Si pjesë e bashkëpunimit të vazhdueshëm me Këshillin e Evropës në kuadër të projektit PROFLEX, në vitin 2025, ekspertet Marina Tuneva dhe Snezhana Trpevska, për nevojat e Agjencisë, përgatitën studim mbi zbatimin e inteligjencës artificiale në proceset e punës nga mediat.

Më 27 mars, përfaqësues i Agjencisë mori pjesë në takimin e Bordit drejtues PROFREX, ku u diskutua për zbatimin dhe aktivitetet e ardhshme në kuadër të projektit.

Përfaqësuesit e Agjencisë, në periudhën 9 deri më 11 tetor, qëndruan në Athinë ku morën pjesë në dy ngjarje të ndërlidhura të organizuara nga Këshilli i Evropës dhe SEEDIG në kuadër të projektit PROFREX. Në shkëmbimin rajonal mbi qasjet rregullore ndaj përmbajtjes së dëmshme në platformat online, u diskutuan trendet evropiane, detyrimet sipas Aktit të shërbimeve digjitale, përvojat kombëtare të Greqisë, Italisë dhe vendeve të rajonit, si dhe nevoja për tregues të unifikuar, përmirësimi i koordinimit dhe forcimi i kapaciteteve të rregullatorëve të medias. Në kuadër të SEEDIG 10, u trajtuan tema lidhur me transformimin digjital, udhëheqjes së internetit, zbatimin e rregullatës evropiane për inteligjencën artificiale (AI Act), zhvillimin e identiteteve digjitale dhe luftën kundër dezinformimit dhe gjuhës së urrejtjes. Përmes pjesëmarrjes në panele, punëtori dhe diskutime ekspertësh, përfaqësuesit e ASHMA-së fituan njohuri praktike mbi modelet moderne të bashkë-rregullimit dhe mbikëqyrjes online, si dhe mundësi të reja për bashkëpunim rajonal.

Më 20 nëntor, përfaqësues i Agjencisë mori pjesë në Takimin e tretë të Komitetit Drejtues të PROFREX. Eventi shqyrtoi progresin në zbatimin e aktiviteteve në fushat e antidiskriminimit, luftës kundër trafikimit me njerëz, krimin ekonomik dhe pastrimit të parave, si dhe lirisë së shprehjes. Në kuadër të sesioneve tematike, institucionet përfituese të projektit prezantuan rezultatet kryesore, sfidat dhe hapat e mëtejshëm për harmonizimin me standardet evropiane.

Përfaqësues i Agjencisë më 27 nëntor mori pjesë në intervistë në kuadër të Vlerësimit (evaluimit) të punës së Këshillit të Evropës në fushën e inteligjencës artificiale, të kryer nga Drejtoria për revizion të brendshëm, evaluimit dhe hetimit (DIO). Biseda u përqendrua në bashkëpunimin midis ASHMA-së dhe Këshillit të Evropës në fushën e inteligjencës artificiale, me fokus të veçantë në analizën "Inteligjenca artificiale në media në Maqedoninë e Veriut", zbatimin e saj dhe efektet e mundshme në të ardhmen.

PROCESI I INTEGRIMIT EVROPIAN

Në fillim të vitit 2025, përfundoi tvinging-projekti "Forcimi i kapaciteteve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Shërbimit Publik Radiodifuziv". Si një nga aktivitetet përfundimtare, u organizua event me temën: "Dezinformimi: si t'i njohim dhe parandalojmë", në të cilin u prezantua "Manuali për njohjen e dezinformimit", i cili u përgatit nga Agjencia me mbështetjen e ekspertit Tomas Ratgeb, udhëheqës i Njësisë për arsimim mediatik, program dhe hulumtim në Institutin Shtetëror të Komunikimeve në Baden-Burtemberg. Projekti më pas u përfundua me mbajtjen e Takimit të tetë të Komitetit drejtues për projektin, paraqitjen e kontributeve nga udhëheqësi i komponentit të parë të projektit drejtuar Këshilltari Rezident të projektit dhe të tjerët përgjegjës për realizimin e tij, si dhe komentet dhe plotësime në Draft-raportit të pestë mbi zbatimin e projekti IPA.

Më 23 janar, përfaqësuesit e Agjencisë morën pjesë në takimin e 20-të të Nënkomitetit për inovacion, shoqërisë së informacionit dhe politikë sociale, i cili u mbajt në format hibrid. Në takim, në pjesën për shoqërinë e informacionit dhe mediat, u diskutuan ndryshimet në Ligjin për Mediat, financimi i ASHMA-së dhe shërbimit publik i RTM-së, si dhe zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë dhe Këshillit Programor të RTM-së.

Më 30 janar, përfaqësuesit e Agjencisë morën pjesë në Këshillin e fundit Drejtues të tvinging-projektit të financuar nga Unioni Evropian "Forcimi i kapaciteteve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Shërbimit Publik Radiodifuziv", ku u diskutuan aktivitetet e realizuara, si dhe përgatitjen e raportit përfundimtar të projektit.

Më 13 dhe 14 mars, përfaqësuesit e Agjencisë në Bruksel, Mbretëria e Belgjikës, morën pjesë në takimin e 19-të të Nënkomitetit për drejtësi, liri dhe siguri dhe në takimin dypalësh për Raportin për sundimit të së drejtës. Në Nënkomitet, në pjesën mbi të drejtat themelore, lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, përfaqësuesit e Komisionit Evropian kërkuan informacion mbi ndryshimet në Ligjin për Median, financimin e rregullatorit të medias dhe Shërbimit publik, kushtet dhe procedurën për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë dhe Këshillit programor të RTM-së, reklamën shtetërore, transparencën e pronësisë së medias, përfshirë median online, dhe përqendrimin mediatik.

Në prill, Agjencia mbështeti Institutin për Studime të Komunikimit, Fondacionin Metamorfozis, Publik/Ballë për ballë dhe ERA - Shoqata LGBTI për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë në aplikimin për thirrjen e Agjencisë ekzekutive të arsimit dhe kulturës të Evropës për projekte në kuadër të programit “Qytetarët, barazia, të drejtat dhe Vlerat” (CERV) 2025.

Më 9 prill, u dorëzuan komentet dhe plotësime të Draft-raportit të pestë për zbatimin e IPA tvining-projektit.

Më 24 prill, përfaqësuesi i Agjencisë mori pjesë në punëtorinë e Ministrisë për Çështje Evropiane për të finalizuar Udhërrëfyesin për sundimin e të drejtës për pjesën Funkcionimin e Institucioneve Demokratike.

Nga data 12 deri më 14 maj, me ftesë të Këshillit të Evropës, përfaqësuesi i Agjencisë mori pjesë në EuroDIG2025 (Dialogu Evropian për udhëheqjen e internetit), që paraqet forum evropian që shërben si platformë për debat të hapur dhe hartim politikash në lidhje me internetin dhe teknologjitë digjitale. Eventi u mbajtë në Strasburg, Francë.

Më 13 maj, përfaqësuesi i Agjencisë pati takim me përfaqësues nga organizata MEMO 98, e cila po punon në projekt pilot rajonal të mbështetur nga UNESCO që synon përmirësimin e raportimit mediatik në MK dhe Mal të Zi mbi ndryshimet klimatike dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë (DRR), duke përdorur pajisje dhe teknologji digjitale të bazuara në inteligjencën artificiale.

Më 21 maj, përfaqësuesit e Agjencisë u takuan me koordinatoren rajonal të projekteve në Sektorin e komunikimit dhe informacionit të Byrosë rajonale të UNESCO-s për shkencën dhe kulturën në Evropë.

Më 5 qershor, përfaqësuesi i Agjencisë mori pjesë në takimin e Rrjetit për kontakt të bordit mediatik, i cili u mbajt në Bruksel. Takimi ishte në funksion të përgatitjes të takimit plenar të Bordit të planifikuar për 30 qershor, dhe shqyrtoi draft-raportet dhe dokumente të tjera nga puna e nëngrupeve.

Më 10 qershor, përfaqësuesit e Agjencisë mbajtën takim me përfaqësues nga Instituti për studime të komunikimit dhe Instituti universitar evropian në Firence, Itali, për të diskutuar bashkëpunimin e mundshëm.

Më 20 qershor, përfaqësuesi i Agjencisë mori pjesë në punëtorinë mbi platformat digjitale dhe menaxhimin e mediave online në Maqedoninë e Veriut, të organizuar nga UNESCO, me rastin e Ditës Ndërkombëtare kundër Gjuhës së Urrejtjes.

Më 30 qershor, përfaqësuesi i Agjencisë online mori pjesë në pjesë të takimit plenar të Bordit mediatik të mbajtur në Bruksel.

Përfaqësuesi i Agjencisë, më 30 qershor dhe 1 korrik në Gjenevë, mori pjesë në dialogun interaktiv me Komitetin për të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara, si pjesë e delegacionit të RMV-së gjatë shqyrtimit të Raportit të katërt periodik mbi zbatimin e Paktit Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike. Komiteti dha vlerësim pozitiv, por gjithashtu shtoi pyetje në lidhje me diskriminimin, barazinë gjinore, të drejtat e romëve dhe fëmijëve, trafikimin e qenieve njerëzore, pavarësinë e gjyqësorit, liritë fetare dhe lirinë e shprehjes, duke përfshirë pavarësinë e Këshillit të ASHMA-së. Përfaqësuesi i Agjencisë informoi se Këshilli u emërua më 24 qershor 2025 nga Kuvendi i RMV-së, duke respektuar përfaqësimin gjinor dhe etnik dhe kriteret ligjore, dhe pavarësinë e Agjencisë që sigurohet përmes profesionalizmit të shërbimit dhe mekanizmave ligjorë.

Më 1 korrik, përfaqësuesit e Agjencisë patën takim me përfaqësuesit e “Ekspertajz Francë”, agjenci franceze për bashkëpunim teknik dhe ekspertizë. Takimi u mbajt në kuadër të vizitës të organizuar nga Ministria e Çështje Evropiane, me qëllim shkëmbimin e informacionit mbi projektet aktuale në fushat e administratës publike, digjitalizimit, drejtësisë dhe luftës kundër korrupsionit, si dhe shqyrtimin e mundësive për bashkëpunim të ardhshëm dhe përdorimin e përvojës së ekspertëve francezë në këto fusha.

Më 29 korrik, Agjencia i paraqiti Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme përgjigje ndaj kërkesë/mendim mbi konkluzionet e Dialogut Interaktiv të RMV-së me Komitetin për të drejtat e njeriut gjatë sesionit të tij të 144-të, në lidhje me Raportin e katërt periodik sipas Paktit Ndërkombëtar të OKB-së për të drejtat civile dhe politike.

Përfaqësuesit e Agjencisë, më 31 korrik, në ambientet e Ministrisë për çështje Evropiane, morën pjesë në takim online me përfaqësuesit e Komisionit Evropian në lidhje me komentet e tyre mbi Udhërrëfyesin për sundimin e së drejtës (Kapitulli 23). Në takim u diskutuan ndryshimet që duhet të bëhen në këtë udhërrëfyes. Disa ditë më vonë, ndryshimet dhe komentet iu dërguan nga Agjencia Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Çështje Evropiane.

Më 11 shtator, përfaqësuesi i Agjencisë mori pjesë në takimin online të grupit mbi Udhërrëfyesin për funksionimin e institucioneve demokratike me përfaqësues të Komisionit Evropian. Në takim u diskutua se cilat detyrime janë përmbushur tashmë dhe duhet të zëvendësohen me të reja, dhe cilat duhet të specifikohen më tej. Në ditët në vijim, ndryshimet, plotësimet dhe komentet nga Agjencia iu dërguan Ministrisë së Çështjeve Evropiane. Ndryshimeve iu paraprinë konsultime me Këshillin e Etikës së Medias të Maqedonisë, Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë dhe Sindikatën e Pavarur të Gazetarëve dhe punonjësve të medias në lidhje me masat për të mbështetur vetërregullimin.

Përgatitja e raportit dhe informacioneve relevante për procesin e integritit evropian dhe pjesëmarrja në grupet punuese që ofrojnë dialog me komisionin Evropian në fushën audiovizuale

Më 30 janar, Agjencia i dorëzoi Ministrisë së Drejtësisë përgjigjet e pyetësorit si pjesë e procesit të mbledhjes së të dhënave për takimin e 19-të të Nënkomitetit për drejtësi, liri dhe siguri. Agjencia raportoi mbi burimet e saj financiare, njerëzore dhe teknike, boshllëqet dhe sfidat kryesore në sigurimin e transparencës së pronësisë së medias, rregullat mbi përqendrimin mediatik dhe rekomandimet e ODHR-it mbi fushatat zgjedhore dhe mediat, përfshirë dhe mediat sociale.

Agjencia, në dy raste, në prill dhe gusht, i dorëzoi Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Transformimit Digjital përgjigjet e pyetësorëve për Kapitullin 10 dhe Kapitullin 23, si pjesë e kontributit ndaj raportin vjetor të Komisionit Evropian. Në përgjigjet e prillit, Agjencia raportoi mbi pavarësinë e saj financiare, përkatësisht për financimin e saj, kapacitetet njerëzore dhe tekniko-teknologjike, për ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores për transmetimin e veprave audiovizuale evropiane dhe veprave nga producentët të pavarur, Rregulloren për sponsorizimin, Rregulloren për mbrojtjen e të miturve, si dhe miratimin e Rregullores për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të platformave të ndarjes së videoeve. Rregullatori iu referua gjithashtu aktiviteteve lidhur me zbatimin e Rregullores për qasje në shërbimet audiovizuale, mbi analizat e çështjeve gjinore, si dhe Ditëve të arsimimit mediatik dhe Manualit të përgatitur për njohjen e dezinformimit.

Në kontributin e gushtit, në pjesën e Kapitullit 10, u raportua mbi aktivitetet lidhur me Zgjedhjet Lokale 2025, ndryshimet në udhëzimet për reklamat politike me pagesë, monitorimin e televizioneve kombëtare, aktivizimin e Trupit Koordinues për mediat online, miratimin e rregulloreve për mediat online - portalet e internetit dhe influencuesit/vlogerët/kreatorët, aktivitetet e arsimimit mediatik, si dhe analizat e publikuara mbi strukturën e të

punësuarve, qëndrueshmërinë ekonomike të mediave rajonale dhe lokale dhe transparencën e pronësisë së mediave. Në pjesën e Kapitullit 23, Agjencia iu referua mbikëqyrjeve të kryera në maj dhe qershor për përmbushjen e detyrimeve për qasje në përmbajtjet mediatike në përputhje me nenin 26 të LShMAAV dhe Rregulloren për qasje, si dhe analizën e re të përgatitur "Gjinia në Media 2024".

Agjencia mori pjesë gjithashtu në prezantimin e botimeve "Raporti për Klaster(grupin) 1 - Vlerat themelore, me fokus në sundimit të së drejtës dhe lirinë e shprehjes, të drejtat dhe liritë e medias dhe sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve të medias" dhe dokumentin e politikave - "Përdorimi i përgjegjshëm i IA-së në gazetari", të organizuar nga Iniciativa për perspektivë Evropiane (IPE), në bashkëpunim me Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë (ShGN).

TRANSPARENCA NË PUNË DHE KOMUNIKIM ME PUBLIKUN

Organizimi i takimeve publike të Agjencisë

Në vitin 2025, Agjencia mbajti katër takime publike në të cilat u prezantuan aktivitetet e rregullatorit në secilin tremujor, të kryera në përputhje me Programin vjetor të punës së Agjencisë.

Më 26 mars, Agjencia mbajti takimin e parë publik, në të cilin u prezantua përmbledhje e aktiviteteve të kryera në tremujorin e parë.

Në takimin e dytë publik, i cili u mbajt më 24 qershor, u prezantuan gjetjet e analizës "Gjinia në Media 2024: Çështjet gjinore dhe mënyra e përfaqësimit të grave dhe burrave në kohën më të shikuar në televizionet kombëtare", e përgatitur për nevojat e Agjencisë.

Në takimin e tretë publik, u prezantuan gjetjet e Analizës së tregut të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024, të përgatitur nga Agjencia.

Takimi i katërt publik u mbajt më 23 dhjetor 2025 dhe ofroi pasqyrë të aktiviteteve të kryera në tre muajt e mëparshëm. U prezantuan aktivitetet lidhur me monitorimin e raportimit mediatik zgjedhor të transmetuesve për Zgjedhjet Lokale të vitit 2025, aktivitetet lidhur me Zgjedhjet e përsëritura për kryetarë të komunave të Gostivarit, Mavrovës dhe Rostushës, Qendrës së Zhupës dhe Vrapçishtit në vitin 2026, mbikëqyrja e kryer programore dhe administrative të transmetuesve, operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe botuesve të mediave të shtypit.

Komunikimi me publikun

Më 13 shkurt, publiku nëpërmjet njoftimi për shtyp u informua për shënimin e Ditës Botërore të Radios, e cila u mbajt vitin e kaluar nën moton "Radioja dhe ndryshimet klimatike". Në këtë drejtim, Agjencia informoi të gjitha radiot në vend se UNESCO ofron mundësinë për të shkëmbyer përvoja, materiale dhe ide me radiostacione nga vende të tjera, si dhe resurse të dobishme papagesë, duke përfshirë video audio dhe vizuele me temë "Radioja dhe ndryshimet klimatike", materiale lidhur me zhvillimin e mediave, arsimimit mediatik dhe informativ dhe sigurinë e gazetarëve; Udhëzues për informimin rreth ndryshimeve klimatike dhe gjenerimin e të ardhurave. Agjencia të gjitha radiostacionet në vend i uroi Ditën Botërore të Radios dhe u bëri thirrje të japin kontributin e tyre në shënimin e saj.

Më 16 mars, Agjencia publikoi njoftim publik duke shprehur keqardhje të thellë për tragjedinë në Koçan. Meqenëse bëhet fjalë për tragjedi në shkallë të gjerë që përfshinte viktima njerëzore, Agjencia u bëri thirrje mediave të jenë veçanërisht të kujdesshme në raportim, në mënyrë që të respektojnë dinjitetin e viktimave dhe të mos u shkaktojnë dhimbje plotësuese familjeve të tyre. U kujtoi mediave se informacioni që do të publikohet duhet të jetë i saktë dhe i verifikuar, dhe nëse nuk mund të konfirmohet ose bëhet fjalë për supozim, ata duhet ta thonë qartë. Agjencia theksoi se mediat duhet të përshtasin programin në tërësi/publikimet dhe të transmetojnë/publikojnë përmbajtje të përshtatshme për ngjarje të tillë.

Për shkak të tragjedisë në Koçan, më 16 mars, Qeveria e RMV-së shpalli shtatë ditë zie në të gjithë vendin dhe njoftoi masa të rrepta për ata që nuk do ta respektonin vendimin. Agjencia i udhëzoi mediat të transmetojnë/publikojnë përmbajtje që sipas funksionit të tyre mediatic, korrespondojnë me ditët e zisë. Gjatë ditëve të zisë, transmetuesit u liruan nga detyrimi për të transmetuar përqindje të caktuar të muzikës vendase. Agjencia u bëri thirrje mediave të vazhdojnë të raportojnë në mënyrë profesionale, t'i kushtojnë vëmendje dinjitetit të viktimave, të lënduarve dhe familjeve të tyre, si dhe gjatë raportimit të shfrytëzojnë burime të verifikuara dhe bashkëbisedues përkatës.

Më 19 mars, Agjencia përmes njoftim publik për shtyp u kujtoi mediave që t'u përmbahen standardeve më të larta profesionale dhe etike kur raportojnë për funeralet e viktimave të zjarrit tragjik në Koçan. Ajo theksoi se raportimi duhet të jetë i lirë nga sensacionalizmi dhe se është e detyrueshme të respektohet dhimbja dhe pikëllimi personal i familjeve, të afërmeve dhe të dashurve të të ndjerëve, si dhe të tregohet kujdes që të mos kontribuohet në rritjen e mëtejshme të ankthit. Në këtë drejtim ishin edhe kërkesat nga banorët e Koçanit, të cilët iu drejtuan drejtpërdrejt Agjencisë, si dhe përmes rrjeteve sociale, me apel për punonjësit e medias që të qëndrojnë larg gjatë funeraleve dhe të mos filmojnë me dronë. Gjatë ditëve të zisë, mediat treguan nivel të lartë profesionalizmi. Pati disa raste të transmetimit të filmave dhe serialeve me përmbajtje argëtuese, për të cilat u paraqitën ankesa në Agjenci.

Më 19 mars, publiku u informua përmes njoftimi për shtyp se Këshilli i Agjencisë, në seancën e 12-të mbajtur më 19 mars, miratoi vendim për dhënien e ndihmës financiare - donacion për qytetarët e prekur nga zjarri në Koçan, në shumë totale prej 1.500,000 denarësh.

Më 20 mars, Agjencia u bëri përsëri thirrje mediave që t'u përmbahen standardeve më të larta profesionale dhe etike kur raportojnë për funeralet e viktimave të zjarrit tragjik në Koçan. Në njoftim, Agjencia theksoi se mediat nuk duhet të publikojnë foto dhe video të varreve, anëtarëve të ngushtë të familjes dhe duhet të respektojnë momentet private në mënyrë që të mos përkeqësojnë më tej dhimbjen e të pikëlluarve.

Më 21 mars, Agjencia përmes njoftimi publik për shtyp ka dënuar ashpër gjuhën e urrejtjes dhe thirrjet për dhunë kundër mediave dhe gazetarëve. Në njoftim u theksua se thirrjet për sulme ndaj mediave dhe punonjësve të medias drejtpërdrejt kërcënojnë sigurinë e gazetarëve dhe përbëjnë sulm ndaj lirisë së shprehjes.

Në kontekstin e shënimit global të Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit, e cila iu kushtua ndikimit të thellë të inteligjencës artificiale në gazetari dhe media, Agjencia më 3 maj, përmes njoftimi publik për shtyp, kujtoi se vetëm mediat profesionale dhe të pavarura mund të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror dhe demokratik në epokën e ndryshimeve të shpejta teknologjike. Njoftimi për shtyp theksoi se liria e medias nënkupton të drejtën e gazetarëve për të hetuar dhe informuar pa asnjë presion. Megjithatë, me zhvillimin e inteligjencës artificiale, kjo liri merr kuptim të ri dhe përballet me sfida të reja. Inteligjenca artificiale hap mundësi të reja për përparimin e gazetarisë investigative, automatizimin e krijimit të përmbajtjes dhe verifikimin e përshpejtuar të fakteve, por

gjithashtu mbart rreziqe të konsiderueshme në aspektin e gjenerimit të dezinformatave, lajmeve të rreme dhe videove manipuluese. Inteligjenca artificiale është resurs i vlefshëm në praktikën gazetareske, por nuk duhet të jetë zëvendësim i plotë për verifikim thelbësor, të menduarit kritik dhe objektivitetit. Në këtë realitet të ri, është thelbësore që mediat t'i përdorin këto mjete me kujdes dhe përgjegjësi, duke iu përmbajtur standardeve më të larta etike dhe profesionale në punën e tyre.

Më 30 qershor, Agjencia përmes njoftimi publik dënon kërcënimet e bëra ndaj gazetarit Dragan Pavloviq Llatas nga kryetari i komunës së Strumicës në rrjetin social "Facebook". Në njoftim u theksua se politikanët dhe bartësit e funksioneve publike duhet të japin shembull të komunikimit dinjtoz dhe të përmbahen nga deklaratat që mund të nxisin urrejtje në diskursin publik dhe të çojnë në akte të motivuara nga urrejtja. Agjencia bëri thirrje për respektimin e lirisë së medias dhe gazetarëve dhe, nëse politikanët dhe bartësit e funksioneve publike kanë vërejtje ndaj përmbajtjeve mediatike, të përdorin mekanizmat institucionalë për reagim.

Më 3 korrik, Agjencia përmes njoftimi publik informoi se është konstituuar Këshilli i ri i AShMAA-së, me anëtarët e mëposhtëm: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Hajro-Jajaga, mr. Gordana Majnova, Petar Xhurovski, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska dhe Viktor Pavlovski. U theksua se në seancën konstituive, në përputhje me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Rregulloren e Punës së Agjencisë, mr. Sasho Stefanovski u zgjodh për kryetar i Këshillit, ndërsa mr. Zirjeta Hajro-Jajaga zëvendëse e kryetarit të Këshillit.

Më 9 korrik, u dënua ashpër sulmi fizik ndaj ekipit të gazetarëve të televizionit Alsat-M, i cili atë ditë dokumentoi zjarrin në deponinë e Vizbegovës. Në njoftim u theksua se siguria e gazetarëve është parakusht thelbësor për raportim profesional dhe të pavarur, i cili nga ana tjetër, është themeli i të drejtës së qytetarëve për t'u informuar saktë, në kohë dhe objektivisht. Është e nevojshme që gazetarët të kenë mundësinë të kryejnë lirisht dhe në mënyrë të sigurt detyrat e tyre profesionale në interes të publikut. Dhuna ndaj punonjësve të medias, në çdo formë, është absolutisht e papranueshme dhe duhet të sanksionohet.

Më 9 gusht, përmes njoftimi publik u informua se pas shpalljes së zgjedhjeve lokale të planifikuara për 19 tetor 2025, do të fillojë monitorimi i Agjencisë ndaj transmetuesve në lidhje me mënyrën e raportimit në periudhën para fillimit të fushatës zgjedhore dhe respektimit të dispozitave të Kodit Zgjedhor që zbatohen me shpalljen e zgjedhjeve. Njoftimi për shtyp përcaktoi detyrimet e transmetuesve në periudhën para fillimit të fushatës zgjedhore, si dhe se ueb-faqen e Agjencisë është vendosur baner me materiale lidhur me procesin zgjedhor.

Më 24 shtator, u njoftua se ishte hapur Konsultim Publik mbi Draft-Udhëzimin për transmetuesit për Zgjedhjet Lokale 2025, të cilin Këshilli i Agjencisë e miratoi në seancën e 11-të mbajtur po atë ditë. Në njoftimi thuhet se përgatitjes së dokumentit i paraprin disa konsultime me institucionet që kanë kompetenca lidhur me zgjedhjet - KShZ-në, KShPK-në dhe komisionit shtetëror për revizion. Për pasaktësitë e konstatuara në kodin Zgjedhor që ndikojnë në ndarjen e kohës për RPP midis transmetuesve dhe pagesën e mjeteve buzhetore për RPP nga KShZ, katër institucionet me shkresë të përbashkët informuan Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Lidhur me konsultimin publik, Agjencia u bëri thirrje partive politike, transmetuesve dhe të gjitha palëve të interesuara të marrin pjesë në konsultimin publik dhe të japin mendimet dhe sugjerimet e tyre.

Agjencia, më 7 tetor, përmes njoftimi publik për shtyp, dënoi ashpër fjalimin vulgar dhe ofendues të kryeredaktorit të "burevesnik.info", Zoran Bozhnovski, në "Facebook", drejtuar gazetarëve/e. Në njoftim u theksua se publikime të tilla, të mbushura me fyerje dhe shpifje, shkelin standardet etike dhe profesionale, minojnë dinjitetin e punonjësve të medias dhe krijojnë mjedis armiqësor, i cili mund të çojë në frikësim dhe dhunë. Agjencia bëri thirrje për komunikim publik të përgjegjshëm dhe të denjë dhe për përmbajtje nga gjuha e urrejtjes.

Më 8 tetor, publiku përmes njoftimi u informua se Gjykata Themelore Civile e Shkupit, më 3 tetor 2025, e hodhi poshtë si të pabazë padinë e Levicës kundër AShMA-së për masë të përkohshme

që do të ndalonte Udhëzimet për transmetuesit për Zgjedhjet Lokale 2025 dhe dorëzimin e raporteve për reklamat politike me pagesë në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve. Në njoftimin për shtyp u theksua se Udhëzimi është miratuar ekskluzivisht në përputhje me Kodin Zgjedhor, i cili rregullon saktësisht shpërndarjen e reklamave politike me pagesë, pa mundësinë që Agjencia të devijojë nga korniza ligjore. Agjencia theksoi se pavarësisht sulmeve të vazhdueshme dhe të pabazuara nga Levica, ajo mbetet në përputhje me veprimet ligjore.

Më 11 dhjetor, përmes njoftimi publik, u dënua hyrja e dhunshme në redaksinë e portalit të internetit "Infomaks", të kryer nga person i panjohur gjatë transmetimit të podcastit "Тешки myабети"(biseda të vështira). Agjencia theksoi se veprime të tilla paraqesin sulm të drejtpërdrejtë ndaj lirisë së medias dhe të drejtës së gazetarëve për të kryer punën e tyre pa presion dhe kërcënime. U theksua se dhuna ndaj punonjësve të medias dhe sulmet e dhunshme në redaksi janë absolutisht të papranueshme dhe kërkojnë përgjigje të menjëhershme dhe të përshtatshme nga autoritetet kompetente, prandaj pritet sa më shpejtë të merren masa të përshtatshme për zbardhjen e plotë të rastit. Sigurimi i mjedisi pune të sigurt dhe të qëndrueshëm për gazetarët dhe punonjësit e medias është parakusht thelbësor për lirinë e shprehjes dhe të drejtën e informacionit, dhe të gjitha institucionet përkatëse duhet të bëjnë përpjekje maksimale për të parandaluar incidente të tilla dhe të ngjashme në të ardhmen.

Më 26 dhjetor, Agjencia, nëpërmjet njoftimi publik, shprehu shqetësim për gjuhën ofenduese, nënçmuese dhe degraduese në njoftimet e partisë politike Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë, drejtuar gazetarit Branko Geroski. U theksua se përdorimi i fyerjeve personale, skualifikimeve dhe etiketimeve të gazetarëve është formë presioni që ka efekt dekurajues mbi gazetarinë e lirë. Kjo mënyrë komunikimi kontribuon në thellimin e polarizimit në shoqëri, duke minuar kështu demokracinë dhe duke ushtruar presion indirekt mbi pavarësinë editoriale. Në njoftimin për shtyp theksohet se Agjencia u ka bërë vazhdimisht thirrje të gjitha subjekteve politike të tregojnë nivel më të lartë përgjegjësie në diskursin publik, të përmbahen nga gjuha ofenduese dhe degraduese ndaj punonjësve të medias dhe të respektojnë rolin e medias si një nga shtyllat e demokracisë.

Në disa raste, të punësuarit në Agjencinë dhanë deklaratat për mediat mbi tema të ndryshme. Më 13 shkurt, u dha deklaratë për TV Sitel në lidhje me Ditën Botërore të Radios. Më 14 shkurt, një deklaratë u dha për emisionin "Camo prашaj" (Vetëm pyet) në RTM, lidhur me arsimimin mediatik dhe përdorimin e teknologjive të reja, dhe e dytë për TV 24 Vesti, në lidhje me regjistrimin e influencerëve. Më 11 mars, drejtori i Agjencisë ishte i ftuar në emisionin "360 Gradë" në TVM, në lidhje me rregullimin e mediave online - portaleve të internetit.

Përditësimi i faqes së internetit të Agjencisë www.avmu.mk në gjuhën maqedone, shqip dhe anglisht

Me qëllim që publiku dhe të gjitha palët e interesuara të informohen rregullisht dhe në kohë për aktivitetet e Agjencisë, faqja e internetit përditësohej vazhdimisht në tre gjuhë: maqedonisht, shqip dhe anglisht. Në faqen e internetit www.avmu.mk u publikuan informacione për:

- seancat e Agjencisë: rendi i ditës dhe për publikimin e rendit të ditës u informuan të gjitha stacionet radiotelevizive, gazetatat ditore dhe portalet; kronikat e seancave; procesverbalet e seancave; vendimet, aktet, informacionet e miratuara në seancat e Agjencisë;
- masat e shqiptuara për paralajmërim publik dhe ORRPKE-in;
- raportet për mbikëqyrjen e kryer mbi mediae e shtypit, televizionet, radiot dhe operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik;

- përditësimin e regjistrave të televizioneve, radiove, operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik, mediave të shtypit, botuesve të mediave online - portaleve të internetit dhe influencerëve/vlogerëve/kreatërëve të përmbajtjes;
- çertifikatat e lëshuara për regjistrimin e shërbimeve programore dhe lista e lejeve (licencave) për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive të transmetuesve të huaj të paraqitura në Agjenci nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik;
- procedurat e furnizim publik (procedurat në vazhdim dhe të përfunduara, marrëveshja e lidhur për furnizim publik);
- kërkesat dhe përgjigjet për informacion me karakter publik;
- ankesat e paraqitura dhe përgjigjet e tyre;
- buletinet mujore të Agjencisë për muajt nga janari deri në dhjetor 2025, të cilat përfshijnë të gjitha aktivitetet e rëndësishme të kryera nga Agjencia në bazë mujore;
- njoftimet për shtyp;
- materialet lidhur me zgjedhjet në banderola të krijuara posaçërisht për këtë qëllim - banderola "Zgjedhjet Lokale 2025" dhe "Zgjedhjet Lokale 2026".

Përditësimi i faqes së internetit www.mediumskapismenost.mk

Në faqen e internetit www.mediumskapismenost.mk është publikuar informacion në lidhje me ngjarjen përfundimtar të projektit të Tvinging-projektit për forcimin e kapaciteteve të AShMA-së dhe RTsë, si dhe informacione në lidhje me Manualin e përgatitur për njohjen e dezinformatave, i cili është i disponueshëm në formën e publikimit në gjuhën shqipe dhe anglisht..

Janë publikuar zgjidhje kreative dhe tekste për informim të të gjitha ngjarjet që lidhen me DAM 2025, të cilat u mbajtën në lokacione të ndryshme në të gjithë vendin, dhe disa prej tyre online, si dhe tekste për ngjarjet e mbajtura: hapja e Ditëve, punëtorja mbi njohjen dhe trajtimin e ndërhyrjeve të huaja dhe manipulimit të informacionit; punëtorja "Master Evropian në trajtimin e dezinformimit"; punëtorja "Interdemokracia", e destinuar për nxënës të shkollave të mesme; ngjarja e LMG për mbrojtjen e gazetarëve si parakusht për siguri më të madhe të punonjësve të medias; punëtorja "A është mashtrim apo e meriton klikimin tim?"; analiza dhe rekomandimet krahasuese të promovuara në luftën kundër SLAPP padive; panel-diskutimi dhe seanca e hapur e SEMM; debati i IKS "Të rinjtë në fokus: Ndërhyrja e huaj dhe manipulimi i informacionit"; dhe takimi vjetor i Rrjetit të Arsimit Mediatik 2025.

U publikuan spote televizive dhe radiofonike të krijuara për nevojat e DAM-së dhe videot - "Katër tekste, katër botë", "Klasa e Re" dhe "Vizatime dhe mendimi kritik".

Përditësimi i faqes së internetit www.rodotimediumite.mk

Në faqen e internetit www.rodotimediumite.mk është publikuar informacion në lidhje me Sfidat e realitetit gjinor – Përmbledhje analizash, historish dhe përgjigjesh ndaj dezinformimit në lidhje me gjininë, barazinë gjinore dhe ndryshimet gjinore. Është publikuar informacion në lidhje me Shkollën verore mbi barazinë gjinore në Qendrën e burimeve për politikëbërje të përgjegjshëm gjinor dhe buxhetim.

Në faqen e internetit u publikun disa video në gjuhën maqedone, shqip, rome dhe turqisht, të cilat Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, Demografi dhe Rini, në bashkëpunim me zyrën e UNFPA-së dhe me mbështetjen financiare të Ambasadës Britanike, i përgatiti në kuadër të fushatës për rritjen e ndërgjegjësimit për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, të titulluar "Mos u bëj dëshmitar i heshtur",

që është vazhdim i fushatës "Ka ndihmë për jetë pa dhunë". U publikuan edhe materiale të tjera, fletëpalosje, postera, zgjidhje kreative të destinuar për mediat sociale që lidhen me fushatën, si dhe video me gjetjet kryesore nga Analiza e çështjeve gjinore dhe mënyra e përfaqësimit të grave dhe burrave në kohën qendrore në Televizionet Kombëtare, me të cilat ASHMA iu bashkua fushatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) në vend "Gjashtëmbëdhjetë ditë aktivizmi kundër dhunës me bazë gjinore 2025".

Përditësimi i faqes së internetit www.izborenkodeksonline.mk

Në faqen e internetit u publikuan disa informacione për aktivitetet që lidhen me Kodin e sjelljes në hapësirën online gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve. U ndanë informacione se mekanizmi i ankesave lidhur me aktivitetet zgjedhore në hapësirën online është rikthyer në funksion; rreth takimit të mbajtur nga Trupit Koordinues për raportimin dhe trajtimin e ankesave gjatë zgjedhjeve ose referendumeve; konkluzionin i arritur në takimin e Trupit Koordinues pas parashtrësës së paraqitur nga koalicioni "Vredi"; konkluzionet e Trupit Koordinues pas ankesave të pranuar nga kandidat për kryetar bashkie të komunës së Koçanit; ankesë nga portali Apla.mk në lidhje me kandidat për këshilltar në komunën e Manastirit; ankesë nga portali Apla.mk në lidhje me person fizik; ankesë në lidhje me kryetarin aktual të Makedonska Kamenicës; ankesë nga Koalicioni Vlen në lidhje me median "Triling"; ankesë nga Koalicioni Vlen në lidhje me median "Fokus"; ankesë në lidhje me kandidatin e VMRO-DPMNE për kryetar bashkie të Qytetit të Shkupit. Janë publikuar tekste që përmbledhin të gjitha ankesat e paraqitura në Trupin Koordinues për shkelle gjatë Zgjedhjeve Lokale të vitit 2025 dhe përmbledhje e aktiviteteve të Trupit Koordinues për zgjedhjet. U publikua dhe teksti i pastruar i Rregullores së Punës së Trupit Koordinues për paraqitjen dhe veprimin sipas parashtrësive gjatë zgjedhjeve ose referendumeve dhe Procesverbalin e mbledhjes së Trupit Koordinues për zgjedhjet, të mbajtur më 13.8.2025.

Janë postuar logot e subjekteve të reja që i janë bashkuar Kodit të sjelljes në sferën online gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve – partitë politike Desnica dhe Bashkimi Demokratik, grupet e votuesve Keti Staleska, Enis Demirov, Strahil Gavritov dhe Marjan Kalevski nga "Зелен хуман град" (Qyteti i gjelbër human). Deri më tani, 33 subjekte i janë bashkuar Kodeksit (pesë parti politike, katër grupe votuesish, një organizatë e shoqërisë civile, 12 media online dhe 11 transmetues).

Në faqen e internetit gjithashtu lidhet me profilet e facebook dhe profileve të instagramit të Kodeksit, të cilat qëllimisht u hapën përpara Zgjedhjeve Lokale të vitit 2025. Në rrjetet sociale "Facebook" dhe "Instagram", u plasuan mesazhe dhe video në gjuhën maqedone dhe nglisht duke informuar publikun për rëndësinë e sjelljes etike në hapësirën digjitale gjatë procesit zgjedhor, për kuptimin e Kodeksit dhe për mënyrat e paraqitjes së ankesave në Trupin Koordinues që monitoron respektimin e Kodeksit. Në rrjetet sociale "Facebook" dhe "Instagram" u publikuan gjithsej 10 postime të sponsorizuara (mesazhe/kreativa, pesë prej të cilave në gjuhën maqedone dhe pesë në shqip) dhe katër video të sponsorizuara (10-20 sekonda, dy prej të cilave në gjuhën maqedone dhe dy në shqip). Publikimi i përmbajtjeve në rrjetet sociale dy herë në javë, dhe mesazhet/videot e sponsorizuara filluan të publikohen nga 16 shtator dhe zgjatën deri më 4 nëntor 2025. Në këtë mënyrë, pritet të rritet ndërgjegjësimi i subjekteve për të cilat zbatohet Kodeksi, në lidhje me përgjegjësinë e tyre gjatë kryerjes së fushatave në hapësirën online, si dhe përfshirje më të madhe publike në njohjen dhe raportimin e çdo mosrespektimi të mundshëm të parimeve dhe standardeve për kryerjen e fushatave online.

Përditësimi i përmbajtjeve në kanalin You Tube të Agjencisë

Në kanalin YouTube të Agjencisë rregullisht shpërndan seancat e Këshillit të Agjencisë dhe publikon video nga takimet publike të Agjencisë. U publikuan videoja "Kodi i sjelljes në hapësirën online gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve" u publikua në maqedonisht dhe shqip, si dhe disa video nga fushata e Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë për të rritur ndërgjegjësimin kundër dhunës me bazë gjinore "Mos u bëj dëshmitar i heshtur".

Përditësimi i përmbajtjeve në faqen "Facebook" të Agjencisë

Në faqet facebook të Agjencisë u ndanë rregullisht informacione të seancave të Këshillit të Agjencisë, takimeve publike të Agjencisë në vitin 2025, ngjarjes përfundimtare për Tvinging-projektin për forcimin e kapaciteteve të AShMA-së dhe RTM-së, informacion për shënimin e Ditës Botërore të Radios, vizitës së punës së Ambasadorit të Francës Kristof Le Rigoler, disa njoftime për shtyp lidhur me zjarrin tragjik në Koçan, informacion rreth konstituimit të Këshillit të ri të AShMA-së, shënjimin e 3 Majit - Ditës Botërore të Medias, dënimin e gjuhës së urrejtjes dhe thirrjeve për dhunë ndaj medias dhe gazetarëve, klipe audio dhe video për promovimin e Kodit të sjelljes në hapësirën online gjatë zgjedhjeve dhe referendumeve, njoftime për shtyp dhe informacione lidhur me Ditët e Arsimimit Mediatik 2025.

REVIZIONI I BRENDSHËM NË AGJENCION

Në vitin raportues, u kryen revizione të parashikuara në Planin vjetor të shërbimit për revizion të brendshëm për vitin 2025²¹, i cili është përgatitur bazuar në analizat dhe vlerësimin të rrishtit të paraqitura në Planin strategjik të Shërbimit për revizion të brendshëm për periudhën nga viti 2025 deri në vitin 2027²².

Revizioni i parë u krye mbi sistemin e menaxhimit të rrishtit në Agjenci, në periudhën nga 7 janari deri më 12 shkurt 2025. Qëllimi i këtij revizioni ishte t'i mundësonte revizionit të brendshëm të merrte siguri të arsyeshme nëse sistemi i menaxhimit të rrishtit është i përshtatshëm dhe në pajtim me kërkesat e standardit ISO 9001:2015. Në fund të shkurtit 2025, udhëheqësi i Shërbimit për revozion të brendshëm u largua nga Agjencia për shkak të emërimit të tij nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut²³ si person udhëheqës të institucioni shtetëror. Prandaj, revizioni i brendshëm i sapopunësuar në Agjenci, bazuar në raport e lëshuar më parë më 30 shtator 2025, dorëzoi raportin përfundimtar të revizionit nga revizioni i brendshëm i kryer të procesit të menaxhimit të rrishtit në Agjenci.

Revizioni i dytë ishte mbi procesin e regjistrimit dhe pagesës së të ardhurave që Agjencia i realizon nga kryerja e veprimtarisë së saj dhe u krye në periudhën nga 22 gushti deri më 30 shtator 2025, dhe raporti përfundimtar i revizionit u dorëzua më 8 tetor 2025. Qëllimi i revizionit ishte të përcaktonte nëse evidentimi dhe pagesa e të ardhurave që Agjencia ka realizuar nga kryerja e veprimtarisë së saj në periudhën nga 1 janari deri më 15 gusht 2025 u krye në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse.

Revizioni i tretë i kryer në vitin 2025 ishte mbi procesin e evidentimit dhe raportimit të detyrimeve të Agjencisë. Ky revizion u krye në periudhën nga 10 tetori deri më 5 nëntor 2025, dhe rezultatet e revizionit janë paraqitur në raportin përfundimtar të revizionit të dorëzuar më 19 dhjetor 2025. Qëllimi i këtij revizionit ishte të përcaktohej nëse

²¹ Plani vjetor i Shërbimit të revizionit të brendshëm për 2025 me nr.ark.02-5014/1 të datës 03.12.2024

²² Plani strategjik i Shërbimit të revizionit të brendshëm në periudhën nga 2025 deri më 2027 me nr.ark.02-5024/1 të datës 04.12.2024

²³ Aktvendim nr.18-2163/1 të datës 25.02.2025 i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut

evidentimi dhe raportimi i detyrimeve të Agjencisë në periudhën nga 1 janari deri më 30 shtator 2025 u krye në pajtim me rregulloret ligjore dhe rregullatore përkatëse dhe aktet e brendshme.

Revizioni i katërt u krye mbi procesin e zbatimit të kontratave për furnizime publike në Agjenci, në periudhën nga 10 deri më 30 dhjetor 2025, dhe raporti i revizionit u lëshua në fillim të vitit 2026, pas përfundimit të procedurës për harmonizimin me sektorët kompetentë përfshirë në revizion. Qëllimi i këtij revizioni ishte të përcakton nëse zbatimi i kontratave për furnizime publike në Agjencion në periudhën nga 1 janari deri më 30 shtator 2025 kryhet në pajtim me kontratat e nënshkruara dhe rregulloret ligjore dhe rregullativat nënligjore dhe aktet e brendshme të Agjencisë.

Revizioni i fundit i planifikuar për vitin 2025 ishte revizion i sistemit të mbrojtjes së të dhënave personale në Agjenci, me qëllim përcaktimin nëse sistemi i mbrojtjes së të dhënave personale është i përshtatshëm dhe ofron mbrojtje në pajtim merregullativën ligjore dhe nënligjore dhe aktet e brendshme. Revizioni u krye gjatë janarit 2026, dhe raporti përfundimtar i revizionit u dorëzua në shkurt 2026.

Përveç kësaj, për çdo revizion të përfunduar, është dorëzuar raport përfundimtar i revizionit për të cilin është dhënë mendim për funksionimin e sistemit të vendosur të kontrollit të brendshëm dhe harmonizimit të aktiviteteve në kuadër të proceseve të cilët janë lëndë e revizionit me ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme që rregullojnë fushat e përfshira në revizionin e brendshëm, dhe për tejkalimin e situatave të caktuara janë dhënë rekomandime.

Gjithashtu në vitin raportues, përkatësisht në mesin e gushtit, u hartua Kartë për revizion të brendshëm, e cila përcakton kornizën brenda së cilës funksionon revizioni i brendshëm, kompetencat e tij, rolin, fushëveprimin, përgjegjësitë, si dhe mënyrën e raportimit, dhe iu dorëzua Ministrisë së Financave.

Në dhjetor 2025, u krye shqyrtim fillestar dhe plotësim të fushave të punës të rëndësishme për realizimin e qëllimeve të Agjencisë, të cilat mund të jenë lëndë e revizionit, dhe bazuar në analiza dhe vlerësime të rrizikut, dhe duke marrë parasysh kapacitetin aktualë kadrovike të revizionit të brendshëm, u hartua Strategji për revizion të brendshëm për periudhën nga viti 2026 deri në vitin 2028²⁴ dhe Plani vjetor i revizionit të brendshëm për vitin 2026²⁵ dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

PUNA MATERIALE-FINANCIARE

Plani financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025 i referohet shpenzimeve të planifikuara në shumë prej 202.429.722,00 denarë dhe të ardhurave të planifikuara në shumë prej 202.429.722,00 denarë.

Mjetet në total të planifikuara në anën e të ardhurave në planin financiar të miratuar për vitin 2025 i referoheshin të ardhurave të planifikuara nga Buxheti i RMV-së për proceset zgjedhore në vitin 2025 (zgjedhjet lokale) në shumë prej 13.000.000,00 denarë, të ardhurave të planifikuara nga mjetet financiare nga Buxheti i RMV-së në shumë prej 78.800.000,00 denarë, të ardhurave të planifikuara nga kompensime të lejeve për transmetimit televiziv dhe radio në shumë prej 50.000.000,00 denarë, të ardhurave të planifikuara nga mbikëqyrja për ritransmetimin e shërbimeve programore të operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë në shumë prej 10.500.000,00 denarë, të ardhurave të planifikuara nga faturat tranzite në

²⁴ Strategjia e revizionit të brendshëm për periudhën nga viti 2026 deri në 2028 me nr.ark.02-5673/1 të datës 30.12.2025;

²⁵ Plani vjetor i revizionit të brendshëm për vitin 2026 me nr.ark.02-5672/1 të datës 30.12.2025;

shumë prej 1.000.000,00 denarë dhe mjeteve të tepërta të transferuara nga viti i kaluar në shumë prej 49.129.722,00 denarë. Të ardhurat në total të planifikuara ishin 202.429.722,00 denarë.

Të ardhurat në total të relizuara në vitin 2025 arrijnë në shumë prej 141.336.000,00 denarë. Këto të ardhura janë realizuar nga burimet e mëposhtme:

- Të ardhura nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për aktivitetet zgjedhore të zhvilluara në vitin 2025 (zgjedhjet lokale) për të cilat Agjencia shfrytëzoi mjete në shumë prej 7.581.728,00 denarë;
- Mjete financiare nga Buxheti i RMV-së dhe të ardhura nga taksa e arkëtuar radiodifuzive në shumë prej 74.117.431,00 denarë;
- Të ardhura të realizuara nga kompensimet e lejeve për transmetim televiziv dhe radio në shumë prej 47.495.388,00 denarë;
- Të ardhura nga mbikëqyrja e ritransmetimit të shërbimeve programore dhe nga ofuesit e shërbimeve programore me kërkesë në shumë prej 10.751.766,00 denarë;
- Të ardhura nga faturat tranzite në shumë prej 1.072.760,00 denarë dhe
- Të ardhura të tjera në shumë prej 316.927,00 denarë.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me Vendimin nr. 50-8237/3 të datës 4.9.2025, miratoi mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në shumë totale prej 11.270.000,00 denarësh për Agjencinë e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele për monitorimin e zgjedhjeve lokale në vitin 2025. Këto mjete ishin të destinuara ekskluzivisht për financimin e aktiviteteve të Agjencisë gjatë proceseve zgjedhore dhe u transferuan në llogari të veçantë. Agjencia i përdori mjetet për qëllimet e mëposhtme:

- për punësim të përkohshëm u shfrytëzuar në total 4.445.069,00 denarë, përfshirë TVSH-në;
- për shërbimin – transmetim të të dhënave nga lokacione të largëta me trafik të pakufizuar të përfshirë në dy drejtime (download/upload), u shpenzuan mjete në shumë prej 675.432,00 denarë;
- për harxhime avokatie u shpenzuan mjete në shumë totale prej 122.000,00 denarë;
- për harxhime telefonike u shpenzuan mjete në shumë totale prej 389.254,00 denarë;
- për mirëmbajtje të softuerit të sistemit për monitorim të radios dhe shërbimeve-TV dhe mbikëqyrjes së ORRPKE (operatorëve të rrjetit publik të komunikimit elektronik) u harxhuan mjete në shumë totale prej 1.179.816,00 denarë;
- për harxhime postare u shpenzuan mjete në shumë totale prej 20.050,00 denarë;
- për materiale zyre u shpenzuan mjete në shumë totale prej 25.160,00 denarë;
- për ofrimin e të dhënave të marra përmes matjes elektronike të shikueshmërisë së reklamave politike me pagesë, me të dhëna të detajuara për transmetimin e RPP të televizioneve kombëtare tokësore gjatë Zgjedhjeve Lokale 2025, u shpenzuan mjete në shumë totale prej 512.120,00 denarë dhe
- për mirëmbajtjen e pajisjeve të sistemit për monitorimin e shërbimeve në radio dhe TV dhe mbikëqyrjen e ORRPKE (operatorëve të rrjetit publik të komunikimit elektronik), u shpenzuan mjete në shumë totale prej 207.975,00 denarë.

Gjithashtu, nga kjo llogari janë paguar provizione bankare dhe provizione mujore për mirëmbajtjen e llogarisë në shumë totale prej 4.852,00 denarë, dhe kështu, nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025 janë shfrytëzuar gjithsej 7.581.728,00 denarë.

Agjencia vazhdoi të shfrytëzoi mjetet e pashfrytëzuara në shumën totale prej 3.688.272,00 denarësh në vitin 2026, për shkak se Kuvendi i RMV-së shpalli zgjedhje të përsëritura për kryetar të komunës së Gostivarit, kryetar të komunës së Vrapçishtit, kryetar të komunave të Mavrovës dhe Rostushës dhe kryetar të komunës së Qendrës Zhupë (të cilat u mbajtën më 11 janar 2026) dhe janë ekskluzivisht për përmbushjen e detyrimeve ligjore në lidhje me aktivitetet zgjedhore në vitin 2026 (zgjedhje lokale në katër komuna).

Pas përfundimit të aktiviteteve zgjedhore, Agjencia i paraqiti Ministrisë së Financave të RMV-së shpjegim të detajuar të shpenzimeve aktuale të bëra për realizimin e aktiviteteve të Agjencisë gjatë proceseve zgjedhore (zgjedhjet lokale në 2025 dhe 2026) dhe mjetet e tepërta plotësisht do të kthehen në Buxhetin e RMV-së.

Agjencia i siguron mjetet nga Buxheti i RMV-së në pajtim me nenin 105 të LShMAAV-së, sipas të cilit 1% e të ardhurave të realizuara tatimore të përcaktuara në llogarinë e fundit përfundimtare të Buxhetit të RMV-së ndahen çdo vit për financimin e veprimtarisë radiodifuzive, përkatësisht për funksionimin dhe zhvillimin e Radiotelevizionit të Maqedonisë, Ndërmarrjes Publike Radiodifuzioni i Maqedonisë dhe Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Këto mjete shpërndahen si më poshtë: 80% për RTM-në për mbulimin e shpenzimeve të krijimit dhe transmetimit të programeve dhe për zhvillimin tekniko-teknologjik; 15% për NP "Radiodifuzioni i Maqedonisë" për mirëmbajtjen, përdorimin dhe zhvillimin e rrjetit publik radiodifuziv; dhe 5% për Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Shuma që i paguhet Agjencisë në pajtim me ligjin llogaritet në bazë vjetore, por detyrimi për pagesë është në bazë mujore.

Në llogarinë e fundit përfundimtare të miratuar nga Buxheti i RMV-së për vitin 2023 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.169/2024) thuhet se të ardhurat tatimore në total të realizuara në vitin 2023 në Buxhetin e RMV-së arritën në 157.733.000.000,00 denarë. Prandaj, në Buxhetin e RMV-së për vitin 2025, të publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 254 të datës 16.12.2024", u përcaktuan saktë mjetet e destinuar për financimin e veprimtarisë radiodifuzive, përkatësisht 1% nga të ardhurat tatimore të realizuara arrijnë në 1.577.330.000,00 denarë (një miliard e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e treqind e tridhjetë mijë denarë, nga të cilat 5% për Agjencinë, që arrin në nivel vjetor 78.866.500,00 denarë, ose më saktë shumë mujore prej 6.572.208,00 denarë.

Duke filluar nga janari i vitit 2025 dhe deri në nëntor të vitit 2025, Ministria e Transformimit Digjital pagoi shumë e saktë mujore prej 6,572,208.00 denarë në llogarinë e Agjencisë, ndërsa për muajin dhjetor të vitit 2025, mbi këtë bazë iu transferuan Agjencisë 1,572,208.00 denarë, që është për 5,000,000.00 denarë më pak.

Për këtë arsye, Agjencia me Shkresë iu drejtua ministrisë kompetente me Kërkesë për Informacion në lidhje me pagesën më të ulët të mjeteve për financimin e veprimtarisë radiodifuzive (nr. ynë ark.03-289/1 të datës 23.01.2026 dhe nr. ynë ark.03-289/2 të datës 20.02.2026) për dhjetorin 2025 dhe deri më tani Agjencia nuk ka marrë përgjigje kthyese.

Në pajtim nga sa më sipër, të ardhurat totale të realizuara në vitin 2025 për financimin e veprimtarisë radiodifuzive dhe nga arkëtimi i taksës radiodifuzive arritën në 74.117.431,00 denarë.

Në vitin 2025, bazuar në të ardhurat nga lejet për transmetim televiziv dhe radio, u realizuan mjete në shumë totale prej 47.495.388,00 denarë.

Në pajtim me nenin 142, paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18, 27/19 dhe 154/23 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), Agjencia realizon të ardhura si nga mbikëqyrja e ritransmetimit të shërbimeve programore, ashtu edhe nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë. Këto të ardhura në vitin 2025 arritën në 10.751.766,00 denarë.

Në vitin 2025, janë realizuar edhe të ardhura nga faturat tranzite në shumë prej 1.072.760,00 denarë. Ato janë realizuar nga faturat tranzite të lëshuara nga Agjencia për energji elektrike të konsumuar, për mirëmbajtjen e ashensorëve dhe platformave dhe për mirëmbajtjen dhe servisimin e sistemit të ftohjes, ngrohjes dhe ventilimit.

Agjencia gjithashtu ka realizuar edhe të ardhura të tjera në shumë prej 316.927,00 denarë.

Struktura e të ardhurave totale paraqitet në Shtojcën nr. 1, si pjesë përbërëse e Raportit.

Më 11.2.2025, Agjencia miratoi vendim (nr. ynë ark.05-602/1) për ndarjen e ndihmës financiare - donacion për Institucionin publik shëndetësor - Spitali i Specializuar për Mjekësi Paliative Geriatrike "13 Nëntori" Shkup, në shumën prej 1.000.000,00 (një milion) denarë, për realizimin e "Projektit për Efikasitet Energjetik për IShP SBGPM 13 Nëntori Shkup", qëllimi i të cilit është instalimi i sistemi të ri vetëqëndrueshëm të ngrohjes së ujit përmes sistemi kolektori diellor, i cili është më efikas nga ana energjetike nga sistemi që përdor aktualisht spitali, më ekonomik, dhe ekologjik, duke siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përmes kujdesit më cilësor të higjienës personale për pacientët geriatrikë dhe paliativë, duke ulur faturat e energjisë elektrike të spitalit, si dhe mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e gjelbër, uljen e ndotjes së ajrit dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike. Për këtë qëllim, Agjencia nënshkroi marrëveshje donacion me Institucionin publik të shëndetit - Spitalin e Specializuar për Mjekësi Paliative Geriatrike "13 Nëntori" Shkup dhe mjetet Agjencia i transferoi me datë 11.4.2025, pasi mori mendim pozitiv për interes publik nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Më 20.3.2025, Agjencia miratoi vendim (nr. ynë ark.05-1137/1) për ndarjen e ndihmës financiare - donacion në shumën prej 1.500.000,00 (një milion e pesëqind mijë) denarësh, si ndihmë për qytetarët e prekur nga aksidenti i tmerrshëm - zjarri që ndodhi në Koçan më 16.3.2025, i cili u realizua përmes Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si marrës i donacionit. Për këtë qëllim, Agjencia nënshkroi marrëveshje donacion me Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe mjetet Agjencia i transferoi me datë 16.4.2025, pasi mori mendim pozitiv për interes publik nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Më 20.3.2025, Agjencia miratoi një vendim tjetër (nr. ynë ark.05-1138/1) për ndarjen e ndihmës financiare - donacion për Shoqërinë Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevaip ShPKNJ P Tetovë, në shumën prej 500.000,00 (pesëqind mijë) denarësh, për sanimin e pasojave të zjarrit që më 8.3.2025 përfshiu pjesë të ambienteve të transmetuesit, me qëllim mbështetjen e aktiviteteve të transmetuesit për kryerjen e papengesa të veprimtarisë së saj - transmetimin e programeve televizive dhe përmbajtjeve me rëndësi për rajonin D8 – Kodra e Diellit (Tetovë, Gostivar, Vrapçisht, Bogovinë, Brvenicë, Tearcë, Jegunovcë, Zhelinë), si dhe ofrimin e sigurisë dhe mbrojtjes së të punësuarve. Për këtë qëllim, Agjencia nënshkroi marrëveshje donacion me Shoqërinë Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevaip ShPKNJ P Tetovë dhe Agjencia i transferoi mjete më datë 7.5.2025, pasi mori mendim pozitiv për interes publik nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shpenzimet totale në vitin 2025 arrijnë në shumë prej 146.963.368,00 denarë.

Shpenzimet i feroohen qëllimeve në vijim:

- për harxhim të lëndës së parë dhe materiale, për furnizim të karburantit për automjete zyrtare, për blerjen e mjeteve zyrtare, produkteve për higjienë personale, për ujin e konsumuar, për pagesën e ligjienës komunale, për blerjen e materialit të konsumuar IT, janë shpenzuar mjete në shumë prej 828.429,00 denarë;
- energjia elektrike e konsumuar, që përfshin konsumimin e energjisë termike për ngrohje në shumë prej 3.391.995,00 denarë;
- për mirëmbajtjen e investimeve të mjeteve përkatësisht për mirëmbajtjen e rregullt dhe servisimin të automjeteve zyrtare, larjen e automjeteve zyrtare, për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike dhe pajisjeve të tjera TIK (teknologjisë informative të komunikimit) pajisje të Agjencisë, për mirëmbajtjen e sistemit për monitorimin e shërbimeve në radio dhe TV dhe monitorim të ORRPKE (operatorëve të rrjetit publik të komunikimit elektronik) të Agjencisë, për mirëmbajtjen e shërbimeve të sistemit hardver të monitorimit në radio dhe TV dhe mbikëqyrjes së ORRPKE (operatorëve të rrjetit publik të komunikimit elektronik), për mirëmbajtjen e faqeve ekzistuese të internetit të Agjencisë (faqja e përgjithshme e internetit: www.avmu.mk, www.rodotimediumite.mk, www.mediumskapismenost.mk dhe internet faqja për zgjedhje dhe media), për

- mirëmbajtjen e modulit të punës në arkivë dhe mirëmbajtjen e softuerit të integruar të punës juridike, financiare dhe ekonomike, për mirëmbajtjen parandaluese dhe adaptive të sistemit automatik për menazhim të dokumenteve (DMS – sistemi i menazhimit të dokumenteve), për mirëmbajtjen dhe servisimin e aparateve për fotokopje-printim, për mirëmbajtjen e instalimit të spërkatësve kundër zjarrit (nënstacion i thatë, spërkatës dhe pompa) dhe pajisjeve PP, për angazhimin e firmës për shërbime hidraulike dhe elektrike, për mirëmbajtjen dhe servisimin e sistemit për ftohje, ngrohje dhe ventilim si dhe për mirëmbajtjen teknike të ashensorëve dhe platformave, u shpenzuan mjete në shumë prej 9.922.566,00 denarë;
- për shërbime shtypi janë shpenzuar mjete në shumë prej 367.100,00 denarë;
 - për shpenzime postare, për tarifa telefonike duke përfshirë telefona celular dhe fikse si dhe për tarifa të tjera për shërbime transporti, u shpenzuan mjete në shumë prej 1.600.557,00 denarë;
 - për shpenzime për reprezentacion u harxhuan mjete në shumë prej 684.580,00 denarë;
 - për marrjen me qira për shfrytëzim të objekteve ndërtimore përkatësisht mjeteve të destinura për marrje me qira për kolokacion (vendosje) të pajisjeve TIK në 8 lokacione të ndryshme në RMV, janë shpenzuar mjete në shumë prej 1.202.790,00 denarë;
 - për shpenzime të taksave gjyqësore dhe dministrative, për blerje të gazetave, revistave, literaturës profesionale, qasje në internet në botimet elektronike të „Gazetës Zyrtare të RMV-së“, si dhe botimet e shtypit të „Gazetës Zyrtare“ për vitin aktual dhe për pjesëmarrje në seminare, punëtori, konferenca, konsultime dhe të ngjajshme, janë shpenzuar mjete në shumë prej 176.012,00 denarë;
 - për kontrolle teknike dhe regjistrimin e automjeteve zyrtare janë shpenzuar mjete në shumë prej 38.815,00 denarë;
 - për mbajtjen e Ditëve të Arsimimit Mediatik nga Agjencia, u shpenzuan mjete në shumë prej 1.473.079,00 denarë;
 - për provizion të tarifave transaksioni dhe provizion bankar, u shpenzuan mjete në shumë prej 96.116,00 denarë;
 - për sigurimin e objektit të punës së Agjencisë për sigurimin e pajisjeve që posedojnë, për sigurimin e automjeteve zyrtare, për sigurimin e përgjegjësive automobilistike gjatë regjistrimit për kartona të gjelbër dhe sigurimin e udhëtimit, janë shpenzuar mjete në shumë prej 270.027,00 denarë;
 - për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, mëditjeve për udhëtime zyrtare në vendë dhe jashtë vendit për kompensim të harxhimeve për transport për udhëtime zyrtare në vend dhe jashtë vendit, për shpenzimet e akomodimit brenda dhe jashtë vendit, janë shpenzuar mjete në shumë prej 1.313.328,00 denarë;
 - për çmime përvjetori u shpenzuan mjete në shumë prej 242.217,00 denarë;
 - për kompensime të tjera për të punësuarit janë shpenzuar mjete në shumë prej 3.528.404,00 denarë;
 - për kompensime të anëtarëve të Këshillit të Agjencisë deri më 23.06.2025, janë shpenzuar mjete në shumë prej 6.059.098,00;
 - për diferencat negative të llogaritura të kursit të këmbimit janë shpenzuar mjete në shumë prej 2.023,00 denarë;
 - për anëtarësim vjetor në platformën ndërkombëtare të oganeve rregullatore (EPRA) janë shpenzuar mjete në shumë prej 253.175,00 denarë;
 - për shërbime kontraktuese përkatësisht për angazhim përmes Agjencisë për punësime të përkohshme për bashkëpunëtor të jashtëm të cilën kryesisht ishin të angazhuar për monitorimin e aktiviteteve zgjedhore në vitin 2025 (zgjedhjet lokale), për angazhimin e zyrës për përkthim dhe për mirëmbajtjen e higjienës në ambientet e punës së Agjencisë, u shpenzuan mjete në shumë prej 10.598.600,00 denarë;
 - për shërbime avokatie, u shpenzuan mjete në shumë prej 366.000,00 denarë;
 - për shërbime noteriale, u shpenzuan mjete në shumë prej 13.403,00 denarë;
 - për shërbime të tjerapersonale dhe intelektuale të destinuar për trajnimin e të punësuarve në Agjencion , u shpenzuan mjete në shumë prej 167.817,00 denarë;
 - për analizën e çështjeve gjinore dhe mënyrës së përfaqësimit dhe prezantimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve, u shpenzuan mjete në shumë prej 338.478,00 denarë;

- për sigurimin e të dhënave të marra nga matjet elektronike të shikueshmërisë të reklamave politike me pagesë me të dhëna të detajuara për transmetimin e RPP (reklamim i paguar politik) të televizione tokësore kombëtare gjatë zgjedhjeve lokale në vitin 2025, u shpenzuan mjete në shumë prej 512.120,00 denarë;
- për shpenzime të tjera përkatësisht për sistemin e shpërndarjes së internetit të Regjistrit Qendror, për shërbime revizioni për lidhje interneti me hostimin e internet faqeve ekzistuese të Agjencisë, për marrjen me qira për publikim e njoftimeve në gazetat ditore, për njoftime zyrtare për transmetim të të dhënave nga lokacione të largëta (8 lokacione të RMV-së), me komunikacion të pakufizuar të përfshirë sipas lokacionit për dy drejtimet (download/upload) dei në selinë e Agjencisë dhe shpenzime të tjera të Agjencisë, u shpenzuan mjete në shumë prej 3.067.449,00 denarë;
- për blerjen e mobiljeve dhe pajisje zyre u shpenzuan mjete në shumë prej 22.370,00 denarë;
- për furnizim e kryer të pajisjes TIK (teknologjisë informative të komunikimit) dhe modernizimin e server sallës, u shpenzuan mjete në shumë prej 4.666.626,00 денари;
- për furnizim e çertifikatave digjitale për nënshkrim elektronik të tokenit, të licencave për pajisje sigurie të rrjetit kompjuterik (Firewall), të licencave për softuer të bekapimit automatik të të dhënave dhe për riçertifikimin e ISO-standarteve 9001:2015, u shpenzuan mjete në shumë prej 962.340,00 denarë;
- për ndihmë financiare – donacione u shpenzuan mjete në shumë prej 3.000.000,00 denarë;
- për pagesën e pagave bruto të punësuarve në shërbimin profesional, u shpenzuan mjete në shumë prej 91.679.888,00 denarë dhe
- për taksat dhe kontributet që lidhen me shlyerjen e kërkesave të papaguara, janë shpenzuar mjete në shumë prej 117.966,00 denarë.

Shpenzimet në total në vitin 2025 janë 5.627.368,00 denarë më të larta se të ardhurat në total në të njëjtin vit. Nëse Ministria e Transformimit Digjital në llogarinë e Agjencisë për dhjetorin do të kishte paguar shumën e saktë mujore prej 6.572.208,00 denarë në vend të 1.572.208,00 denarë (që është 5.000.000,00 denarë më pak), nuk do të paraqitej ndryshim kaq i madh midis shpenzimeve dhe të ardhurave për vitin 2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr.Sasho Stefanovski**

SHTOJCA NDAJ RAPORTIT

1. LEJET E DHËNA/TË HEQURA DHE PASQYRA E MASAVE TË SHQIPTUARA

Dhënia e lejeve me konkurs publik

1. Sasha Mitiq nga Kumanova	
Numri dhe data e Letrës së paraqitur me qëllim / Kërkesë me shkrim për shpallje të konkursit publik për dhënie e lejes	Kërkesë me shkrim, nr. ark.08-2944/1, datë 4.7.2024
Mënyra e transmetimit të shërbimit programor (mjeti teknik për transmetim)	Transmetues tokësor
Niveli i shikueshmërisë (shtetëror, rajonal ose lokal)	Nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës
PA1 numri dhe data e vendimit për shpalljen e konkursit publik për dhënie e lejes	Vendimi PA1 nr. 08-275 datë 21.10.2024 për shpalljen e konkursit publik për dhënie e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal
Numri dhe data e kërkesës së paraqitur për dhënie e lejes	PA1 nr. 08-362 datë 27.12.2024
PA 1 numri dhe data e Vendimit për dhënie e lejes	PA1 nr. 08-362 datë 6.2.2025
Gazeta Zyrtare në të cilën është publikuar Vendimi për shpalljen e konkursit publik për dhënie e lejes	"Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr.219/24 datë 29.10.2024
Dhënia e lejes / Refuzimi i kërkesës / Vendimi për konkurs publik të pasuksesshëm	Dhënia e lejes
Viti i dhënies së lejes / viti i refuzimit të kërkesës / konkurs publik i pasuksesshëm	Viti 2025

2. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive Buba Mara Ranko ShPKNJ P Shkup	
Numri dhe data e Letrës së paraqitur me qëllim/ Kërkesë me shkrim për shpallje të konkursit publik për dhënie e lejes	Kërkesë me shkrim, nr. ark.08-102/1, datë 10.1.2025
Mënyra e transmetimit të shërbimit programor (mjeti teknik për transmetim)	Transmetues tokësor
Niveli i shikueshmërisë (shtetëror, rajonal ose lokal)	Nivel lokal, në zonën e komunës së Prilepit
PA1 numri dhe data e vendimit për shpalljen e konkursit publik për dhënie e lejes	Vendimi PA1 nr. 08-140 datë 25.4.2025 për shpalljen e konkursit publik për dhënie e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal.
Numri dhe data e kërkesës së paraqitur për dhënie e lejes	PA1 nr. 08-211 datë 7.7.2025
PA 1 numri dhe data e Vendimit për dhënie e lejes	PA1 nr. 08-225 datë 29.7.2025
Gazeta Zyrtare në të cilën është publikuar Vendimi për shpalljen e konkursit publik për dhënie e lejes	„Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr. 91/25 datë 7.5.2025
Dhënia e lejes / Refuzimi i kërkesës / Vendimi për konkurs publik të pasuksesshëm	Dhënia e lejes
Viti i dhënies së lejes / viti i refuzimit të kërkesës / konkurs publik i pasuksesshëm	Viti 2025

3. Ensar Alushi nga Struga	
Numri dhe data e Letrës së paraqitur me qëllim / Kërkesë me për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes	Kërkesë me shkrim, nr.ark.08-432/1 datë 29.1.2025
Mënyra e transmetimit të shërbimit programor (mjeti teknik për transmetim)	Transmetues tokësor
Niveli i shikueshmërisë (shtetëror, rajonal ose lokal)	Nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës
PA1 numri dhe data e vendimit për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes	Vendim PA1 nr. 08-153 të datës 8.5.2025 për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimi programor në nivel lokal
Numri dhe data e Kërkesës së paraqitur për dhënien e lejes	PA1 nr. 08-213 datë 14.7.2025
Numri PA 1 dhe data e Vendimit për dhënien e lejes	PA1 nr. 08-213 datë 8.8.2025
Gazeta Zyrtare në të cilën është publikuar Vendimi për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes	„Gazeta Zyrtare e RMV-së “ nr. 96/25 datë 14.5.2025
Dhënia e lejes / Refuzimi i kërkesës / Vendimi për konkurs publik të pasuksesshëm	Dhënia e lejes
Viti i dhënies së lejes / viti i refuzimit të kërkesës / konkurs publik i pasuksesshëm	Viti 2025

4. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive Buba Mara Ranko ShPKNJP Shkup	
Numri dhe data e Letrës së paraqitur me qëllim / Kërkesë me shkrim për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes	Kërkesë me shkrim, nr.ark.08-102/1 datë 10.1.2025
Mënyra e transmetimit të shërbimit programor (mjeti teknik për transmetim)	Transmetues tokësor
Niveli i shikueshmërisë (shtetëror, rajonal ose lokal)	Nivel lokal, në zonën e komunës së Shtipit
PA1 numri dhe data e Vendimit për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes / PA1 numri dhe data e Vendimit për refuzimin e kërkesës për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes	Vendim PA1 nr. 08-155 datë 8.5.2025 për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimi programor në nivel lokal
Numri dhe data e kërkesës së paraqitur për dhënien e lejes	PA1 nr. 08-214 datë 14.7.2025
PA 1 numri dhe data e Vendimit për dhënien e lejes	PA1 nr. 08-214 datë 8.8.2025
Gazeta Zyrtare në të cilën është publikuar Vendimi për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes	„Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr. 96/25 datë 14.5.2025
Dhënia e lejes / Refuzimi i kërkesës / Vendimi për konkurs publik të pasuksesshëm	Dhënia e lejes
Viti i dhënies së lejes / viti i refuzimit të kërkesës / konkurs publik i pasuksesshëm	Viti 2025

SHTOJCË NR. 1.2.

Aktvendime për mdërmarrje të masës – paralajmërim publik ndaj transmetuesve në vitin 2025

Numri rendor	Emri i transmetuesit që është paralajmëruar	Numri i Arkivit (PA1 numër) dhe data e aktvendimit për paralajmërim publik	Dispozita e LSHMAAV/LM që është shkelur	Përshkrim i shkeljes
1	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV DUE Nazmi ShPKNJ P Gostivar	PA1 nr. 03-9 datë 22.1.2025	Neni 51, paragrafi (1) të LShMAAV	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuar më 4 nëntor 2024, nuk ofroi informacionin që duhej t'u vihej në dispozicion përdoruesve.
2	Shoqëria Tregtare me veprimtari transmetimi SPEKTRA, Komuna Labunishtë ShPKNJ P	PA1 nr. 03-10 datë 22. 1.2025	Neni 64, paragrafi (1) të LShMAAV	Në shërbimin programor televiziv të transmetuesit, më 4 nëntor 2024, në disa përmbajtje programore u transmetuan pjesë të fjalës në gjuhë të huaja (serbisht ose anglisht ose shqip), pa u përkthyer paraprakisht në gjuhën maqedone.
3	Shoqëria Tregtare me veprimtari transmetimi SPEKTRA, Komuna Labunishtë ShPKNJ P	PA1 nr. 03-11 datë 23.1.2025	Neni 92, paragrafi (1) të LShMAAV	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 4 nëntor 2024, nuk transmetoi së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.
4	Ndërmarrja Publike Radiodifuzive RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonis - Shërbimi i Tretë Programor (RTM3)	PA1 nr. 03-51 datë 20.2.2025	Neni 51, paragrafi (1) të LShMAAV	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuar më 8 janar 2025, nuk ofroi informacionin që duhej t'u vihej në dispozicion përdoruesve.
5	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV DUE Nazmi ShPKNJ P Gostivar	PA1 nr. 03-67 datë 25.2.2025	Neni 92, paragrafi (1) të LShMAAV	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 27 janar 2025, nuk transmetoi së paku 30% program të krijuara burimor si vepra audiovizuale maqedonase.
6	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV DUE Nazmi ShPKNJ P Gostivar	PA1 nr. 03-68 datë 25.2.2025	Neni 50, paragrafi (3) të LShMAAV dhe neni 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve	Në shërbimin programor televiziv të transmetuesit, të transmetuar më 27 janar 2025, përpara transmetimit të disa programeve të kategorisë së parë, të dytë dhe të katërt, u aplikua sinjal i gabuar programor për mbrojtjen e të miturve, që nuk parashikohet në RrMM.
7	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV NEWS ShPKNJ P Kumanovë	PA1 nr. 03-69 datë 25.2.2025	Neni 51, paragrafi (1) të LShMAAV	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuar më 28 janar 2025, nuk ofroi informacionin që duhej t'u vihej në dispozicion përdoruesve.

8	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV NEWS ShPKNJ P Kumanovë	PA1 nr. 03-70 datë 25.2.2025	Neni 14 të LM	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuar më 28 janar 2025, nuk i publikoi të dhënat për impresium të regjistrimit të Festivalit të Këngëve dhe Valleve Shqiptare, të regjistrimit nga manifestimi i mbajtur me rastin e vendosjes së tre shkronjave të UÇK-së në fshatin Tanushë dhe regjistrimit nga manifestimi i mbajtur me rastin e Ditës së Alfabetit Shqip.
9	Republika e Maqedonisë së Veriut - Universiteti Shtetëror "Goce Delçev" Shtip - Institucion radiodifuziv jofitimprurës RADIO UNIVERSITARE UGD FM	PA1 nr. 03-102 datë 7.4.2025	Neni 67, paragrafi (6) të LShMAAV	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor gjatë një jave, përkatësisht në periudhën nga 10 deri më 16 shkurt 2025, nuk ka zbatuar së paku 80% të konceptit programor për të cilin i është dhënë leja e transmetimit në radio.
10	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV SHENJA ShPKNJ P Shkup	PA1 nr. 03-116 datë 11.4.2025	Neni 14 të LM	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuar më 4 mars 2025, nuk publikoi të dhënat për impresium në programin dokumentar "Al Jazeera hulumton (Al Jazeera – Investigations)".
11	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI ShPKNJ P eksport-import Saraj, Shkup	PA1 nr. 03-117 datë 11.4.2025	Neni 14, të LM	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuar më 4 mars 2025, nuk publikoi impresium në emisionet edukative me përmbajtje fetare: "Merr Frymë" (Диши) dhe "N'konak te Hoxha"(Во конакот на оцата) dhe në emisionit informativ aktual "Klan debat" (Дебатна емисија Клан).
12	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI ShPKNJ P eksport-import Saraj, Shkup	PA1 nr. 03-118 datë 11.4.2025	Neni 51, paragrafi (1) të LShMAAV	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuara më 4 mars 2025, nuk ofroi informacionin që duhej t'u vihej në dispozicion përdoruesve.
13	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI ShPKNJ P eksport-import Saraj, Shkup	PA1 nr. 03-119 datë 11.4.2025	Neni 50, paragrafi (3) të LShMAAV dhe neni 16 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve	Në shërbimin programor televiziv të transmetuesit, më 4 mars 2025, episodet e seriaeve artistike Nënë ("Мајка"), "Merjem" dhe "Tradhetia" ("Неверство"), të shënuara si programe të kategorisë së tretë (12+), u transmetuan në periudha kohore të papërshtatshme në shërbimin programor.
14	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KOMPANI 21-M ShPKNJ P Shkup	PA1 nr. 03-120 datë 11.4.2025	Neni 98, paragrafi (2) të LShMAAV dhe neni 14, paragrafi (4) të Rregullores për teknikat e reja të reklamimit	Në kuadër të shërbimit programor televiziv, të transmetuar më 4 mars 2025, në edicionin premierë të emisionit "Thirre 21-shin (Повикај 21)" u transmetuan reklama pop-up/në ekran të ndarë pa kaluar periudha e përcaktuar prej së paku 15 minuta.
15	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KOMPANI 21-M ShPKNJ P Shkup	PA1 nr. 03-121 datë 11.4.2025	Neni 53, paragrafi (2) të LShMAAV	Në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 4 mars 2025, në edicionin premierë të emisionit informativ aktual "Thirre 21-shin (Повикај 21)", u transmetua komunikim i fshehtë komercial audiovizual për "Оптика Капри"(Оптика Капри).

16	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV SHENJA ShPKNjP Shkup	PA1 nr. 3-122 datë 11.4.2025	Neni 92, paragrafi (1) dhe (3) të LShMAAV	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 5 mars 2025, nuk transmetoi së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, as nuk transmetoi së paku gjysmën e minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase në periudhën nga ora 7:00 deri në orën 19:00.
17	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KOMPANI 21-M ShPKNjP Shkup	PA1 nr. 03-123 datë 11.4.2025	Neni 52 të LShMAAV	Në kuadër të shërbimit programor televiziv, të transmetuar më 4 mars 2025, në emisionin "Thirre 21-shin (Повикај ro 21)" – shou me fjalë informativ aktual në të cilin shikuesit kanë edhe mundësinë të marrin pjesë në shpërblime, ofruesi i shërbimit mediatik audiovizual nuk ofroi as publikim të qartë të rregullave, as informacion publik për shpërblimin e premtuar. Megjithatë, njoftimi që publikoi në faqen e internetit nuk përmban informacionin e nevojshëm të përcaktuar në Rregulloren për programe me pjesëmarrje shpërblyese dhe për përdorimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar.
18	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KOMPANI 21-M ShPKNjP Shkup	PA1 nr. 03-124 datë 11.4.2025	Neni 14 të LM	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuar më 4 mars 2025, nuk i publikoi të dhënat për impresium në emisionet "#21 Repotazhe"(21 Репортажа) dhe "Për ditë të mbarë"(За добар ден).
19	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI ShPKNjP eksport-import Saraj, Shkup	PA1 nr. 03-125 datë 11.4.2025	Neni 92, paragrafët (1) dhe (3) të LShMAAV	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 5 mars 2025, nuk transmetoi së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, as nuk transmetoi së paku gjysmën e minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase në periudhën nga ora 7:00 deri në orën 19:00.
20	Shoqëria Radiodifuzive NASHA TV SH.PK Shkup	PA1 nr. 03-126 datë 11. 4.2025	Neni 98, paragrafi (2) të LShMAAV dhe neni 14, paragrafi (4) të Rregullore për teknikat e reja të reklamimit	Në kuadër të shërbimit programor televiziv, të transmetuar më 4 mars 2025, në edicionet premierë dhe të ritransmetuara të emisioneve "Projekt zdravje", "Gradime da trae" dhe "Zgotveno nad oblaci", u transmetuan reklama pop-up/në ekranit të ndarë pa kaluar periudha e përcaktuar prej së oaku 15 minuta.
21	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive 24 NEWS ShPKNjP Shtip	PA1 nr. 03-138 datë 25.4.2025	Neni 55, paragrafi (2), nënparagrafët 2, 3 dhe 4 të LShMAAV dhe pikat 25 dhe 26 të Rregullore për zbatimin për plasim të produkteve	Në shërbimin programor televiziv të radiodifuzerit, më 4 mars 2025, në emisionin e specializuar informativ "Faktori Shëndi (Фактор здравје) me Biljana Debarlievën", nuk u respektuan kushtet për plasim të produkteve në programet audiovizuale, si dhe rregullat për shënimin e programeve që përmbajnë plasim të produkteve.
22	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV DUE Nazmi ShPKNjP Gostivar	PA1 nr. 03-154 datë 9.5.2025	Neni 14 të LM	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv, të transmetuar më 25 mars 2025, nuk ka publikuar impresium të: programeve me përmbajtje fetare "Rregullat e shkurozimit në islam"(Правилата за развод во исламот), lexim nga Kurani (njësi audiovizive pa titull), "Drita islame" (Светлина на исламот)dhe "Drita e Islamit". ("Besimi she shpresa në Allahun xh.sh."); programin dokumentar-argëtues "Kuzhina në ekran" (Кухната на екран); dhe në emision reprizë-informativ intervistë me Ardian Hoxhën,

				drejtor në Albafon, "Emission debativ - Meqë ra fjalë" ("Дебатна емисија – Како што е зборот")
23	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV Studio TERA Mangovski Zoran Manastir ShPKNjP	PA1 nr. 03-208 datë 8.7.2025	Neni 50, paragrafi (3) të LShMAAV dhe neni 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve	Në shërbimin programor televiziv të radiodifuzerit, të transmetuar më 2 maj 2025, gjatë transmetimit të dy programeve artistike, gabimisht është aplikuar sinjalizimi paralajmërues për program të kategorisë së dytë. Numri "8" dhe shenja "+" mungonin në të gjithë pamjen e përcaktuar të sinjalizimit paralajmërues, si tregues të grupmohës së shikuesve për të cilën është destinuar programi.
24	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV M Arnaudov Mihajlo Ohrid ShPKNjP	PA1 nr. 03-209 datë 8.7.2025	Neni 50, paragrafi (3) të LShMAAV dhe neni 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve	Në shërbimin programor televiziv të radiodifuzerit, të transmetuar më 2 maj 2025, disa programe u transmetuan me sinjalizim paraprak të aplikuar gabimisht për program të kategorisë së dytë. Numri "8" dhe shenja "+" mungonin në të gjithë pamjen e përcaktuar të sinjalizimit paralajmërues, si tregues të grupmohës së shikuesve për të cilën është destinuar programi.
25	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV KANAL FESTA ShPKNjP Kumanovë	PA1 nr. 03-216 datë 22.7.2025	Neni 92, paragrafët (1) dhe (3) të LShMAAV	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 3 qershor 2025, nuk transmetoi së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, as nuk transmetoi së paku gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase në periudhën nga ora 7:00 deri në orën 19:00.
26	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISION PLUS ShPKNjP Kumanovë	PA1 nr. 03-217 datë 22.7.2025	Neni 92, paragrafët (1) dhe (3) të LShMAAV	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 3 qershor 2025, nuk transmetoi së paku 30% program të krijuara burimor si vepra audiovizuale maqedonase, as nuk transmetoi së paku gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase në periudhën nga ora 7:00 deri në orën 19:00.
27	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI USKANA MEDIA ShPKNjP Kërçovë	PA1 nr. 03-221 datë 29.7.2025	Neni 64, paragrafi (1) të LShMAAV	Në shërbimin programor televiziv të radiodifuzerit, më 3 qershor 2025, u transmetua reklamë për kompaninë "Alba Bridges" fillimisht në gjuhën angleze, pa ofruar përkthim në shqip ose në gjuhën maqedone, gjuhët në të cilat media transmeton programe në pajtim me lejen.
28	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI USKANA MEDIA SH.P.Kërçovë	PA1 nr. 03-222 datë 29.7.2025	Neni 92, paragrafët (1) dhe (3) të LShMAAV	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 3 qershor 2025, nuk transmetoi së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, as nuk transmetoi së paku gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase në periudhën nga ora 7:00 deri në orën 19:00.
29	Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI USKANA MEDIA ShPKNjP Kërçovë	PA1 nr. 03-223 datë 29.7.2025	Neni 51, paragrafi (1) të LShMAAV	Transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuar më 3 qershor 2025, nuk ofroi informacionin që duhej t'u vihej në dispozicion përdoruesve.

Agjencia, me Planin Vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore në vitin 2025, parashikoi kryerjen e mbikëqyrjes së rregullt programore mbi ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë dy herë, një herë në çdo gjysmë viti. Në korrik, Shoqëria e Shërbimeve të Komunikimit A1 MAQEDONI ShPKNJ P Shkup (Vip Now) e njoftoi Agjencinë se po pushonte së kryeri veprimtarin e saj, për këtë arsye u fshi nga regjistri. Në pajtim me këtë, u kryen shtatë mbikëqyrje të rregullta (katër në maj dhe tre në shtator).

Mbikëqyrja u krye mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në nenet e mëposhtme të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale:

➤ **Neni 49 – Detyrimet për veprat kinematografike**

"Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale nuk mund të publikojnë, përkatësisht transmetojnë vepra kinematografike jashtë periudhës së specifikuar në kontratat me mbajtësit e të drejtave."

➤ **Neni 50 – Mbrojtja e të miturve**

paragrafi (1) – *"Transmetuesit nuk mund të transmetojnë ose ritransmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve, në veçanti programe që përmbajnë pornografi ose dhunë të tepruar. Ofruesit e shërbimeve me kërkesë, duhet të marrin masat më të rrepta teknike për të siguruar që të miturit të mbrohen nga përmbajtja më e dëmshme, siç është dhuna e tepruar dhe pornografia".*

paragrafi (2) - *"Dhuna e tepërt është përhapja e mesazheve tekstuale, verbale dhe vizuale që në terma të programit që janë të arritshme për të miturit, glorifikojnë format fizike, verbale ose psikologjike të sadizmit ose llojeve të ngjashme të dhunës, që është qëllim në vetvete dhe nuk mund të justifikohet në asnjë mënyrë as përmes kontekstit të zhanrit dhe as përmes motiveve të veprimit dramatik të programit të shfaqur".*

paragrafi (3) - *"Përveç programeve të përmendura në paragrafin (1) të këtij neni, programe të tjera që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve duhet të ofrohen nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale në mënyrë të tillë që të miturit të mos mund t'i shohin ose t'i dëgjojnë programet në mënyrën e zakonshme. Kur programet transmetohen ose ritransmetohen në formë të pakoduar, ofruesi i shërbimit mediatik audiovizual është i detyruar të ofrojë paralajmërim paraprak akustik dhe mundësinë e njohjes me anë të shenjave vizuale gjatë gjithë transmetimit të programeve."*

Mbikëqyrje të rregullta programore në vitin 2025	
Ofrues me kërkesë	Shkeljee e konstatuara të LShMAAV-së
Maj	
TELEKOMI I MAKEDONSË ShA Shkup	/
A1 MAQEDONI ShPKNjP Shkup	/
SVOD Master ShPK Shkup	/
MTEL ShPKNjP Shkup	/
Shtator	
SVOD Master ShPK Shkup	/
MTEL ShPKNjP Shkup	/
TELEKOMI I MAKEDONSË ShA Shkup	/

Të gjitha raportet nga mbikëqyrjet e kryera janë të disponueshme për publikun në faqen e internetit të Agjencisë nëpërmjet linkut: [Даватели на АВМУ по барање – Агенција за аудио и аудиовизуелни медиумски услуги \(avmu.mk\)](http://www.avmu.mk).

**3. RAPORT FINANCIAR MBI ZBATIMIN E PLANIT FINANCIAR PËR VITIN 2025, ME TË
ARDHURAT, SHPENZIMET, KËRKESAT DHE DETYRIME TË REALIZUARA PËR VITIN 2025**

Të ardhurat në total të realizuara në vitin 2025 janë shumë prej 141.336.000,00 denarë. Këto të ardhura janë realizuar nga burimet e mëposhtme:

- Të ardhura nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për aktivitetet zgjedhore që u zhvilluan në vitin 2025 (zgjedhjet lokale) për të cilat Agjencia përdori mjete në shumë prej 7.581.728,00 denarë;
- Burime financiare nga Buxheti i RMV-së dhe të ardhura nga taksa e paguar radiodifuzive në shumë prej 74.117.431,00 denarë;
- Të ardhura të realizuara nga kompensimet e lejeve për transmetim televiziv dhe radio në shumë prej 47.495.388,00 denarë;
- Të ardhura nga mbikëqyrja për ritransmetim të shërbimit programor dhe nga ofruet e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë në shumë prej 10.751.766,00 denarë;
- Të ardhura nga faturat tranzite në shumë prej 1.072.760,00 denarë dhe
- Të ardhura të tjera në shumë prej 316.927,00 denarë.

Qeveria e RMV-së me Vendimin nr. 50-8237/3 të datës 04.09.2025, miratoi mjete nga Buxheti i RMV-së në shumë totale prej 11.270.000,00 denarë për Agjencinë e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale për monitorimin e zgjedhjeve lokale në vitin 2025. Këto mjete ishin të destinuara ekskluzivisht për financimin e aktiviteteve të Agjencisë gjatë proceseve zgjedhore dhe u transferuan në llogari të veçantë. Agjencia mjete i shfrytëzoi për qëllimet e mëposhtme:

- Për punësime të përkohshme u shfrytëzuan në total 4.445.069,00 denarë me TVSH;
- për shërbimin – transfer i të dhënave nga lokacione të largëta me komunikacion të pakufizuar në dy drejtime (download/upload) u shfrytëzuan mjete në shumë totale prej 675.432,00 denarë;
- për shpenzime avokatie u shpenzuan mjete në shumë totale prej 122.000,00 denarë;
- për shpenzime telefoni u shpenzuan mjete në shumë totale prej 389.254,00 denarë;
- për mirëmbajtjen e softuerit të sistemit për monitorimin e radiove dhe TV-shërbime dhe monitorim të ORRPKE (operatorë të rrjetit publik të komunikimit elektronik) u shpenzuan mjete në shumë totale prej 1.179.816,00 denarë;
- për shpenzime postare u shpenzuan mjete në shumë totale prej 20.050,00 denarë;
- për materiale zyre u shpenzuan mjete në shumë totale prej 25.160,00 denarë;
- për sigurimin e të dhënave të marra përmes matjes elektronike të shikueshmërisë së reklamave politike me pagesë me të dhëna të detajuara për transmetimin e RPP në televizionet kombëtare tokësore për Zgjedhjet Lokale 2025 u harxhuan mjete në shumë totale prej 512.120,00 denarë dhe
- për mirëmbajtjen e hardver sistemit për monitorimin e shërbime televizive dhe radio dhe mbikëqyejen e ORRPKE (operator të rrjetit publik të komunikimit elektronik), u shpenzuan mjete në shumë totale prej 207.975,00 denarë.

Gjithashtu, nga kjo llogari janë paguar provizione bankare dhe provizione mujore për mirëmbajtjen e llogarisë në shumë totale prej 4.852,00 denarë, dhe kështu, nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025 janë shfrytëzuar gjithsej 7.581.728,00 denarë.

Mjetet e pashfrytëzuara në shumë totale prej 3.688.272,00 Agjencia vazhdon ti shfrytëzon dhe në vitin 2026, për shkak se Kuvendi i RMV-së shpalli zgjedhje të përsëritura për kryetar të komunës së Gostivarit, kryetar të komunës së Vrapçishtit, kryetar të komunave të Mavrovës dhe Rostushës dhe kryetar të komunës Qendër Zhupë (të cilat u mbajtën më 11 janar 2026) dhe ato janë ekskluzivisht për përmbushjen e detyrimeve ligjore në lidhje me aktivitetet zgjedhore në vitin 2026 (zgjedhje lokale në katër komuna).

Pas përfundimit të aktiviteteve zgjedhore, Agjencia i paraqiti Ministrisë së Financave të RMV-së shpjegim të detajuar të shpenzimeve reale të kryera për zbatimin e aktiviteteve të Agjencisë gjatë proceseve zgjedhore (zgjedhjet lokale në 2025 dhe 2026) dhe mjetet e tepërta do të kthehen plotësisht në Buxhetin e RMV-së.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale siguron mjete për financimin e aktiviteteve radiodifuzive në pajtim me nenin 105, paragrafi (1) dhe (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25) të cilat thonë:

- (1) „Mjete për financimin e veprimtarisë radiodifuzive, për punën dhe zhvillimin e RTM-së, Ndërmarrjes publike „Radiotelevizioni i Maqedonisë“ dhe Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në shumë prej 1 % të të ardhurave të realizuara tatimore përcaktuar në llogarinë e fundit përfundimtare të miratuar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut“.
- (2) Mjetet nga paragrafi (1) do të ndahen sipas mënyrës në vijim:
 - 80 % për RTM për mbulimin e shpenzimeve për krijimin dhe transmetimin e programeve dhe për zhvillimin tekniko-teknologjit,
 - 15 % për NP „Radiodifuzioni i Maqedonisë“ për mirëmbajtje, përdorim dhe zhvillim të rrjetit publik radiodifuziv dhe
 - 5 % për Agjencisë e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Shuma që i paguhet Agjencisë në pajtim me ligjin llogaritet në bazë vjetore, por detyrimi i pagesës është në bazë mujore.

Në lidhje me zgjidhjen e cituar ligjore, në llogarinë përfundimtare të miratuar të Buxhetit të RMV-së për vitin 2023 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.169/2024) thuhet se të ardhurat totale tatimore të realizuara në vitin 2023 në Buxhetin e RMV-së arritën në shumë prej 157.733.000.000,00 denarë. Prandaj, në Buxhetin e RMV-së për vitin 2025, të publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.254 të datës 16.12.2024", u përcaktuan mjetet e destinuar për financimin e veprimtarisë radiodifuzive, përkatësisht 1% nga të ardhurat tatimore të realizuara arrijnë në shumë prej 1.577.330.000,00 denarë (një miliard e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e treqind e tridhjetë mijë denarë, nga të cilat 5% për Agjencinë, të cila në nivel vjetor arrin shumën prej 78.866.500,00 denarë, ose më saktë shumë mujore prej 6.572.208,00 denarë.

Duke filluar nga janari i vitit 2025 deri në nëntor të vitit 2025, Ministria e Transformimit Digjital në llogarinë e Agjencisë pagoi shumën e saktë mujore prej 6.572.208,00 denarë, ndërsa për dhjetorin e vitit 2025, mbi këtë bazë Agjencisë iu transferuan 1.572.208,00 denarë, të cilët janë për 5.000.000,00 denarë më pak.

Për këtë arsye, Agjencia me Shkresë iu drejtua ministrisë kompetente me Kërkesë për informacion në lidhje me nënpagesën e mjeteve për financimin e veprimtarisë radiodifuzive (nr.y në ark. 03-289/1 datë 23.01.2026 dhe nr.y në ark. 03-289/2 datë 20.02.2026) për dhjetorin 2025 dhe deri më tani Agjencia nuk ka marrë përgjigje.

Në pajtim me të gjitha sa më sipër, të ardhurat totale të realizuara në vitin 2025 për financimin e veprimtarisë radiodifuzive dhe nga pagesa e taksës radiodifuzive arritën në shumë prej 74.117.431,00 denarë.

Në vitin 2025, bazuar në të ardhurat nga lejet për transmetim televiziv dhe radio, u realizuan mjete në shumë totale prej 47.495.388,00 denarë.

Nga regjistri i radiodifuzerëve në vitin 2025 për arsye të ndryshme u fshinë transmetuesit në vijim:

- Njësia organizative radiodifuzive jofitimprurëse RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM 92.9;
- Njësia radiodifuzive jofitimprurëse RADIO UNIVERSITARE UGD FM – Universiteti „Goce Dellçev“ Shtip dhe
- Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI ShPKNJ P eksport – import Saraj, Shkup.

Në pajtim me nenin 142, paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18, 27/19 dhe 154/23 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), Agjencia realizon të ardhura si nga mbikëqyrja e ritransmetimit të shërbimeve programore, ashtu edhe nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë. Këto të ardhura në vitin 2025 arritën në shumë prej 10.751.766,00 denarë.

Në vitin 2025, janë realizuar të ardhura nga faturat tranzite në shumë prej 1.072.760,00 denarë. Ato janë realizuar nga faturat tranzite të lëshuara nga Agjencia për konsumimin e energjisë elektrike, për mirëmbajtjen e ashensorëve dhe platformës dhe për mirëmbajtjen dhe servisimin e sistemit të ftohjes, ngrohjes dhe ventilimit.

Agjencia gjithashtu ka realizuar të ardhura të tjera në shumë prej 316.927,00 denarë.

Struktura e të ardhurave totale paraqitet në Shtojcën Nr. 1, pjesë përbërëse e Raportit.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale më 11.2.2025 miratoi vendim (nr.y në ark.05-602/1) për dhënien e ndihmës financiare - donacion për Institucionin Publik Shëndetësor - Spitali i Specializuar për Mjekësi Paliative Geriatrike "13 Nëntori" Shkup, në shumën prej 1.000.000,00 (një milion) denarë, për zbatimin e "Projektit për efikasitet energjetik për IPSH SBGPM 13 Nëntori Shkup", qëllimi i të cilit është instalimi i sistemit të ri vetëqëndrueshëm për ngrohjen e ujit përmes sistemi diellor kolektor, i cili është energjikisht më efikas nga sistemi që përdor aktualisht spitali, më ekonomik, më ekologjik ndaj mjedisit, i cili do të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përmes kujdesit dhe higjienës personale më cilësore për pacientët geriatrikë dhe paliativë, uljen e faturave të energjisë elektrike të spitalit, si dhe mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e gjelbër, uljen e ndotjes së ajrit dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike. Për këtë qëllim, Agjencia nënshkroi marrëveshje donacioni me Institucionin Publik të Shëndetit - Spitalin e Specializuar për Mjekësi Paliative Geriatrike "13 Nëntori" Shkup dhe Agjencia mjetet i transferoi më datë 11.4.2025, pas marrjes së mendimi pozitiv për interes publik nga Ministria e Drejtësisë e RMV-së.

Agjencia më 20.3.2025, Agjencia miratoi edhe një vendim (nr.y në ark. 05-1137/1) për dhënien e ndihmës financiare - donacion në shumën prej 1.500.000,00 (një milion e pesëqind mijë) denarë, si ndihmë për qytetarët e prekur nga aksidenti i tmerrshëm - zjarri që ndodhi në Koçan më 16.3.2025, i cili u zbatua përmes Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si marrës i donacionit. Për këtë qëllim, Agjencia nënshkroi marrëveshje donacioni me Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Agjencia mjete i transferoi më datë 16.4.2025, pasi mori mendim pozitiv për interes publik nga Ministria e Drejtësisë e RMV-së.

Gjithashtu, Agjencia më 20.3.2025, Agjencia miratoi një vendim tjetër (nr.y në ark. 05-1138/1) për dhënien e ndihmës financiare - donacion për Shoqërinë Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevaip ShPKNJ P Tetovë, në shumën prej 500.000,00 (pesëqind mijë) denarësh, për sanimin e pasojave të zjarrit që më 8.3.2025 përfshiu pjesë

të ambienteve të transmetuesit, me qëllim mbështetjen e aktiviteteve të transmetuesit për kryerjen pandërprje të veprimtarisë - transmetimin e programeve televizive dhe përmbajtjeve me rëndësi për rajonin D8 – Kodra e Diellit (Tetovë, Gostivar, Vrapçisht, Bogovinë, Brvenicë, Tearcë, Jegunovcë, Zhelinë), si dhe ofrimin e sigurisë dhe mbrojtjes së punonjësve. Për këtë qëllim, Agjencia nënshkroi marrëveshje donacioni me Shoqërinë Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevaip ShPKNJ P Tetovë dhe Agjencia i transferoi me datë 7.5.2025, pasi mori mendim pozitiv për interes publik nga Ministria e Drejtësisë e RMV-së.

Shpenzimet totale në vitin 2025 arrijnë në 146.963.368,00 denarë.

Shpenzimet i referohen qëllimeve të mëposhtme:

- Për lëndë të parë dhe materiale, për blerjen e karburantit për automjet zyrtare, për furnizim të mjeteve për zyrë, produkteve për higjienë personale, për ujin e harxhuar, për pagesën e higjienës komunale, për furnizimin e materialit të shpenzuar IT janë shpenzuar mjete në shumë totale prej 828.429,00 denarë;
- energji elektrike e konsumuar, e cila përfshin dhe harxhimin e energjisë termike në shumë prej 3.391.995,00 denarë;
- për investimin e mirëmbajtjes së aseteve, përkatësisht për mirëmbajtjen e rregullt të automjeteve, larjen e automjeteve, për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike dhe pajisjeve të tjera TIK (teknologjisë së informacionit dhe komunikimit) të Agjencisë, për mirëmbajtjen e sistemit për monitorimin e shërbimeve në radio dhe TV dhe mbikëqyrjen e ORRPKE (operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik) të Agjencisë, për mirëmbajtjen e hardver sistemit për monitorimin e shërbimeve e shërbimeve në radio dhe TV dhe mbikëqyrjen e ORRPKE (operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik), për mirëmbajtjen e faqes së internetit të Agjencisë (faqes së përgjithshme të internetit: www.avmu.mk, www.rodotimediumite.mk, www.mediumskapismenost.mk dhe faqes së internetit për zgjedhje dhe media), për mirëmbajtjen e modulit të punës së arkivit dhe mirëmbajtjen të softuerit të integruar të punës juridike, financiare dhe ekonomike, për mirëmbajtjen preventive dhe adaptive të sistemit të automatik për të menaxhimin të dokumenteve (DMS – sistemi i menaxhimit të dokumenteve), për mirëmbajtjen dhe servisimin të fotokopjuesit dhe printerëve, për mirëmbajtjen e instalimeve të spërkatësve kundër zjarrit – instalimit spliker (nënstacion i thatë, spërkatës dhe pompa) dhe pajisje PP, për angazhimin e firmës për shërbime hidraulike dhe elektrike, për mirëmbajtjen dhe servisimin e sistemit për ftohje, ngrohje dhe ventilim si dhe për mirëmbajtjen teknike të ashensorëve dhe platformës janë shpenzuar mjete në shumë prej 9.922.566,00 denarë;
- për shërbime shtypi janë shpenzuar mjete në shumë prej 367.100,00 denarë;
- për harxhime postare, për tarifa telefonike duke përfshirë telefona celular dhe fikse si dhe për tarifa të tjera për shërbime transporti janë shpenzuar mjete në shumë prej 1.600.557,00 denarë;
- për shtesa për reprezentacion janë shpenzuar mjete në shumë prej 684.580,00 denarë;
- për shtesa për përdorimin e objekteve të ndërtimit përkatësisht mjete destinuar për marrjen me qira për kolokacion të pajisjeve TIK në 8 lokacione të ndryshme në RMV janë shpenzuar mjete në shumë prej 1.202.790,00 denarë;
- për shtesa të taksave gjyqësore dhe administrative, shpenzime për blerjen e gazetave, revistve, literaturë profesionale, qasje në internet botimet elektronike të „Gazetës Zyrtare të RMV-së“, dhe botime të shtypit në „Gazetën Zyrtare“ për vitin aktual për pjesëmarrje në seminare, punëtori, konferenca, konsultime dhe të ngjajshme janë shpenzuar mjete në shumë prej 176.012,00 denarë;
- për kontroll sistematike dhe regjistrim të automjeteve janë shpenzuar mjete në shumë prej 38.815,00 denarë;

- për mbajtjen e ditëve të arsimit mediatic nga Agjenci janë shpenzuar mjete në shumë prej 1.473.079,00 denarë;
- për provizion të transaksioneve të pagesave dhe provizion bankar u shpenzuan mjete në shumë prej 96.116,00 denarë;
- për sigurimin e objektit të punës së Agjencisë, për sigurimin e pajisjes që posedojmë, për sigurimin e automjeteve zyrtare, për sigurimin nga përgjegjësia automobilistike pas regjistrimit, për kartona të gjelbër dhe sigurimin e udhëtimit, janë shpenzuar mjete në shumë prej 270.027,00 denarë;
- për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, mëditjet për udhëtime zyrtare në vend dhe jashtë vendit, për kompensimin e shpenzimeve të transportit për udhëtime zyrtare në vend dhe jashtë, për shpenzimet e akomodimit brenda dhe jashtë vendit, janë shpenzuar mjete në shumë prej 1.313.328,00 denarë;
- për shpërblime jubilarë (përvjetore) janë shpenzuar mjete në shumë prej 242.217,00 denarë;
- për kompensime të tjera për punonjësit janë shpenzuar mjete në shumë prej 3.528.404,00 denarë;
- për kompensimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë deri me datë 23.06.2025 janë shpenzuar mjete në shumë prej 6.059.098,00 denarë;
- për llogaritjen e ndryshimeve negative të kurseve janë shpenzuar mjete në shumë prej 2.023,00 denarë;
- për anëtarim vjetor në platformën ndërkombëtare të organeve rregullatore (EPRA) janë shpenzuar mjete në shumë prej 253.175,00 denarë;
- për shërbime kontraktuese përkthësisht për angazhimin përmes Agjencisë për punësim të përkohshëm për bashkëpunëtor të jashtëm, të cilët në pjesën më të madhe u angazhuan për monitorimin e aktiviteteve zgjedhore në vitin 2025 (zgjedhjet lokale), për angazhimin e zyrës për përkthim dhe mirëmbajtjes së higjienës në ambientet e punës të Agjencisë janë shpenzuar mjete në shumë prej 10.598.600,00 denarë;
- për shërbime avokatie janë shpenzuar mjete në shumë prej 366.000,00 denarë;
- për shërbime noteriale janë shpenzuar mjete në shumë prej 13.403,00 denarë;
- për shërbime të tjera personale dhe profesionale të destinuar për trajnime të punonjësve të Agjencisë u shpenzuan mjete në shumë prej 167.817,00 denarë;
- për analizën e çështjeve gjinore dhe mënyrës së përfaqësimit dhe prezantimit të grave dhe burrave në programet e radiodifuzerëve u shpenzuan mjete në shumë prej 338.478,00 denarë;
- për sigurimin e të dhënave të mara përmes matjes elektronike të shikueshmërisë së reklamave politike me pagesë me të dhëna të detajuara për transmetim të RPP (reklamim i paguar politik) në televizionet kombëtare tokësore gjatë zgjedhjeve lokale 2025, u shpenzuan mjete në shumë prej 512.120,00 denarë;
- për shpenzime të tjera, përkthësisht për sistemin e shpërndarjes së internetit të Regjistrimit Qendror, për shërbime revizioni, për lidhje interneti me hosting të faqeve ekzistuese të internetit të Agjencisë, për marrjen me qira për publikimin e reklamave në gazetatat ditore, për njoftime publike, për transferimin e të dhënave nga lokacione të largëta (8 lokacione në RMV) me komunikacion të pakufizuar të përfshirë për vendndodhje në dy drejtimet (download/upload) deri në selinë e Agjencisë dhe për shpenzime të tjera, janë shpenzuar mjete në shumë prej 3.067.449,00 denarë;
- për blerjen e mjeteve për zyrë dhe pajisje zyre janë shpenzuar mjete në shumë prej 22.370,00 denarë;
- për furnizimin e pajisjeve TIK (teknologjia e informacionit dhe komunikimit) për pajisje për modernizimin e server sallës, janë shpenzuar mjete në shumë prej 4.666.626,00 denarë;
- për pajisjen me çertifikatë digjitale për nënshkrim elektronik-token, për leje për pajisje sigurie të rrjetit kompjuterik (Firewall), për leje për softuer për bekapim automatik të të dhënave dhe për riçertifikimin e standartit ISO 9001:2015 u shpenzuan mjete në shumë prej 962.340,00 denarë;
- për ndihmë financiare – donacione janë shpenzuar mjete në shumë prej 3.000.000,00 denarë;

- për pagesë e pagave bruto të punonjësve në shërbimin profesional, janë shpenzuar mjete në shumë prej 91.679.888,00 denarë dhe
- për taksa dhe kontributet që lidhen me shlyerjen e kërkesave të papaguara, janë shpenzuar mjete në shumë prej 117.966,00 denarë.

Shpenzimet individuale janë renditur në Shtojcën nr. 1, pjesë përbërëse e këtij Raporti.

Shpenzimet totale të realizuara në vitin 2025 janë më të larta për 5.627.368,00 denarë krahasuar me të ardhurat totale të realizuara në të njëjtin vit. Nëse Ministria e Transformimit Digjital në llogarinë e Agjencisë për muajin dhjetor 2025 do të paguante shumën e saktë mujore prej 6.572.208,00 denarë në vend të shumës 1.572.208,00 denarëve (që është 5.000.000,00 denarë më pak), nuk do të paraqitej dallim kaq i madh midis shpenzimeve dhe të ardhurave për vitin 2025.

Vlera kontabël e mjeteve bazë të Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në fund të vitit 2025 është 299.451.458,00 denarë. Amortizimi i llogaritur (korrigjim i vlerës) për vitin 2025 është 8.697.871,00 denarë.

Sipas llogarisë vjetore për vitin 2025, kemi kërkesa për më shumë taksa dhe kontribute më të paguara në shumën prej 4.906.918,00 denarë. Ato i referohen kërkesës bazuar në tatimin total mbi të ardhurat dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

Kërkesat në total të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale bazuar në faturat e lëshuara nga vitet e kaluara, si dhe nga viti aktual 2025 sipas llogarisë vjetore për vitin 2025 arrijnë në shumë prej 1.925.823,00 denarë.

Detyrimet në total të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ndaj kreditorëve sipas llogarisë vjetore për vitin 2025 arrijnë në shumë prej 1.128.058,00 denarë. Këto borxhe kanë të bëjnë me detyrime të papaguara, pjesa më e madhe e të cilave janë paguar në janar të vitit 2026.

Agjencia sipas llogarisë vjetore për vitin 2025, ka detyrim të paguajë tatim mbi të ardhurat totale të organizatave jofitimprurëse në shumë prej 1% të të ardhurave tatimore të realizuara në shumë prej 583.199,00 denarë.

Shtojcë nr. 1

TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË REALIZUARA PËR VITIN 2025

A SHPENZIME

Mendim	Shpenzimet	Planifikuar për vitin 2025	Realizuar në vitin 2025
	Shpenzimet totale	202.429.722,00	146.963.368,00
400	Materiale të shpenzuara	1.908.000,00	828.429,00
400002	Inventar i vogël në përdorim	150.000,00	0,00
400100	Karburant i harxhuar, lubrifikant, etj.	450.000,00	157.718,00
400300	Material i shpenzuar zyre	360.000,00	99.407,00
400500	Material i shpenzuar për higjienë personale, ujë etj.	612.000,00	359.116,00
400700	Materiale dhe lëndë të para të shpenzuara	236.000,00	212.188,00
400900	Pjesë këmbimi të shpenzuara	100.000,00	0,00
401	Energji e konsumuar	9.900.000,00	3.391.995,00
401000	Energji elektrike e konsumuar	8.500.000,00	2.782.176,00
401100	Energji ngrohëse e konsumuar	1.400.000,00	609.819,00
402	Mirëmbajtje investimi e asetëve	15.343.000,00	9.922.566,00
402010	Riparime mallrash, shërbimesh, montimesh - automjete të lehta	400.000,00	371.319,00
402020	Riparime mallrash, shërbimesh, montimesh - mobiljesh	50.000,00	0,00
402030	Riparime mallrash, shërbimesh, montimesh - harduer dhe softuer	10.801.000,00	8.484.407,00
402040	Riparime mallrash, shërbimesh, montimesh - pajisje	3.192.000,00	915.209,00
402050	Riparime, mirëmbajtje të objekteve ndërtimore	900.000,00	151.631,00
403	Shërbime të tjera	708.000,00	367.100,00
403400	Shërbime shtypi	708.000,00	367.100,00
404	Shërbime transporti	1.950.000,00	1.600.557,00
404500	Posta (letra, materiale të shtypura, pako, etj.)	300.000,00	162.401,00
404600	Tarifat telefonike, tarifat për telefon, etj.	1.630.000,00	1.438.156,00
404900	Tarifat e tjera për shërbimet e transportit	20.000,00	0,00
405	Shpenzime për reklama, propagande dhe reprezentimi	1.100.000,00	684.580,00
405000	Shpenzime reprezentimi	1.100.000,00	684.580,00
408	Qira	8.660.000,00	1.202.790,00
408000	Qira për përdorimin e ndërtesave	1.400.000,00	1.202.790,00
408100	Qira për përdorimin e pajisjeve	7.230.000,00	0,00
408500	Lloje të tjera qiraje	30.000,00	0,00
409	Shpenzime të tjera materiale	2.964.000,00	1.687.906,00
409000	Tarifa gjyqësore dhe administrative	200.000,00	10.006,00
409100	Shpenzime për literaturë profesionale	250.000,00	121.610,00
409200	Shpenzime për pjesëmarrje në seminare, këshillime, etj.	350.000,00	44.396,00
409300	Shpenzime për regjistrimin e automjeteve	40.000,00	38.815,00
409500	Shpenzime për mbajtjen e kongreseve, punëtorive	2.124.000,00	1.473.079,00
410	Provizioni i transaksionit të pagesës	120.000,00	96.116,00
410100	Provizion i transaksionit të pagesës	90.000,00	81.265,00
410200	Provizion bankar	30.000,00	14.851,00
412	Prime sigurimi	1.600.000,00	270.027,00
412100	Prime sigurimi për pasuri të paluajtshme dhe të drejta	350.000,00	213.922,00
412200	Prime për sigurimin e automjeteve	150.000,00	56.105,00
412500	Prime të sigurimit shëndetësor privat	1.100.000,00	0,00
413	Mëditjet e udhëtimeve zyrtare dhe shpenzimeve të udhëtimit	3.920.000,00	1.313.328,00
413000	Mëditjet e udhëtimeve zyrtare në vend	100.000,00	26.400,00
413100	Mëditjet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit	600.000,00	221.756,00
413200	Kompensimi i shpenzimeve të transportit për udhëtim pune në vend	100.000,00	14.970,00
413300	Kompensimi i shpenzimeve të transportit për udhëtim pune jashtë vendit	1.700.000,00	428.339,00

413400	Kompensimi i shpenzimeve për qëndrim njëditore në udhëtim të ngjashëm në vend	250.000,00	81.610,00
413500	Kompensim i shpenzimeve për qëndrimeve njëditore në udhëtim të ngjashëm jashtë vendit	1.100.000,00	526.431,00
413720	Shpërblime të tjera që lidhen me udhëtimet e zyrtaret jashtë vendit	70.000,00	13.822,00
414	Kompensimet për shpenzimet e punëtorëve dhe qytetarëve	11.705.000,00	9.829.719,00
414800	Shpërblime jubilarë	245.000,00	242.217,00
414900	Kompensime të tjera	5.400.000,00	3.528.404,00
414901	Kompensime të tjera - anëtarë të Këshillit të Agjencisë	6.060.000,00	6.059.098,00
415	Diferencat e kursit të këmbimit	0,00	2.023,00
415000	Diferencat negative të kursit të këmbimit	0,00	2.023,00
416	Anëtarësime	259.000,00	253.175,00
416300	Tarifat e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare dhe të tjera	259.000,00	253.175,00
417	Shërbime intelektuale dhe të tjera	21.536.000,00	11.996.418,00
417100	Shërbime kontraktuale	16.533.000,00	10.598.600,00
417400	Shërbime avokatie	500.000,00	366.000,00
417500	Shërbime noteriale	50.000,00	13.403,00
417700	Shërbime të tjera personale dhe intelektuale	900.000,00	167.817,00
417800	Shërbime të tjera që nuk përmenden -hulumtime	3.553.000,00	850.598,00
418	Shpenzime të tjera të mbetura	6.582.000,00	3.067.449,00
418800	Shpenzime të tjera	6.582.000,00	3.067.449,00
441	Mjete për pajisje	5.438.000,00	4.688.996,00
441000	Blerje mobiljesh zyre	300.000,00	22.370,00
441200	Blerje - furnizim makinerish, pajisjesh, instrumentesh (pajisje TIK)	4.838.000,00	4.526.626,00
441500	Blerje – furnizim pajisjesh të tjera	300.000,00	140.000,00
442	Mjete të tjera kapitale	5.007.000,00	962.340,00
442100	Blerje patentash, lejeshe dhe të drejta të tjera	5.007.000,00	962.340,00
450	Ndihma, donacione dhe pagesa të tjera për subjektet	3.000.000,00	3.000.000,00
450100	Ndihma, donacione dhe pagesa të tjera për subjektet	3.000.000,00	3.000.000,00
460	Paga të llogaritura	100.729.722,00	91.679.888,00
460000	Paga neto dhe kompensime mbi pagat	65.835.315,00	60.119.034,00
460200	Taksa personale mbi pagat dhe kompensime mbi pagat	6.690.086,00	5.891.820,00
460300	Kontributi i sigurimit pensional dhe invalidor	18.937.187,00	17.234.953,00
460310	Kontributi i punësimit	1.208.754,00	1.100.097,00
460320	Kontributi i sigurimit shëndetësor	7.554.726,00	6.875.630,00
460330	Kontributi për sëmundje profesionale	503.654,00	458.354,00
470	Tatimet dhe kontributet që lidhen me shlyerjen e kërkesave të papaguara	0,00	117.966,00
470000	Tatimet dhe kontributet që lidhen me shlyerjen e kërkesave të papaguara	0,00	117.966,00

B SHPENZIME

Pozicion	Të ardhurat	Planifikuar për vitin 2025	Realizuar për vitin 2025
----------	-------------	----------------------------	--------------------------

Të ardhura nga Buxheti i RMV-së për proceset zgjedhore në vitin 2025 (zgjedhjet lokale)	13.000.000,00	7.581.728,00
Burime financiare nga Buxheti i RMV-së dhe të ardhura nga taksa e paguara radiodifuzive	78.800.000,00	74.117.431,00
Të ardhura të realizuara nga kompensimet për lejet e transmetimit televiziv dhe radio	50.000.000,00	47.495.388,00
Të ardhura nga mbikëqyrja e ritransmetimit të shërbimeve programore të operatorëve të rrjetit publik të komunikimit elektronik dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë	10.500.000,00	10.751.766,00
Të ardhura nga faturat tranzite	1.000.000,00	1.072.760,00
Të ardhura të tjera	0,00	316.927,00
Mjetet e tepërta të transferuara nga viti i kaluar	49.129.722,00	
Në total	202.429.722,00	141.336.000,00

Shtojcë nr. 2

**TË ARDHURAT E REALIZUARA DHE SHPENZIMET E REALIZUARA TË AGJENCISË PËR VITIN 2025,
TË GRUPUARA SIPAS STRUKTURËS ORGANIZATIVE**

**TË ARDHURAT E REALIZUARA TË AGJENCISË PËR VITIN 2025 QË NUK JANË TË GRUPUARA SIPAS
STRUKTURËS ORGANIZATIVE**

Pozicioni	Të Ardhurat	Mjetet e realizuara
	Të ardhurat nga Buxheti i RMV-së për proceset zgjedhore në vitin 2025 (zgjedhjet lokale)	7.581.728,00
	Të ardhurat nga Buxheti i RMV-së dhe të ardhurat nga taksa e paguar radiodifuzivet	74.117.431,00
	Të ardhurat e realizuara nga kompensimet për lejet e transmetimit televiziv dhe radio	47.495.388,00
	Të ardhurat nga mbikëqyrja e ritransmetimit të shërbimeve programore të operatorëve të rrjetit publik të komunikimit elektronik dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesës	10.751.766,00
	Të ardhurat nga faturat tranzite	1.072.760,00
	Të ardhura të tjera	316.927,00
	Në totali	141.336.000,00

**TË ARDHURAT E REALIZUARA TË AGJENCISË PËR VITIN 2025 QË NUK MUND TË
GRUPOHEN SIPAS STRUKTURËS ORGANIZATIVE**

401	Energjia e shpenzuar	3.391.995,00
401000	Energjia elektrike e shpenzuar	2.782.176,00
401100	Energjia termike e shpenzuar	609.819,00
404	Shërbimet e transportit	1.600.557,00
404500	Posta (letra, materiale të shtypura, pako, etj.)	162.401,00
404600	Tarifat telefonike, tarifat telefonike, etj.	1.438.156,00
405	Shpenzimet për reklamim, propagandë dhe përfaqësimit	684.580,00
405000	Shpenzimet e përfaqësimit	684.580,00
408	Qiratë	1.202.790,00
408000	Qiraja për përdorimin e objekteve ndërtimore	1.202.790,00
409	Shpenzimet e tjera materiale	214.827,00
409000	Tarifat gjyqësore dhe administrative	10.006,00
409100	Shpenzimet për literaturë profesionale, gazeta, etj.	121.610,00
409200	Shpenzimet për pjesëmarrje në seminare, këshillime, etj.	44.396,00
409300	Shpenzimet për regjistrimin e automjeteve	38.815,00
410	Provizion i transaksionit të pagesës	96.116,00
410100	Provizion për transaksionet e pagesave	81.265,00
410200	Provizion bankar	14.851,00
412	Primet e sigurimit	270.027,00
412100	Primet për sigurimin e pasurive të paluajtshme dhe të drejtave	213.922,00
412200	Primet për sigurimin e automjeteve	56.105,00

413	Mëditjet për udhëtime zyrtare dhe shpenzimet e udhëtimit	1.313.328,00
413000	Mëditje për udhëtime pune në vend	26.400,00
413100	Mëditje për udhëtime pune jashtë vendit	221.756,00
413200	Kompensimi i shpenzimeve të transportit për udhëtime pune në vend	14.970,00
413300	Kompensimi i shpenzimeve të transportit për udhëtime pune jashtë vendit	428.339,00
413400	Kompensime i shpenzimeve të akomodimit gjatë natës për udhëtime pune në vend	81.610,00
413500	Kompensimi i shpenzimeve të akomodimit gjatë natës për udhëtime pune jashtë vendit	526.431,00
413720	Kompensime të tjera që lidhen me udhëtimet zyrtare jashtë vendit	13.822,00
414	Kompensimi i shpenzimeve të punëtorëve dhe qytetarëve	9.829.719,00
414800	Shpërblimet e jubileut	242.217,00
414900	Kompensime të tjera	3.528.404,00
414901	Kompensime të tjera - anëtarë të Këshillit të Agjencisë	6.059.098,00
415	Diferencat e kursit të këmbimit	2.023,00
415100	Diferencat negative të kursit të këmbimit	2.023,00
416	Anëtarësimi	253.175,00
416300	Tarifat e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare dhe të tjera	253.175,00
417	Shpenzime intelektuale dhe të tjera	10.766.417,00
417100	Shërbime kontraktuale	10.598.600,00
417700	Shërbime të tjera personale dhe intelektuale	167.817,00
418	Shërbime të tjera të mbetura	3.067.449,00
418800	Shpenzime të tjera	3.067.449,00
441	Mjetet për pajisje	4.548.996,00
441000	Blerja e mobiljeve të zyrës	22.370,00
441200	Blerja-furnizim makinash, pajisje, instrumente (pajisje TIK)	4.526.626,00
442	Blerje mobiljesh zyre	962.340,00
442100	Blerje - blerje makinash, pajisjesh, instrumentesh (pajisje TIK)	962.340,00
450	Ndihma, donacione dhe pagesa të tjera të subjekteve	3.000.000,00
450100	Ndihma, donacion dhe pagesa të tjera të subjekteve	3.000.000,00
460	Rrogat e llogaritura	91.679.888,00
460000	Rrogat neto dhe kompensime të rrogave	60.119.034,00
460200	Tatimi personal mbi pagat dhe kompensimi i pagave	5.891.820,00
460300	Kontribut për sigurimin personal dhe invalidor	17.234.953,00
460310	Kontributi për punësim	1.100.097,00
460320	Kontributi i sigurimit shëndetësor	6.875.630,00
460330	Kontributi i sëmundjeve personale	458.354,00
470	Taksat dhe kontributet që lidhen me shlyerjen e taksave të papaguara	117.966,00
470000	Taksat dhe kontributet që lidhen me shlyerjen e taksave të papaguara dhe kërkesat	117.966,00
	Në total	133.002.193,00

SHPENZIMET E AGJENCISË NË VITIN 2025 TË GRUPUARA SIPAS STRUKTURËS ORGANIZATIVE

SEKTORI PËR PËRKRAHJEN E PUNËS SË DREJTORIT DHE KËSHILLIT

403	Shërbime të tjera	367.100,00
403400	Shërbime printimi	367.100,00
	Në total	367.100,00

SEKTORI PËR ÇËSHTJE PROGRAMORE

409	Shpenzime të tjera materiale	1.473.079,00
409500	Shpenzime për mirëmbajtje të punëtorive	1.473.079,00
417	Shërbime intelektuale dhe të tjera	850.598,00
417800	Shërbime të tjera që nuk përmenden - hulumtime	850.598,00
	Totali	2.323.677,00

SEKTORI PËR ÇËSHTJE JURIDIKE DHE FURNIZIME PUBLIKE

417	Shërbime intelektuale dhe të tjera	379.403,00
417400	Shërbime Avokati	366.000,00
417500	Shërbime Noteriale	13.403,00
	Në total	379.403,00

SEKTORI I FINANCAVE DHE LOGJISTIKË

400	Materiale të konsumuara	670.711,00
400300	Materiale zyre të konsumuara	99.407,00
400500	Materiale të konsumuara për higjienike personale, ujë, etj.	359.116,00
400700	Materiale të tjera të konsumuara dhe lëndë të para	212.188,00
402	Investime për mirëmbajtjen e mjeteve	1.066.840,00
402040	Riparime, ekzekutim mallrash, shërbime, instalime-pajisje	915.209,00
402050	Riparim, mirëmbajtje e objekteve të ndërtimit	151.631,00
	Në total	1.737.551,00

SEKTORI PËR MBËSHTETJE INFORMATIKE DHE ÇËSHJTJE TË PËRGJITHSHME

400	Materiale të konsumueshme	157.718,00
400100	Karburant i konsumuar, lubrifikantë, etj.	157.718,00
402	Investime dhe mirëmbajtje të aseteve	8.855.726,00
402010	Riparime, ekzekutim mallrash, shërbim, montim - automjete të lehta	371.319,00
402030	Riparime, ekzekutim mallrash, shërbim, montim - harduer dhe softuer	8.484.407,00
441	Pajisje dhe asete	140.000,00
441500	Blerje - furnizime pajisjesh të tjera	140.000,00
	Në total	9.153.444,00

SEKTORI PËR PLANIFIKIM STRATEGJIK DHE TË DREJTAT E AUTORIT

417	Shërbime intelektuale dhe të tjera	0,00
417800	Shërbime të tjera që nuk përmenden - hulumtime	0,00
	Në total	0,00

Grupimi i shpenzimeve sipas strukturës organizative kryhet në bazë të kompetencës të secilit sektor përkatës për zbatimin e aktiviteti të caktuar të Agjencisë.

ANALIZË KRAHASUESE E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE TË REALIZUARA TË AGJENCISË PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE NË VITIN 2024 DHE VITIN 2025

Analiza krahasuese e të ardhurave të realizuara në vitin 2024 me të ardhurat e realizuara në vitin 2025 tregon se:

Në vitin 2025, nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në llogarinë e Agjencisë u paguan mjete, të cilat ishin të destinuara vetëm për financimin e aktiviteteve të Agjencisë gjatë proceseve zgjedhore (zgjedhjeve lokale), në pajtim me Kodin Zgjedhor, dhe prej saj u shpenzuan mjete në shumë prej 7.581.728,00 denarë. Në vitin 2024, gjatë aktiviteteve zgjedhore (zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale), u shpenzuan mjete në shumë totale prej 4.197.302,00 denarë.

Në vitin 2025, Ministria e Transformimit Digjital dhe pagesës së taksës radiodifuzive u realizuan në total 74.117.431,00 denarë, ndërsa në vitin 2024, mbi të njëjtën bazë u transferuan 75.309.086,00 denarë. Nëse Ministria e Transformimit Digjital do të kishte paguar shumën e saktë mujore prej 6.572.208,00 denarë në llogarinë e Agjencisë për dhjetor 2025, në vend të 1.572.208,00 denarëve (që është 5.000.000,00 denarë më pak), në atë rast të ardhurat në vitin 2025 do të kishin qenë më të larta krahasuar me vitin 2024 mbi këtë bazë.

Mjetet e paguara nga lejet për transmetim televiziv dhe radio në vitin 2025 arritën në shumë prej 47.495.388,00 denarë, ndërsa në vitin 2024 në 45.577.501,00 denarë. Dallimi është për shkak të faktit se shuma e PDB-së (si një nga elementët e formulës për llogaritjen e kompensimit vjetore) ishte më e lartë në vitin 2025.

Kompensimi i mbikëqyrjes nga operatorët që ritransmetojnë shërbime programore dhe nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë në vitin 2025 arriti në shumë prej 10.751.766,00 denarë, ndërsa në vitin 2024 ishte pak më e ulët dhe arriti në shumë prej 10.422.602,00 denarë.

Nga faturat e tranzitit të lëshuara nga Agjencia për konsumim të energjisë elektrike, për mirëmbajtjen e ashensorëve dhe platformave, për mirëmbajtjen dhe servisimin e sistemit të ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit, në vitin 2025 janë realizuar mjete në shumë prej 1.072.760,00 denarë, të cilat në vitin 2024 ishin më të ulëta dhe arritën në shumë prej 858.310,00 denarë.

Në vitin 2025 u realizuan edhe të ardhura të tjera në shumë prej 316.927,00 denarë, të cilat në vitin 2024 arritën në shumë prej 244.301,00 denarë. Në vitin 2025, pjesa më e madhe e këtyre mjeteve erdhi nga pagesat për dokumentacionin e tenderit për konkurset publike për dhënien e lejeve për transmetim të programeve televizive dhe radio.

Dallimet midis shpenzimeve për disa pozicione në vitin 2024 dhe 2025 janë për shkak të arsyeve të mëposhtme:

Në pozicionin (414901) – Kompensime të tjera – Anëtarë të Këshillit të Agjencisë, në vitin 2025 janë paguar mjete në shumë prej 6.059.098,00 denarë, ndërsa në vitin 2024 janë paguar mjete në shumë totale prej 11.759.574,00 denarë. Diferenca është për shkak të faktit se që nga data 23.06.2025, anëtarët e vjetër të Këshillit ishin të angazhuar në Agjenci si persona të zgjedhur dhe të emëruar për të cilët Agjencia paguante kompensim për të cilin nuk ishin paguar kontribute, ndërsa që nga data 24.06.2025, Agjencia ka anëtarë të rinj të Këshillit të cilët janë persona të emëruar dhe të angazhuar profesionalisht me orar të plotë pune.

Në pozicionin (417100) - Shërbime kontraktuale, në vitin 2024 u shpenzuan mjete në shumën prej 7.878.262,00 denarë, ndërsa në vitin 2025 u shpenzuan mjete në shumën prej 10.598.600,00 denarë. Dallimi është rezultat për faktin se në vitin 2024 Agjencia angazhoi bashkëpunëtorë të jashtëm përmes Agjencisë së Punësimit të Përkohshëm për të monitoruar proceset zgjedhore (zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale), ndërsa në vitin 2025 Agjencia angazhoi më shumë bashkëpunëtorë të jashtëm për të monitoruar zgjedhjet lokale.

Sipas pozicionit (450100) - Ndhimë, donacione dhe grante të tjera për subjekte, në vitin 2024 janë shpenzuar mjete në shumë prej 5.000.000,00 denarë, ndërsa në vitin 2025 janë shpenzuar mjete në shumë prej 3.000.000,00 denarë. Dallimi është për shkak të faktit se në vitin 2024 Agjencia ndau fonde Shoqatës së Qytetarëve LABORATORI I RAPORTIMIT TË KËRKIMEVE - IRL Shkup, me qëllim sigurimin e realizimit të iniciativave të tyre kërkimore, ndërsa në vitin 2025 Agjencia ndau tre donacione, njëra prej të cilave në shumën prej 1.000.000,00 (një milion) denarë, për zbatimin e "Projektit për Efikasitet Energjetik për ISHP SBGPM 13 Nëntori Shkup", tjetra në shumën prej 1.500.000,00 (një milion e pesëqind mijë) denarë, si ndihmë për qytetarët e prekur nga aksidenti i tmerrshëm - zjarri që ndodhi në Koçan më 16.3.2025, të cilat u zbatuan përmes Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe donacioni i tretë për Shoqërinë Tregtare Radiotelevizive TV KOHA Mevaip ShPKNjP Tetovë, në shumën prej 500.000,00 (pesëqind mijë) denarë, për sanimin e pasojave të zjarrit që ndodhi më 8.3.2025 duke përfshirë pjesë të ambienteve të transmetuesit, me qëllim mbështetjen e aktiviteteve të transmetuesit për kryerjen pandërprerje të aktivitetit të tij - transmetimin e programeve televizive dhe përmbajtjeve me rëndësi për rajonin D8 – Kodra e Diellit (Tetovë, Gostivar, Vrapçisht, Bogovinë, Brvenicë, Tearcë, Jegunovcë, Zhelinë), si dhe ofrimin e sigurisë dhe mbrojtjes së punonjësve.

Në pozicionin e shpenzimeve (460) - Pagat e llogaritura, në vitin 2025 u shpenzuan mjete në shumën prej 91.679.888,00 denarë, ndërsa në vitin 2024 mjetet e shpenzuara arritën në shumë prej 68.745.073,00 denarë. Diferenca është për shkak të faktit se që nga data 24.06.2025, anëtarët e rinj të Këshillit janë persona të angazhuar profesionalisht me orar të plotë dhe që atëherë janë në listën e pagave të Agjencisë.

Shtojcë 2.1

Të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara në vitin 2024 dhe 2025

A SHPENZIMET

Vendosja	Shpenzimet	Realizuar në vitin 2024	Realizuar në vitin 2025
	Shpenzime në total	128.669.018,00	146.963.368,00
400	Materiale të konsumuara	806.034,00	828.429,00
400002	Inventar i vogël në përdorim	0,00	0,00
400100	Karburant i konsumuar, lubrifikantë, etj.	167.618,00	157.718,00
400300	Materiale zyre të konsumuara	78.246,00	99.407,00
400500	Materiale të konsumuara për higjienë personale, ujë, etj.	363.147,00	359.116,00
400700	Materiale të tjera dhe lëndë të para të konsumuara	197.023,00	212.188,00
401	Energji e shpenzuar	3.749.190,00	3.391.995,00
401000	Energji elektrike e shpenzuar	3.005.226,00	2.782.176,00
401100	Energji ngrohëse e shpenzuar	743.964,00	609.819,00
402	Mirëmbajtje investimi i aseteve	8.767.798,00	9.922.566,00
402010	Riparime mallrash, shërbimesh, montimi - automjete të lehta	198.905,00	371.319,00
402030	Riparime mallrash, shërbimesh, montimi - harduer dhe softuer	7.254.750,00	8.484.407,00
402040	Riparime mallrash, shërbimesh, montimi - pajisje	1.283.983,00	915.209,00
402050	Riparim, mirëmbajtje e objekteve ndërtimore	30.160,00	151.631,00
403	Shërbime të tjera	286.790,00	367.100,00
403400	Shërbime shtypi	286.790,00	367.100,00
404	Shërbime transporti, udhëtimi	1.494.576,00	1.600.557,00
404500	Posta (letra, materiale të shtypura, pako, etj.)	150.955,00	162.401,00
404600	Tarifat telefonike, tarifat për telefon, etj.	1.343.621,00	1.438.156,00
405	Shpenzime reklamimi, propagande dhe reprezentimi	861.354,00	684.580,00
405000	Shpenzime për reprezentim	861.354,00	684.580,00
408	Qira	1.333.924,00	1.202.790,00
408000	Qira për përdorim të objekteve ndërtimore	1.333.924,00	1.202.790,00
409	Shpenzime të tjera materiale	1.746.989,00	1.687.906,00
409000	Taksat gjyqësore dhe administrative	54.986,00	10.006,00
409100	Shpenzime për literaturë profesionale	140.280,00	121.610,00
409200	Shpenzime për pjesëmarrje në seminare, këshillime, etj.	0,00	44.396,00
409300	Shpenzime për regjistrimin e automjeteve	29.827,00	38.815,00
409500	Shpenzime për mbajtjen e kongreseve, punëtorive	1.521.896,00	1.473.079,00
410	Provizion për transaksione pagesash	96.235,00	96.116,00
410100	Provizion për transaksione pagesash	86.985,00	81.265,00
410200	Provizion bankar	9.250,00	14.851,00
412	Prime për sigurim	268.139,00	270.027,00
412100	Prime për sigurimin e pasurive të paluajtshme dhe të drejtave	153.363,00	213.922,00
412200	Prime për sigurimin e automjeteve	114.776,00	56.105,00
413	Mëditje për udhëtime zyrtare dhe shpenzimet e udhëtimit	1.612.353,00	1.313.328,00
413000	Mëditjet e udhëtimeve zyrtare brenda vendit	17.600,00	26.400,00

413100	Mëditjet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit	369.319,00	221.756,00
413200	Kompensimi i shpenzimeve të transportit për udhëtim të ngjashëm në vend	13.110,00	14.970,00
413300	Kompensim i shpenzimeve të transportit për udhëtim të ngjashëm jashtë vendit	419.497,00	428.339,00
413400	Kompensim i shpenzimeve të akomodimit gjatë natës për udhëtim të ngjashëm në vend	89.220,00	81.610,00
413500	Kompensim i shpenzimeve të akomodimit gjatë natës për udhëtim të ngjashëm jashtë vendit	700.807,00	526.431,00
413720	Kompensime të tjera që lidhen me udhëtim zyrtar jashtë vendit	2.800,00	13.822,00
414	Kompensime për shpenzimet e punëtorëve dhe qytetarëve	14.459.580,00	9.829.719,00
414800	Çmime jubilare	0,00	242.217,00
414900	Kompensime të tjera	2.700.006,00	3.528.404,00
414901	Kompensime të tjera - anëtarëve të Këshillit të Agjencisë	11.759.574,00	6.059.098,00
415	Diferenca të kursit të këmbimit	151,00	2.023,00
415000	Diferenca negative të kursit të këmbimit	151,00	2.023,00
416	Anëtarësime	240.786,00	253.175,00
416300	Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare dhe të tjera	240.786,00	253.175,00
417	Shërbime intelektuale dhe të tjera	9.293.238,00	11.996.418,00
417100	Shërbime kontraktuale	7.878.262,00	10.598.600,00
417400	Shërbime avokatie	374.000,00	366.000,00
417500	Shërbime noteriale	7.261,00	13.403,00
417700	Shërbime të tjera personale dhe intelektuale	76.876,00	167.817,00
417800	Shërbime të tjera të papërmendura - hulumtime	956.839,00	850.598,00
418	Shpenzime të tjera të mbetura	3.164.359,00	3.067.449,00
418800	Shpenzime të tjera	3.164.359,00	3.067.449,00
441	Mjete pajisjesh	4.891.089,00	4.688.996,00
441000	Blerje e mobiljeve të zyrës	0,00	22.370,00
441200	Blejre – furnizim me makinave, pajisjeve, instrumenteve (pajisje IT)	4.836.589,00	4.526.626,00
441500	Blerja – furnizim i pajisjeve të tjera	54.500,00	140.000,00
442	Aseteve të tjera kapitale	1.851.360,00	962.340,00
442100	Huazim i patentave, lejeve dhe të drejtave të tjera	1.851.360,00	962.340,00
450	Ndihma, donacionet dhe pagesat e tjera për subjektet	5.000.000,00	3.000.000,00
450100	Ndihma dhe pagesat e tjera për subjektet	5.000.000,00	3.000.000,00
460	Pagat e llogaritura	68.745.073,00	91.679.888,00
460000	Pagat neto dhe kompensimi i pagave	45.160.807,00	60.119.034,00
460200	Taksa personale mbi pagat dhe kompensimi i pagave	4.336.634,00	5.891.820,00
460300	Kontributet e sigurimit pensional dhe invalidor	12.924.076,00	17.234.953,00
460310	Kontributet e punësimit	824.941,00	1.100.097,00
460320	Kontributet e sigurimit shëndetësor	5.155.888,00	6.875.630,00
460330	Kontributi për sëmundjet profesionale	343.727,00	458.354,00
470	Taksa dhe kontribute që lidhen me shlyerjen e kërkesave të papaguara	0,00	117.966,00
470000	Taksa dhe kontribute që lidhen me shlyerjen e kërkesave të papaguara	0,00	117.966,00

B TË ARDHURA

Pozicion	Të Ardhurat	Realizuar në vitin 2024	Realizuar në vitin 2025
	Të Ardhurat nga Buxheti i RMV-së për proceset zgjedhore në vitin 2025 (zgjedhjet lokale)	4.197.302,00	7.581.728,00
	Të Ardhurat nga Buxheti i RMV-së dhe të ardhurat nga taksa e paguar radiodifuzive	75.309.086,00	74.117.431,00
	Të Ardhurat nga kompensimet e lejeve për transmetim televiziv dhe radio	45.577.501,00	47.495.388,00
	Të Ardhurat nga mbikëqyrja e ritransmetimit të shërbimeve programore të operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë	10.422.602,00	10.751.766,00
	Të Ardhurat nga faturat tranzite	858.310,00	1.072.760,00
	Të Ardhurat nga diferencat pozitive të kursit të këmbimit	1.556,00	0,00
	Të Ardhura të tjera	244.301,00	316.927,00
	Në total	136.610.658,00	141.336.000,00